RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
"AUDITIM PËRPUTHSHMËRIE MBI VEPRIMTARINË E ADMINISTRATËS SË ZONAVE TË MBROJTURA TIRANË"

Tiranë, janar 2023

	Përmbajtja	1
I	**HYRJE**	2-2
	1.Titulli	2-2
	2.Marrësi	2-3
	3.Objektivat dhe qëllimi	2-3
	4.Identifikimi i çështjes	3-3
	5.Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	3-3
	6.Përgjegjësitë e audituesve	3-4
	7.Kriteret e vlerësimit	4-5
	8.Standardet e Auditimit	5-5
	9.Metodat e auditimit	5-5
	10. Dokumentimi i auditimit	5-5
II	**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	5-6
1	Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit	6-6
Pika 1	Mbi administrimin e pronës shtetërore. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare. Inventarizimi i pronës shtetërore dhe regjistrimi në Zyrat e Pasurisë.	6-7 7-8
Pika 2	Auditim mbi zbatimin e ligjshmërisë në monitorimin e mjedisit dhe zbatimi i procedurave të vetë monitorimit.	8-15 16-19
Pika 3	Auditim mbi masat e marra për vlerësimet periodike të situatave mjedisore në aktivitetin mjedisor e zhvillimor të zonave dhe ruajtjen e monumenteve të natyrës.	20-21
Pika 4	Auditim mbi zbatimin e procedurave për planet zhvillimore të subjekteve private e vetë njësisë publike dhe zbatimin i ligjshmërisë të akteve te lidhura me subjektet private.	21-56
Pika 5	Hartimi dhe zbatimi planeve të menaxhimit për Zonat e Mbrojtura.	57-59
Pika 6	Auditim mbi bashkëpunimin me organet e tjera të kontrollit si ARM, etj., për kryerjen e inspektimin e kontrolleve dhe inspektimeve të përbashkëta në zonat e mbrojtura. Probleme te ndryshme qe dalin gjate auditimit.	60-69
III.	**KONKLUZIONI DHE OPINIONI I AUDITIMIT**	70-71
IV.	**GJETJET DHE REKOMANDIMET**	71-75
V.	**LISTA E DOKUMENTEVE TË AUDITIMIT**	76-77
VI	**ANEKSE**	77-87

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
AdZM	Administrata e Zonave të Mbrojtura
AKZM	Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave të Ndërtimeve Informale
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
ISHMP	Inspektorati Shtetëror Mbrojtjes Pyjeve
DRISHMP	Drejtoria Rajonale Inspektoratit Mbrojtjes Pyjeve
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
DFB	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
DTTV	Drejtoria e Tarifave dhe Taksave Vend
IKMT	Inspektorati Kombëtar Mbrojtjes Territorit
KKRRT	Këshilli Kombëtar rregullimit Territorit

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë kryen veprimtarinë në zbatim të ligjit nr.81/2017 "Për zonat e mbrojtura"; VKM nr.1189, datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit"; Ligjin nr.10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar; si dhe Urdhrin e Ministrit të Mjedisit nr. 129, datë 23.06.2016 "Për miratimin e procedurës së dhënies në përdorim me kontratë qiraje të sipërfaqeve të zonave të mbrojtura" vendime dhe udhëzimet tjera të dala në funksionim të ligjeve.Menaxhimin ruajtjen e zonave të mbrojtura mjedisore, parimi i zhvillimit të qëndrueshëm, menaxhimit të kujdesshëm, të burimet tokës, përfshirë ajrin, ujin, florën dhe faunën. Integrimi i politikave të mbrojtjes së mjedisit në ato të zhvillimit ekonomik, ndërgjegjësimine popullatësndaj florës,faunësndalimi gjuetisë të paligjshmenë Zonë të mbrojtura.Monitorimin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura si dhe krijimin e përdorimin të ardhurave që realizon institucionit.

I .1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

I.2. Auditimi i ushrtruar në ADZM Tiranë, u realizuarmbizbatimin e përputhshmërisë, rregullshmërisë dhe ligjshmërisë në aktivitetin, monitorimin, gjendjen e florës dhe faunës,si dhe mbrojtjen e mjedisit.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	Në zonat e mbrojtura ushtrojnë aktivitet individ privat banorë të zonës si dhe një numër i konsiderueshëm biznesesh,që shfrytëzojnë këto burime natyrore fitimprurëse.	Pika 3.	E mesme	AdZM Tiranë të marrë masa që në çdo raste të ketë informacionin e duhur nëpërmes monitorimeve për aktivitete që kryhen brenda zonës së mbrojtur.
2	Mangësi në dokumentacionin e ne menaxhimin e te ardhurave	Pika 2.	E mesme	Nga auditimi u konstatua se ADZM Tirane nuk ka përllogaritur sakte dhe nuk ka marre masa për arkëtimin e plote te detyrimeve për tarifat e qirasë për sipërfaqet e zonave te mbrojtura ne përdorim.
3	Mos hartim i planit të menaxhimit nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit.	Pika3.2	E Lartë	Nga auditimi i ushtruar u konstatua se Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë ka burime te tjera te të ardhura te pa arkëtuara dhe te munguara në buxhetin e shtetit Të ardhuara këto nga lëvizja e vizitorëve në drejtimin tjetër të portës hyrës që kalojnë "**pa paguar as një detyrim** në Zonën e Mbrojtur Dajt, nga lëvizja e vizitorëve "ndërmjet teleferikut "D-E" si dhe ne zonën e K,

				objekteve të natyrës dhe antenat televizive te vendosura ne Zonat e Mbrojtura e nuk kanë as një plan për menaxhimin dhe rritjen e te ardhurave me Ministrinë e vartësisë.
4	Problematikat e mugese dokumentacioni ne Zonat e Mbrojtura Tiranë.	Pika. 4	E mesme	Nga auditimi u konstatua se nuk janë regjistruar ne ASHK Tirane sipërfaqet e zonave te mbrojtura nga Administrata e zonave të mbrojtura Tiranë dhe (AKZM).
5	Nga auditimi u konstatua se 8 procesverbale konstatimi rezultojnë të jenë pa autorë.	Pika .5		Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë në bashkërendim me Inspektoratin e Policisë Pyjore të marrë masa për të zbuluar dhe ndëshkuar,rastet e dëmtimit, pushtimit, shpërdorimit, tjetërsimit, shkretimit dhe degradimit të zonave të mbrojtura brenda territorit të tyre".
6	Ndërtimet Informale në zonat e mbrojtura.	Pika3.1	E Lartë	ADZM Tiranë të marrë masa dhe të këtë të gjithë informacionet për ndërtimet informale, si dhe të bashkëpunoje me të gjitha institucionet ligj zbatuese për Zonën e mbrojtura me njoftime periodike shkresore pranë IKMT dhe ASHK për ndjekjen procedurave ligjore në të gjitha ato zona ku ka objekte të ndërtuara jashtë ligjit.

I.3. KONKLUZIONI DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion mbi përputhshmërinë: (I modifikuar/kualifikuar)

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së Administratës të Zonave të Mbrojtura, përsa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve, termave dhe kushteve mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), në mbështetje të ligjit nr. 154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Rregulloren e Procedurave të Auditimit dhe në Manualit të Auditimit Përputhshmërisë të tij.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Administratës të Zonave të Mbrojtura, të krijuar me VKM nr.102, datë 04.02.2015 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe të Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura", janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin" që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale dhe cilësore por jo të përhapura dhe që justifikojnë dhënien e një opinioni të modifikuar/kualifikuar.

<u>Baza për opinionin</u>

Ne kemi kryer auditimin e përputhshmërisë dhe besojmë se evidencat e auditimit janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të shërbyer si bazën e arsyeshme për dhënien e opinionit i modifikuar/kualifikuar. Dhënien e **opinionit i modifikuar/kualifikuar** e mbështesim sipas përshkrimeve të mëposhtme të arritura në përfundim të procesit të auditimit:

-Zonat e mbrojtur Tiranë kanë shtrirje në një sipërfaqe prej 55 mije hektarë, si zonë e mbrojtur natyrore dhe nga të dhënat e raporteve të menaxhimit dhe monitorimit nga Administrata e

Zonave të Mbrojtura Tiranë dhe nga projekte veprimtaritë ekonomike-sociale, që veprojnë në këtë zonë, është konstatuar se kanë ndikim negativ në florën dhe fauna e cila është e kërcënuar për vete faktin se brenda zonave të mbrojtura jetojnë një numër i lartë biznese dhe banore, që me aktivitetin e tyre cenojnë këto vlera si dhe dëmtojnë biodiversitetin ,që shfrytëzojnë këto burime fitimprurëse të Zonat e Mbrojtura.

-Nga Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë nuk ka evidentim dhe regjistrim të subjekteve të biznesit të cilat kryejnë veprimtari të ndryshme me karakter ekonomik dhe social si bujqësi, kulturore dhe shërbimet turistike. Nuk ka të dhëna për to në lidhje me aktivitetet e tyre (licencimi, koha e ushtrimit të aktivitetin, mendime , territoret apo dhe veprimtaritë e të cilëve përfshihen në zonën e mbrojtur ose në atë buferike) në kundërshtim me neni 9 pika 5 I ligjet nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura".

-Nga Qeveria Qendrore dhe Pushteti Vendor nuk është zgjidhur problem i taksimit specifik të personave fizik dhe juridik që shfrytëzojnë vlerat natyrore, historike dhe kulturore të zonave të mbrojtura, nëpërmjet përfshirjes së tyre në paketat fiskale të tyre.

-Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë nuk ka të evidentuara ndërtimet pa leje të kryera në ZM të Qarkut e Tiranës, të cilat duhet të ishin raportuar pranë AKZM Tiranë. Nga informacioni i marrë nga zyra e ASHK Tiranë, rezulton se ka pasur një numër të ndërtimeve pa leje dhe Vetë deklarimeve për legalizim. Për këtë arsye në disa zona aty ku ka pasur edhe një dendësi të lartë të ndërtimeve është vepruar duke i shpallur Zona Informale.

-Këto legalizime janë bërë në mungesë të planit të menaxhimit të zonës të aprovuar në kundërshtim me ligjin nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura" "neni 19 "Përdoruesit e zonave të mbrojtura" dhe Neni 25 "Veprimtaritë në zonat e mbrojtura" ligjin nr. 2020/2020 "Për Përfundimin e Proceseve kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë".

-Për periudhën objekt auditimi të viteve 2019-2021, nuk ishte kryer inventari i rregullt dhe i pa kontabilizuar saktë me mungesa e kartelave personale të secilit punonjës ne 17 artikuj në vlerë 6,319,273 lekë, në kundërshtim Rregulloren e Brendshme, neni 30 pika 1 dhe në kundërshtim me Udhëzimin nr.30,datë 27.12.2011(pika 73 dhe 74).

-Nga auditimi u konstatua se 32 procesverbale konstatimi rezultojnë të jenë pa autorë, sa më sipër është vepruar në kundërshtim të ligjit Nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura ".

-Në subjekte që kanë lidhur kontratë qiraje me Administratën e Zonave të Mbrojtura Tiranë , rezulton nuk kane përllogaritur saktë sipërfaqet e zonave te mbrojtura për 11 subjekte ne vlerën 1,955,991 lekë. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim të ligjit Nr.81/2017 "Për zonat e mbrojtura".

-Nga Ministra e Turizmit dhe Mjedisit nuk është zgjidhur, problemi i regjistrimit të sipërfaqeve pronave në ASHK-Tiranë ne kundërshtim me nenin 55 te ligjit 81/2017.

-Nga AdZM-Tiranë dhe AKZM nuk ka funksionuar bashkëpunimi me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për të planifikuar sandarte për të gjithë vizitorët në territorin e Zonës Mbrojtur Tiranë kryesisht "Zona e Teleferikut dhe Karavastasë dhe antenat televizive " për të arkëtuar sipas tarifave përkatëse, për të gjithë vizitoret dhe për te rritur të ardhurat në vlerën mesatarisht 200 milion në vit, të cilat janë të ardhura te munguara në buxhetin e shtetit.

- Nga auditimi u konstatua se nuk ka është marrë informacion i plotë për subjektet që kanë kontrata të lidhura nga AdZM si dhe informacion nga sistemi "Ruda " dhe Ministria e Bujqësisë mbi sasinë e krerëve të tyre, që ç frytëzohen për kullota në Malin e Dajtit veprime në kundërshtim me nenin 3 pika 2 e ligjit 81/2017 .

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Administratës së Zonave të Mbrojtura Tiranë:

Strukturat drejtuese të Administratës së Zonave të Mbrojtura Tiranë, janë përgjegjëse për ruajtjen e zonave të mbrojtura mjedisore dhe zhvillimin e qëndrueshëm, në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit).
Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullator në fushën e mjedisit si:
-Monitorimi i mjedisit dhe zbatimi i kushteve për ruajtjen e tyre, vlerësimet periodike të situatave mjedisore, aktivitetin mjedisor e zhvillimor dhe ruajtjen e monumenteve të natyrës,
- Hartimi i plan-menaxhimit dhe zbatimi i tyre,
- Bashkëpunimi me organet e tjera të kontrollit si ish/DRISHMP, Njësitë Vendore etj.
Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:
Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.
-Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatueshmërinë e kritereve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH",në zbatim të Programit të Auditimit nr.892/1 datë 13.10.2022, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 17.10.2022, deri në datë 09.12.2022, në subjektin AdZM Tiranë, për periudhën nga 01.01.2019 deri në 31.12.2021,u krye auditimi "Mbi zbatimin e përputhshmërisë", nga **Grupi i Auditimi me përbërje:**

1.H. M, përgjegjës grupi
2.B.B, anëtare
3.R.F, anëtare

***1. Objektivat i auditimit*:** Kontrolli i Lartë i Shtetit ka audituar zbatimin e përputhshmërisë, rregullshmërisë dhe ligjshmërisë në aktivitetin, monitorimin dhe mbrojtjen e mjedisit për periudhën objekt i këtij auditimi, në përputhje me:
-Ligjin nr. 154/2014datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
- Ligjin nr.81/2017 datë 04.05.20217"Për zonat e mbrojtura";
-Vendimi i KM nr. 102, datë 04.02.2015 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura";
-Urdhri i Kryeministrit nr.39 datë 12.03.2015, mbi "Miratimin e strukturës dhe Organikës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura";
-Urdhrin nr. 48 , datë 29.03.2016, "Miratimin e strukturës dhe Organikës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura" i ndryshuar;

-Si dhe udhëzimeve te dala nga Ministria Mjedisit dhe Turizmit.

2.Qëllimi i auditimit: është vlerësimi objektiv, profesional e i pavarur i përputhjes së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare të Administratën e Zonave të Mbrojtura Tiranë, mbi çështjet që lidhen me ruajtjen, menaxhimin, monitorimin e zonave të mbrojtura si dhe masat dhe bashkëpunimet ndërinstitucionale për parandalimin e dëmtimeve ekologjike dhe natyrore.

3. Identifikimi i çështjes

1-Rregullshmëria e plotësimit dhe përpunimit të dokumentacionit për shpenzimet e të ardhurat
2-Hartimi i kontratave dhe lidhja me të tretet, mënyra e plotësimit dokumentacionit.
3-Përdorimi efektiv i shpenzimeve minimale operative në lidhje me rregullshmërinë dhe ligjshmërinë e dokumentacionit mbështetës për përdorimin e karburantit dhe kancelari .
4-Monitorimi i mjedisit dhe zbatimi i kushteve për ruajtjen e tyre, vlerësimet periodike të situatave mjedisore, aktivitetin mjedisor e zhvillimor dhe ruajtjen e monumenteve të natyrës,
5-Hartimi i plan-menaxhimit dhe zbatimi i tyre,
6-Marja e të dhëna për ndërtimet informale në zonat e mbrojtura.
7- Bashkëpunimi me organet e tjera të kontrollit si ish/DRISHMP, Njësitë Vendore etj.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar:

Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë, në zbatim - ligjin nr.81/2017 "Për zonat e mbrojtura" që ka për objektiv: Vendimi i KM nr. 102, datë 04.02.2015 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura".
-Urdhri i Kryeministrit nr.39 datë 12.03.2015, mbi "Miratimin e strukturës dhe Organikës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura"
-Urdhrin nr. 48 , datë 29.03.2016, "Miratimin e strukturës dhe Organikës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura" i ndryshuar.
-Si dhe udhëzimeve te dala nga Ministria Mjedisit dhe Turizmit.
-Monitorimi i mjedisit dhe zbatimi i kushteve për ruajtjen e tyre, vlerësimet periodike të situatave mjedisore, aktivitetin mjedisor e zhvillimor dhe ruajtjen e monumenteve të natyrës,
- Hartimi i plan-menaxhimit dhe zbatimi i tyre,
- Bashkëpunimi me organet e tjera të kontrollit si ish/DR-ISHMP, Njësitë Vendore etj.

5. Përgjegjësitë e audituesve:

Grupi i auditimit të KLSH-së, për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimitnë përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, grupi i auditimit ka zbatuar Kodin e Parimet Etike të cilat drejtojnë përgjegjësitë profesionale të audituesit, si dhe Standardet e Miratuara të Auditimit të cilat kanë në qendër të vëmendjes:
- Evidentimi i të metave dhe mangësive në lidhje me rregullshmërinë e proceseve sipas legjislacionit dhe rregullave të funksionimit të miratuara nga Administratën e Zonave të Mbrojtura Tiranë.
- Monitorimi i mjedisit dhe zbatimi i kushteve për ruajtjen e tyre, vlerësimet periodike të situatave mjedisore, aktivitetin mjedisor e zhvillimor dhe ruajtjen e monumenteve të natyrës.
-Vlerësimi i realizimit të treguesve të të ardhurave, shpenzimeve, mënyrës dhe saktësisë në pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare dhe rakordimit me thesarin.
- Hartimi i plan-menaxhimit dhe zbatimi i tyre,
-Puna për krijimin e të ardhurave dhe mbështetja institucionale për vendosjen e tarifave dhe infrastrukturës së nevojshme për realizimin e tyre.

- Vlerësimi i transparencës me publikun, krahasimi i rezultateve të veprimtarisë së institucionit midis viteve objekt i auditimit.
- Ballafaqimi dhe diskutimi i rezultateve të auditimit me personat përgjegjës.
- Përcaktimi i rekomandimeve në bazë të gjetjeve nga auditimi, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen, shlyerjen e dëmeve të mundshme ekonomike dhe parandalimin e veprimtarive të paligjshme dhe ruajtjen e vlerave natyrore e kombëtare të ZM.

6. Kriteret e vlerësimit:

Përcaktimet ligjore dhe rregullat e funksionimit të Administratës së Zonave të Mbrojtura Tiranë, normat dhe metodat e përcaktuara sipas kërkesave të ligjeve, akteve administrative, rregullores së institucionit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe database e kadastrave.

Në të gjitha fazat e auditimit sipas programit të detajuar, në përshtatje me Standardet e Auditimit, në referencë me problematikën është patur si kriter vlerësues në radhë të parë ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", - Ligjin nr.81/2017 datë 04.05.20217"Për zonat e mbrojtura"; VKM nr.102 datë 04.02.2015 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura"; Urdhri i Kryeministrit nr. 39 datë 12.03.2015, mbi "Miratimin e strukturës dhe Organikës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura"; Urdhrin nr.48,datë 29.03.2016,'Miratimin e strukturës dhe Organikës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura" i ndryshuar.

Në vlerësimin e mekanizmave të auditimit, janë marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

-llojet e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve të cilat mund të ndodhin;

-procedurat e mekanizmave të auditimi, që i shërbejnë parandalimit dhe zbulimit të këtyre gabimeve, të metave, parregullsive dhe shkeljeve;

-nëse janë miratuar procedurat e duhura dhe nëse niveli i respektimit të tyre, është i kënaqshëm;

-anët e dobëta të mekanizmave ekzistuese të auditimi, që çojnë në mos zbulimin e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve prej tyre;

-ndikimi që këto anë të dobëta kanë, dhe:

-shpërndarjen në kohë dhe intensitetin e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve.

Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik dhe Standardet duke përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë për zbatimin e ligjshmërisë së procesit të legalizimit dhe rregullshmërisë së veprimtarisë, konform me parimet, normat, rregullat dhe ligjet në fuqi.

7. Standardet e auditimit

Rregullorja e Brendshme "Mbi Organizimin dhe Funksionimin Administrativ të Kontrollit të Lartë të Shtetit", miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH, Nr. 85, datë 30.06.2015; Rregullorja e Brendshme "Për procedurat e auditimit të KLSH"; Udhëzimi i Kryetarit të KLSH nr. 1,datë 04.11.2016" Mbi Procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës, në auditimin e verifikimit zbatimit rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit"; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t" (ISSAI), "Standardet e Kontrollit të KLSH", "Manualeve" si dhe udhëzimeve dhe rregullave të nxjerra në zbatim të tyre.

8. Metodat e auditimit

Për arritjen e objektivave, audituesit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit dhe në procedurat analitike. Metodat e përdorura gjatë auditimit në arritjen e konkluzioneve janë:

a. *Metoda e ekzaminimit*: Kjo është një procedurë e cila ka shërbyer për të shqyrtuar të dhëna që lidhen me kryerjen e auditimit. Në këtë mënyrë, ajo që është vëzhguar dhe identifikuar të mund të testohet më tej. Vlerësimi ka përfshirë procedura testimi, si dhe gjykimin profesional të audituesve në lidhje me përshtatshmërinë dhe efiçencën e veprimeve.

b. *Metoda e ekzaminimit kryq*: Është përdorur kur është marrë informacioni për një ngjarje nga një burim i caktuar. Ky informacion është marrë dhe është krahasuar me një informacion të marrë për të njëjtat ngjarje, por me origjinë nga një burim tjetër. Kjo metodë është përdorur për të arritur nivelin e mjaftueshëm të besueshmërisë së përfundimeve.

c. *Metoda e intervistimit*: Është konsideruar si një nga metodat më të mira dhe më të përshtatshme të përdorura gjatë procesit të auditimit për të gjetur informacion të menjëhershëm. Duke qenë se kjo metodë kufizohet nga besueshmëria e evidencës së mbledhur gjatë përdorimit të saj, kjo metodë është përdorur për kontrollin dhe verifikimin e informacionit gjatë përdorimit të ekzaminimit kryq, ose forma të tjera si p.sh. caktimi i takimeve, intervistat me punonjësit e tjerë të institucionit, ballafaqimi midis punonjësve që kanë patur përgjegjësi në procesin e punës etj. Është intervistuar stafi menaxherial dhe operacional gjatë fazës së njohjes së aktiviteteve dhe proceseve të njësisë së audituar. Intervistat kanë ofruar një mundësi për parashtrimin e pyetjeve për sqarim të informacionit shtesë në bazë të përgjigjeve të dhëna. Audituesit kanë qenë të paanshëm dhe janë munduar të jenë sa më efektiv duke iu shmangur anshmërisë së informacioneve duke bërë pyetje të hapura (që kërkojnë përgjigje dhe shpjegime disi të gjera). Evidencat e auditimit që përftohet nga takimi janë mbajtur saktë dhe në mënyrë korrekte.

d. *Metoda e testimit të detajuar*: Audituesit kanë kryer ekzaminimin e dokumenteve të institucionit sipas objektivave të auditimit, dhe kanë marrë evidenca më të besueshme se sa intervistimt ose në mbështetje të informacioneve të mbledhura gjatë intervistimit.

9. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë dhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230"Dokumentimi i Auditimit".Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullores. Konkluzionet janë arritur duke u bazuar në rezultatet e procedurave të kryera dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe në çështjet e rëndësishme që dolën gjatë auditimit.

III-PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1.Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë kryen veprimtarinë në zbatim të ligjit nr.81/2017 "Për zonat e mbrojtura"; VKM nr.1189, datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit"; Ligjin nr.10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar; si dhe Urdhrin e Ministrit të Mjedisit nr. 129, datë 23.06.2016 "Për miratimin e procedurës së dhënies në përdorim me kontratë qiraje të sipërfaqeve të zonave të mbrojtura" vendime dhe udhëzimet tjera të dala në funksionim të ligjeve, ka për objektiv: Menaxhimin ruajtjen e zonave të mbrojtura mjedisore, parimi i zhvillimit të qëndrueshëm, menaxhimit të kujdesshëm, të burimet tokës,

përfshirë ajrin, ujin, florën dhe faunën. Integrimi i politikave të mbrojtjes së mjedisit në ato të zhvillimit ekonomik, ndërgjegjësimi ne popullatës ndaj florës, faunës , ndalimi gjuetisë të paligjshme në Zonë të mbrojtura. Monitorimin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura si dhe krijimin e përdorimin të ardhurave që realizon institucionit.

Pika. 2. Mbi administrimin e pronës shtetërore. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare. Inventarizimi i pronës shtetërore dhe regjistrimi në Zyrat e Pasurisë.

Për periudhën objekt auditimi nga Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë, në lidhje me aktivitetin e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor zonë e mbrojtur për kryerjen e aktiviteteve të lejuara në zbatim të ligjit 81/2017 "Për zonat e mbrojtura". Lidhja dhe zbatimi i kontratave është bërë në zbatim ligjit nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura", procedurat janë ndjekur në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Mjedisit nr. 129, datë 23.06.2016 "Për miratimin e procedurës së dhënies në përdorim me kontratë qiraje të sipërfaqeve të zonave të mbrojtura".

Në zbatim të nenit 58 dhe 57 të ligjit nr.81/2017, "Për Zonat e Mbrojtura" janë miratuar dy akte nënligjore: VKM nr .1156, datë 24.12.2020 "Për përcaktimin e të ardhurave të gjen eruara nga tarifat që paguhen në zonat e mbrojtura, të masës dhe kritereve të përdorimit të tyre". Dhe udhëzimi nr.1, datë 10.2.2021 i Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit "Për rregullat e përdorimit dhe të gëzimit të shërbimeve që ofron zona e mbrojtur mjedisore dhe pagimin e çmimit për to".

Në mbështetje të pikës 11, të VKM-së1156/2020 në datën 2 mars 2021, nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është kryer transferimi i të ardhurave të akumuluara në llogarinë jashtë thesarit në bankë te nivelit të dytë, me emërtimin "Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe kullotave, qe nga krijimi i AKZM-se, në llogarinë e të ardhurave të thesarit për AKZM, të cilat sipas këtij vendimi do të administrohen nga AKZM.

Këto të ardhura ishin kanalizuar nëpërmjet llogarisë së thesarit dhe do të përdoren nga AKZM si të ardhura jashtë limitit. Sipas lidhjes 1 të VKM-së janë miratuar 7 grupe tarifash për zonat e mbrojtura mjedisore. Tarifat e vendosura në VKM hyn ne fuqi në 1 shtator te vitit 2021.

Gjatë periudhës objekt auditimi 1 Janar 2019 deri më 31.12.2021, baza ligjore mbi të cilën janë lidhur kontratat për të ardhurat e krijuara në ZM janë bërë në zbatim ligjit nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura" procedurat janë ndjekur në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Mjedisit nr. 129, datë 23.06.2016 "Për miratimin e procedurës së dhënies në përdorim me kontratë qiraje të sipërfaqeve të zonave të mbrojtura", u evidentuan tre lloje burimesh të ardhurash:

-Të ardhura nga dhëniet e fondit me qira të zonave të mbrojtura.

-Të ardhura të krijuara nga hyrja e vizitorëve në postblloqet; Parku Dajt dhe Karavastasë Lushnjë.

Pika 2.1. Inventarizimi i pronës shtetërore dhe regjistrimi në Zyrat e Pasurisë.

Inventarizimi dhe regjistrimi i pronës shtetërore nga AdZM-Tiranë nuk janë të regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe janë të pa pajisur me certifikatë pronësie që ti administrojë AdZM-Tiranë, pa zona kadastrale si dhe nr. pasurie në kundërshtim me, neni 52 Pronësia mbi zonat e mbrojtura, sipas ligjit 81/2017.

Pika 1.2.-Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave.

Me Urdhrin e brendshëm të Titullarit nr. 15, datë 20.01.2020, të AKZM "Për kryerjen e inventarit të aktiveve në përdorim dhe administrim nga punonjësit e AdZM" janë ngritur komisionet për inventarizimin e aktiveve në AdZM në Qarqe.

Bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", komisioni i inventarizimit ka hartuar kartelat personale me aktivet në ngarkim, si pajisje zyre dhe automjetet në ngarkim të secilit punonjës.
Fletët e inventarit nuk janë të firmosura nga komisioni dhe sipas të dhënave të tyre kanë rezultuar diferenca ne kartelat personale.
Për periudhën objekt auditimi janë kryer inventarët e viteve 2019 dhe 2020, dhe 2021 nuk ka një urdhër nga AKZM për gjendjen faktike te vitit 2021, për këtë në AdZM nuk ka ardhur urdhër për kryerjen e inventarit të vitit 2021.
Ky veprim është në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12. 2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Kreu IV "Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve" pikat 73,74 ku citohet se "*Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar, si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me efecientë të tyre. Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me këtë udhëzim dhe me urdhër/udhëzim të miratuar nga titullari i njësisë publike* "dhe "*Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin aktiveve afatgjata materiale dhe jo materialë, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, në përmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës".*

Pika 1.3.-Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.

Sipas pasqyrave që disponon AdZM- Tiranë për vitin 2019 deri në fund të vitit 2021 nuk ka dokumentacion mbi inventarizimin e bazës materiale që disponon kjo administrate ne secilin vit ushtrimor te mbyllur dhe nuk ka as një urdhër nga titullari i studionit për te ngritur një grup pune për kryerjen e inventarit , megjithëse furnizimi dhe marrja e tyre dhe kontabilizimi i tyre kryet nga AKZM.
Në kartelat personale të Rojeve Mjedisore nuk na u paraqiten dokumentacion mbi mbjelljen, dorzimin e fidanëve pishe e zezë , pishe e butë dhe akacje me personat përgjegjës.
Ne pasqyrat e paraqitura si dhe kartelat personale te secilës zyre dhe personave përkatës konstatohet se ka mos përputhje dhe mos pasqyrim te sakte ne kartelat përkatëse, nga secili person përgjegjës nuk janë të firmosur kartelat e secilit inspektor, dhe nuk ka urdhër nga AZM për dhenien e dokumentacionit si dhe përgjegjësinë individuale te secilit punonjës nga ish /Drejtori Z.D.
Gjendja e inventarit paraqitet si me poshtë pasqyra nga AdZM-Tiranë.

Nr.	**Vitet**	**Gjendja sipas viteve**	**Nr kronologjik sipas pasqyres**
1	**2019**	**140,976,817**	**92**
2	**2020**	**144,704,769**	**96**
3	**2021**	**147,327,816**	**101**

Pra në secilën kartele të punonjësve nuk hidhen saktë të dhënat dhe kontabilizimi i tyre nuk përputhet me kartelat me diferenca dhe mos pasqyrim te tyre, nuk ka kartela te mbyllura ose te transferuara në

personat e tjerë te cilët janë larguar nga puna si dhe kalimin e tyre te bazës materiale punonjësit pasardhës.

Sipas kartelave te paraqitura konstatojmë si me poshtë pasqyra e inventarit në dhjetor 2020:

Nr	Personi	Gjendja kontabilizuar	Nr.Kronologjik sipas karteles
1	I.Sh	567.656	11
2	E.J, N.V, J.T	337.598	8
3	O.B,E.K	4.334.726	9
4	H.D,K.S	4.654.900	11
5	M.L	1.036.369	2
6	A.B+ Adzm	72.115.334	1
7	R.K	16.046	1
8	Sh.I	18.973	2
9	E.K,O. B,A.N	4.322.326	9
10	H.D,K.S, NK	4.580.420	11
11	AdZM	1.204.032	3
12	G.T. (Postobllok)	4.690.023	28
13	E.D.	55.768.686	22
	Totali	153.647.089	118

Pra dokumentacioni i inventarit është formal dhe i pa kontabilizuar sakte me diferenca ne kartelat personale sipas pasqyrave dhe të pa firmosura nga dorëzuesi dhe marsi ne dorëzim rezulton se në vitin 2021 gjendja kontabilitetit është 153,647,089 lekë, pra me diference të pa kontabilizuar ne **17 artikuj në vlerë 6,319,273 lekë.**

Nga auditimi i 20 dosjeve**,** për kontratat e lidhura midis subjekteve dhe ADZM, për sipërfaqet e zonave mbrojtura te marra me qira**, u konstatuan disa te meta, mangësi dhe te ardhura munguara** për vlerën **1,955,991 leke,** për periudhën e vitit 2019, 2020 dhe 2021, konkretisht:

<u>Ne mënyre te përmbledhur</u>:

I. Nuk janë regjistruar pranë ASHK Tirane, sipërfaqet e zonave te mbrojtura, nga Administrata e zonave të mbrojtura Tiranë (ADZM), ne kundërshtim me nenin 55 *"Regjistrimi i sipërfaqeve zonave mbrojtura*" te ligjit 81/2017 "*Për zonat e mbrojtura*".

II. Nuk ka asnjë listë mbi ndërtimet e paligjshme në këto zona mbrojtura nga ADZM Tiranë përkatësisht: Pk "*Mali i Dajtit*", Pk "*Mali me Gropa-Bizë-Martanesh*", Pk "*Divjakë-Karavasta*" dhe fshatrat tjera, pasi në këto zona ka ndërtime pa leje, të cilat janë vet deklaruar nga subjektet pranë ASHK Tiranë dhe ASHK Lushnjë, për aktivitete ekonomiko-financiare dhe shtëpi banimi (*ndërtuar para daljes ligjit 81/2017 dhe mbas daljes tij).*

III. Ne 20 raste, dosjet e subjekteve rezultojnë pa inventarë, pa numërimin te dokumenteve, pa marrës dhe dorëzues, për periudhën 2019-2021, për sipërfaqet e zonave mbrojtura te marra me qira**,** në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

III. Ne 2 raste, ne zonën mbrojtur "*Parku Kombëtar Dajt***"** jashtë kritereve ligjore janë **legalizuar 3 ndërtime pa leje** dhe janë pajisur me certifikate pronësie **nga ASHK 1 Tirane** për vitet 2019-2020-

2021**,** ndërsa **nga ADZM me miratim te AKZM u është dhëne subjekteve edhe sipërfaqe tjera për rreth ne përdorim**, ne kundërshtim me ligjin nr. 81/2017 "*Për zonat e mbrojtura*", neni 2 dhe 16/2/a *"Parku Kombëtar"*, me kushtet e kualifikimit te ndërtimeve informate ne ZM për legalizim, nenin 35 te ligjit ALUIZNI i ndryshuar, me kreun II/ë te VKM 756, me ligjin 20/20 date 05.03.2020 "*Për përfundimin e proceseve kalimtare pronësisë ne RSH",* me vendimit nr. 408 date 13.05.2015 "*Për miratimin e rregullores se zhvillimit territorit",* me planin vendor të miratuar pasi zona ku ndodhet objekti nuk përcakton për ndërtime, por për aktivitete social–kreative, me Kodin Civil, pika 19, me kreun II/ë te VKM 756, me VKM 1040 date 25.11.2020 *"Për përcaktimin rregullave zbatimit kritereve legalizimit dhe miratimin modelit legalizimit, për ndërtimet pa leje",* pika 18/ë, përkatësisht:.

** ndërtesa 2-kat kombinuara, legalizimi Gusht 2019**,** certifikata pronësie 17.12.2019, për 2 ndërtesa ne emër A.K, pasuria 184-ND dhe 184 ND1, ZK 2380, vol 11, faqe 59-60, sipërfaqe 384 + 33 m2 dhe kontrate qiraje 51 date 13.05.2019 për sipërfaqen 10,800 m2.*

****** *ndërtesa 274 m2, godine social-ekonomike 1-kat dhe 2-kat, legalizimi 29.06.2020 dhe certifikata pronësisë 10.09.2021 ne emër Sh.A, si dhe kontrata qirasë 110/4 date 17.12.2021**,** për dhënien ne përdorim te sipërfaqes 10,994 m2 se zonës mbrojtur.*

IV. Ne 1 rast, është dhëne ne përdorim ne zonën e mbrojtur "*Parku Kombëtar Dajt* , sipërfaqja 1200 m^2 me afat kohor 49 vite, *me status juridik* **"***livadh dhe shkëmb*", ndërsa **ne thyerje te këtij kushti kjo sipërfaqe ka kaluar ne pronësi te subjektit,** sipas vërtetimit hipotekor date 25.04.2018 te ZRRPP Tirane *(para periudhës nen auditim*).

V. Dokumentacioni i dosjeve te subjekteve, **për sipërfaqet e marra me qira ne zonat e mbrojtura, ne disa raste paraqet mangësi** konkretisht:

a. ***mandat arkëtimet*** për likuidimin e tarifave qirasë vjetore nga subjektet ***janë fotokopje, ne vend te origjinaleve***, ***madje ne 1 rast e palexueshme,*** në kundërshtim me nenin 119 *"Pavlefshmëria e aktit"* te Kodit Civil ne RSH, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik* ", pika 36.

b. ***mungojnë dokumentet për penalitetet*** për ditë vonesat në pagesën e qirasë, sipas kushteve kontraktore për rrjedhoje nuk ka asnjë arkëtim te tyre.

c. ***mungojnë akt verifikimet ne terren, lidhur me respektimin e ndërtimeve prej druri*** te çmontueshme dhe provizore, ose ***nëse ato kane përbërje muri dhe beton***, ne kundërshtim me kërkesat ligjore dhe kushtet e kontratave.

d. ***mungon dokumentet qe vërteton respektimin e sipërfaqes zëne,*** sipas kontratave lidhura,

e. ***mungon dokumentet për rehabilitimin e zonës mbrojtur ne përfundim te afatit te kontratave.***

k. ***mungon dokumentet përfundimtare qe pasqyrojnë sipërfaqet ndërtimore te objekteve (****akt kolaudimi, akti terrenit etj)****,*** kriter baze për përllogaritjen e tarifës qirasë, Pra për vërtetimin e sipërfaqeve te objekteve nuk disponohet asnjë dokument përfundimtar me nënshkrimin e specialistit licencuar, ne vend qe te detyrohej subjekti ti paraqesë ato ashtu siç ka paraqitur dokumentet fillestare, njëkohësisht dhe ADZM nuk disponon dokumente për sipërfaqet ndërtimore te objekteve.

l. ***mungon dokumenti qe te shprehet pushteti vendor*** për këto objekte, ndryshe nga rastet tjera qe disponohet pëlqimi i bashkisë, njësisë ose kryeplakut fshatit, konkretisht:

Për parcelën e ZM 0,35 ha marre ne përdorim nga G.L nuk ka dokument ku te shprehet mendimi i pushtetit vendor, nëse kjo pjese e zonës mbrojtur dhëne ne përdorim preket nga projekti madhor i rrugës "Arbrit", ne fakt ajo preket ku sipërfaqja 1900 m2 e zëne nga rruga dhe është kompensuar me

miratim ne një vend tjetër për interes publik nga AKZM. Pra kontrata baze nuk duhej lidhur ne këtë zone, pasi rruga e Arbrit kishte nisur dhe kalonte neper këtë parcele.

VI. Ne 3 raste, **padrejtësisht është shtyre afati i kontratës nga 5 vjet ne 10 vjet pa mbaruar afati 5 vjeçar i saj, ne vend qe te shtyhej 3 muaj para mbarimit te afatit kontratës 5 vjeçare,** ne kundërshtim me nenin 3, pika 3.1 dhe 3.2 te kontratave përkatëse, *ndërsa ne 1 rast nuk është miratuar shtesa e afatit kontratës, pra me 2 standarde,* konkretisht:
** Ne kundërshtim me kërkesat e kontratës 49/3 date 24.08.2020, neni 4, është shtyre afati i kontratës nga 5 vjet ne 10 vjet (2021-2031, sipas shtesës kontratës nr. 96 date 20.08.2021, pasi duhej shtyre 3 muaj para mbarimit te kontratës 5 vjeçare (2020-2025), subjekti G.M.*
** Ne kundërshtim me nenin 3, pika 3.1 dhe 3.2 te kontratës 55/3 date 13.11.2020 neni 4 është shtyre afati i kontratës nga 5 vjet ne 10 vjet (2021-2031), sipas amendamentit 2 date 20.10.2021, pasi duhej shtyre 3 muaj para mbarimit kontratës 5-vjeçare (2020-2025), A.Sh.*
** Ne kundërshtim me nenin 3, pika 3.2 te kontratave 35/3 date 14.09.2020 dhe 30/6 date 21.07.2021, pa mbaruar afati 5-vjeçar i kontratës është shtyre afati kohor nga 5 vjet qe ishte ne 10 vjet (2021- 2031), sipas amendamentit 2 date 13.09.2021, subjekti D.P..*
- Disponohet kërkesa e subjektit E.K 35/1 date 27.04.2021, për zgjatje afati nga 5 vjet ne 10 vjet te kontratës, e cila nuk është miratuar, sipas shkresës 35/3 date 21.05.2021 te AKZM.

VII. Në 1 rast, pa baze ligjore ADZM ka lidhur 4 kontrata e amendamente *(2020-2021),* **ne vend te 1 kontrate,** kështu **duke ndryshuar** dhe **shtuar sipërfaqet me qira** *(nga 1,3 ha ne 33,8 ha dhe 47,3 ha)* ne zonën e mbrojtur "*Parku Kombëtar Mali Dajtit*", madje kontrata e fundit është nënshkruar padrejtësisht nga përgjegjësi i menaxhimit ne vend të drejtorit ADZM.

VIII. Në disa raste paraqiten vonesa ne mbajtjen e Amendamenteve te kontratave baze, për ndryshimet ligjore te tarifave qirasë vjetore, sipas VKM 1156 date 24.12.2020, lidhja 1, **ne vend qe te mbahen ne momentin e zbardhjes aktit ligjore**, ne mënyre qe subjektet te likuidojnë ne kohen e duhur detyrimet e qirasë për sipërfaqet e marra përdorim.

IX. Të ardhurat për periudhën 2019-2020-2021 sipas raporteve vjetore nuk janë zbërthyer analitikisht. Raporti vjetor nuk ka analize te faktorëve qe kane ndikuar ne mosrealizimin e te ardhurave për sipërfaqet me qira, madje nuk identifikohen emrat e subjekteve debitorë, por është mjaftuar me terma përgjithshme pa emra konkret dhe pa përgjegjësi te askujt. Kështu nuk ka plan vjetor te ardhurave, për efekt krahasimi me faktin e realizuar:
*- Për vitin **2019** subjektet debitorë për sipërfaqet me qira paraqiten 631,533 leke**,** por nuk përcaktohen emrat e subjekte dhe numri i tyre. Gjithashtu nuk përcaktohen te ardhurat e planifikuara vjetore, për efekt krahasimi me realizimin e tyre.*
*- Për vitin **2020** te ardhura nga 35 kontratat e lidhura (progresive) për sipërfaqet ne përdorim me qira paraqiten 3,215,036 leke, por nuk pasqyrohen subjektet debitor**.** Gjithashtu nuk pasqyrohen te ardhurat e planifikuara sipas kontratave përkatëse etj.*
*- Për vitin **2021** te ardhura nga 42 kontratat e lidhura (progresive) për sipërfaqet ne përdorim me qira paraqiten 6,146,970 leke, por nuk pasqyrohen subjektet debitor**.***

X. Ne 11 raste, për vlerën 1,955,991 leke nuk janë shlyer detyrimet e kontratave për qiranë objekteve *(për sipërfaqet ndërtimore te bar-restorante, kabina druri etj)* **mbi zonën e mbrojtur.**

Tabela përmbledhëse sipas subjekteve qiramarrëse debitorë, per vitin 2019, 2020, 2021:

Nr.	Emër Mbiemër	Detyrime qiraje 2019-2020-2021
1	K.D	100,300
2	B.H	207,825
3	E. K	90,000
4	A.Sh	55,011
5	G. L	80,000
6	A.K	118,000
7	A.E	32,337
8	A.D	191,500
9	"T-E" shpk	333,333
10	" D-P " shpk	227,685
11	" H " shpk	520,000
SHUMA		**1,955,991**

Drejtoria e Menaxhimit dhe Monitorimit të projekteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme, nuk kane ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e detyrimeve të subjekteve që nga lidhja e kontratave për marrjen në përdorim të sipërfaqeve në zonat e mbrojtura, ne të kundërt nuk kane kërkuar në rrugë ligjore prishjen e kontratave, siç ka vepruar ne 1 rast.

1.Titulli i gjetjes: Mos kryerja e inventarëve të vitit 2021 dhe mos hedhja sakte e materialeve në kartelat personale te punonjësit.
Situata: Për periudhën objekt auditimi janë kryer inventarët e viteve 2019 dhe 2020, por ende nuk është kryer inventari i vitit 2021, për këtë në AdZM nuk ka ardhur urdhër për kryerjen e inventarit të vitit 2021 nga AKZM.
Kriteri: Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
Pasaktësi në pasqyrat financiare
Ndikimi/efekti: Pasaktësi në pasqyrat financiare
Shkaku: Mos zbatim i legjislacionit.
Rëndësia: E mesme

Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë të marrë masa për kryerjen e inventarëve brenda afateve të përcaktuara në respektim të kritereve dhe kërkesave ligjore, me qëllim kontrollin e menaxhimin e aktiveve të njësisë, për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të tyre dhe pasqyrimin e drejtë të gjendjes në pasqyrat financiare brenda afateve ligjore.

Pika 2.Auditim mbi zbatimin e ligjshmërisë në monitorimin e mjedisit dhe zbatimi i procedurave të vetë monitorimit.

Në administratën e Zonave të Mbrojtura Tiranë, nuk ka asnjë listë mbi ndërtimet e jashtëligjshme të ndërtuara në këto zona, Parkun Kombëtar "Mali i Dajtit", pjesa kadastrale "Mali me Gropa-Bizë-Martanesh", Pk "Divjakë-Karavasta" si dhe fshatrat e tjera që janë të regjistruara në zonat e mbrojtura, ku rezulton se në këto zona ka ndërtime për aktivitete ekonomiko-financiare si dhe shtëpi banimi të ndërtuara në këto zona para daljes së ligjit Nr.81/2017 si dhe mbas daljes së këtij ligji të sipër përmendur. Bashkëpunimi ndërinstitucional nuk ka funksionuar dhe nuk është kërkuar vetdeklarimet e këtyre objekteve ekonomiko-financiare si dhe shtëpi banimi të cilat rezultojnë të jenë vetdeklaruar pranë **ASHK Tiranë** dhe **ASHK Lushnjë** për të kryer monitorimin si detyrë funksionale e AdZM Tiranë.

Nga veprimtaria e AdZM-Tiranë nga 2019 deri në vitin 2021 janë mbajtur gjithsej 40 proces verbale, në vitin 2019 janë mbajtur 18 proces verbale konstatimi, në vitin 2020 janë mbajtur 12 proces verbale ne vitin 2021 janë mbajtur 10 proces verbale konstatimi.

Në të gjitha rastet e konstatuara kanë qenë vetëm evidente dhe pa ndjekje procedurash dhe marrje informacioni mbi procedurat e tjera nga ISHMP, proces verbalet janë firmosur vetëm nga një punonjës, fletët e proces verbaleve të pa sekretuar dhe të pa vulosura dhe pa ciklimin përkatës së sasisë së tyre "Rast pas rasti po i evidentojmë dhe po i paraqesim në material" në mënyrë të përgjithësuar rezulton :Nga informacionet e mara nga AdZM- Tiranë rezulton se janë mbajtur gjithsej 40 proces verbale nga viti 2019-2021, nga këto rezulton se 32 raste janë shënimet "i pa identifikuar" ose 80% e proces verbaleve janë pa autor dhe " **zbatimi dhe rruajtja e zonës së mbrojtur nuk ka qene efektive"** , në 19 raste të rrënjës se zjarrit ne sipërfaqen totale 143.8 ha nuk ka as një autor mbi dëmtimin nga zjarret ne zonat e mbrojtura por janë mjaftuar me një proces verbal konstatimi , gjithashtu theksojmë dhe ne dëmtimin dhe rruajtjen e faunës ne këto zona ka pasur dëmtime dhe prerje te bimësisë në këto zona në 21 raste të konstatuara janë prere 960 cope dru lis, ah dhe pisha dhe 400 m^3 dru "Shkurre " nga veprimet e kryera konstatohet se janë mbajtur proces verbale me dimensionet e trungjeve te mbetura ne zonat e mbrojtura dhe nga këto është vërtetuar se vetëm 8 prej tyre u dihet autori ndërsa 13 janë pa autor (shif pasqyrën si me poshtë e cila nuk është mbajtur kronoligjikisht te gjitha te dhënat mungojnë personat përgjegjës dhe numrat serialë te proces verbaleve të konstatimit)

Nr.	Vitet	Proces verbalet e kostatimit
1	2019	18
2	2020	12
3	2021	10
	Totali	**40**

Shif- (Aneksi 1,2 i kundërvajtjeve) bashkangjitur Projekt Raportit

Pra sipas pasqyrave dhe informacioneve të mara nga AdZM- Tiranë rezulton se janë mbajtur gjithsej 40 proces verbale nga viti nga këto rezulton se 32 raste janë shënimet "i pa identifikuar" ose 80% e proces verbaleve janë pa autor dhe " **zbatimi dhe rruajtja e zonës se mbrojtur nuk ka qene efektive"**, në **19 raste të rrënjës se zjarrit** në sipërfaqen totale 143.8 ha nuk ka as një autor mbi dëmtimin nga zjarret ne zonat e mbrojtura , " N**uk ka as një mase për Rojet Mjedisore në Malin e Dajtit** nga **Sektorin e Monitorimit" për mos ndjekjen dhe zbulimin e zjarrvënësve ne Zonën e Mbrojtur nga rroje e zonës Mbrojtur,** por janë mjaftuar me një proces verbal konstatimi, gjithashtu theksojmë dhe në dëmtimin dhe rruajtjen e faunës ne këto zona ka pasur dëmtime dhe prerje të bimësisë në këto zona në 21 raste të konstatuara janë prere **960 cope dru** lis, ah dhe pisha dhe 400 m^3 dru "Shkurre " gjithashtu theksojmë se në proces verbale për prerjet e drurëve ,ahore, lisa e pisha me dimensionet e trungjeve te mbetura ne zonat e mbrojtura, vetëm 8 prej tyre u dihet autori ndërsa 13 janë pa autor.

Sipas auditimit mbi punën e kryer nga Sektori i Monitorimit ,gjatë vitit 2019-2021 megjithëse nga inspektorët janë informuar se janë prerë pyje në zonat e mbrojtura të tipit ah, pishë dhe shkurre të cilat janë bërë konstatime me përshkrimin "pa autor" janë mbajtur proces verbale dhe akt konstatime , ne te gjitha rastet konstatohen "se mbas kryerjes se veprimit nga kundërvajtësit janë kryer veprimet "**nga titullari i institucionit nuk ka as një mase dhe nxjerrje përgjegjësi për rojet të cilët mbulonin këto zona**(shif pasqyrat si më lart të proces verbaleve te kryer nga viti 2019 deri në vitin 2021).

Në proces verbalet e mbajtura nga inspektoret e monitorimit të zonave të mbrojtura konstatohet se lëvizja e rojeve te ZM, nuk ndiqen procedurat sipas ligjit , nuk na u paraqiten dokumente te protokolluara , për marrjen ne dorëzim te blloqeve te proces verbaleve te konstatimit , te cilat janë te pa cikluara , te pa vulosura dhe mbas mbarimit nuk dorëzohen pranë AZM , duke u konsideruar këto si "Letra me vlerë", pra me veprim edhe mos veprime janë në kundërshtim me ligjin 10296 date 08.07.2010 (me ndryshime) si dhe ne VKM ,nr.30 (pika 34 (dokumentimi i lëvizjes se aktiveve) .

Konkretisht mbi mbajtjen dhe administrimin e Proces verbaleve te konstatimit të tyre rezulton se proces verbalet janë konstatues dhe nuk është marrë as një ndjekje e procedurave te mëtejshme ne disa raste janë te dukshme dhe jo argumentuese nga rroje e Zonave te mbrojtura për veprime e kryera ne këto zona si psh:

Në proces verbalin e datës 16.10.2020 "gërmim dheu 1300 m^2 ,nuk u paraqit as një mase për rrojën e zonës mbrojtur pasi vizualisht është e dukshme qe 1300 m^2 gërmime nuk mund te kryen brenda një dite dhe tregon se nuk ka funksionuar si duhet veprimtaria e sektorit te monitorimit ,ose rasti i prerjeve të shkurreve 400 m^2 etje.

Në proces verbalet e konstatimit të mbajtur nga Roja Mjedisore F. K. " **i larguar me Urdhrin nr.278, datë 11.11.2019** " me nr. serial 00055584 deri 0005590 konstatojmë se janë mbajtur gjithsej **7 proces verbale** të pa vulosura të pa sekretuara, mbajtur vetëm nga një inspektor, pa shënimet përkatëse mbi nr. e përgjithshëm të proces verbaleve të mara në dorëzim. Pavarësisht firmave të mara nga përgjegjësi i Sektorit të Monitorimit i cili ka marre firmat e secilit inspektor për marrjen në dorëzim të bllokut të proces –verbaleve të konstatimi, në proces verbale e mbajtura nga inspektori konstatojmë se:

1- Proces verbale janë të firmosur vetëm nga roja mjedisore F.K "Një inspektor i vetëm".
2- Nuk ka të identifikuar emrin e kundra vajësit dhe as një dëshmitar.
3- Nuk ka të bashkangjitur dokumente mbi dorëzimin e drurëve të prera por vetëm një nr. tel ISHMP dëmtimin e drurëve.
4- Ne te gjitha rastet e konstatuara nuk ka autor dhe identifikim mbi dëmtimin e zonave te mbrojtura.
5- Në proces -verbalet e konstatimit ne as një rast nuk kane nxjerre vlerën e demit te shkaktuar nga kundërvajtësi.

Nga inspektori A.B nuk ka proces verbal të dorëzimit të zonës se mbrojtur nga ish inspektori F.K dhe marrjes ne dorëzim të Zonës Mbrojtur dhe të protokolluar.

Në të gjitha rastet e mbajtjes se Proces-Verbaleve të Konstatimin e Kundërvajtjeve në Zonat e Mbrojtura konstatohet se deri ne Mars të vitit 2021 në kontravajtjet e konstatuara nga Rojet Mjedisore ka praktikuar si model njoftimin e inspektoreve të ISHMP- me një numër tel ndërsa mbas Marsit nuk ka as një njoftim, por informohet AdZM- Qarkut " Përgjegjësi i Sektorit te Monitorimit z. K.S" (shih- Proces-Verbaleve te Konstatimin e Kundërvajtjeve në Zonat e Mbrojtura" si me poshtë:)

Adresa: ... MBROJTURA Tiranë

PROÇES - VERBAL
PËR
KONSTATIMIN E KUNDRAVAJTJEVE NË ZONAT E MBROJTURA

I mbajtur sot me datë 13.06.2021 nga Agim Bala me detyrë Roja mjedisore pranë Administratës Rajonale e Zonave të Mbrojtura Tiranë, nga Kotrtrolli që ushtrova në ngastrën nr. 40, zonimi Tradicional, ekonomia pyjore Shkollë Zona e Mbrojtur I.K. Malit Dajtit, ose në vendin e quajtur Rezervat.

KONSTATOVA

Shtetasi _____ i biri _____ i lindur në _____ i datëlindjes _____ banues _____ duke shkelur dispozitat e Ligjit Nr. 8906, datë 06.06.2002 "Për zonat e mbrojtura", i ndryshuar, Nr. 9385, datë 04.05.2005 "Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor" i ndryshuar, Ligji Nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për Fondin Kullosor", Ligjit Nr. 10253, datë 11.03.2010 "Për gjuetinë", Ligjit Nr. 10006, datë 23.10.2008, " Për mbrojtjen e faunës së egër "si dhe të Ligjit Nr. 9587, datë 20.07.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit", i ndryshuar me Ligjin Nr. 68/2014, ka kryer konkretisht:

Gjatë monitorimit në zonën e mbrojtur ekonomia pyjore Shkollë u konstatua që në vëllim e grupitur të rezervat u gjend material drusuë: prerë cp 33 me ϕ 8-10cm 15 cpë ϕ 10,1-20cm 24 cpë, mesatarisht gjëmbë me vend.

Nr	Përshkrimi i dëmit	Njësia e matjes	Sasia	Volumi (mst/m³)
1	ϕ 8-10 cm pay. drusët lëg. lis	cp	15	0.715 m³
2	ϕ 10,1-20cm pay. drusët lëg. lis	cp	24	3.964 m³
			39	
			Shuma	4.697 m³

Në lidhje me dëmin e kryer (Shpjegim i detajuar) nëse kapet kundravajtësi në flagrancë:

Për këtë shkelje është njoftuar: Përgjegjësi i Monitorimit i AdZM-së së Qarkut Tiranë z. Kostiot Shqepsi dhe Përgjegjësi i Sektorit të Policisë Pyjore, ISHMP-së së Degës Rajonale të Qarkut —, Z. — me numër telefoni _____

Ky proçes - Verbal hartohet në 4 kopje, një kopje i jepet kundravajtësit, një kopje në AdZM të Qarkut Tiranë, një kopje dërgohet ISHMP-së, një kopje dërgohet në AKZM-në pranë Zyrës së Monitorimit.

KUNDRAVAJTËSI **DËSHMITARËT** **ROJA MJEDISORE**

Agim Bala



0005597

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

AGJENCIA KOMBËTARE E ZONAVE TE MBROJTURA
ADMINISTRATA E ZONAVE TË MBROJTURA Tiranë
Adresa:

PROÇES - VERBAL
PËR
KONSTATIMIN E KUNDRAVAJTJEVE NË ZONAT E MBROJTURA

I mbajtur sot me datë 14.08.2021 nga Agim Bala me detyrë Roja mjedisore pranë Administratës Rajonale e Zonave të Mbrojtura Tiranë, nga kotrtrolli që ushtrova në ngastrën nr. 42, zonimi Pyjor, ekonomia pyjore Shkallë Zona e Mbrojtur A.K. "Mali i Dajtit", ose në vendin e quajtur _____.

KONSTATOVA

Shtetasi Islam Bajri i biri Islam i lindur në — i datëlindjes — banues Qf. mullë duke shkelur dispozitat e Ligjit Nr. 8906, datë 06.06.2002 "Për zonat e mbrojtura", i ndryshuar, Nr. 9385, datë 04.05.2005 "Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor" i ndryshuar, Ligji Nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për Fondin Kullosor", Ligjit Nr. 10253, datë 11.03.2010 "Për gjuetinë", Ligjit Nr. 10006, datë 23.10.2008, " Për mbrojtjen e faunës së egër "si dhe të Ligjit Nr. 9587, datë 20.07.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit", i ndryshuar me Ligjin Nr. 68/2014, ka kryer konkretisht:

Me të marrë njoftimin nga ana e policisë së shtetit konstatohet se janë prerë pyjore me flagrancë të shtetasve të lartpërmendur, veçia në vendngjarje atë kohë verifikimin me lejen dhe regullat ze prerë prerë 32 (gjashtëdhjetë e dy) copë bimë druri me lartësi me ligjin e zonave të mbrojtura dhe në bazë të V.K.M. nr 128 datë 13.02.2020. Horizontet pyjore-vetëm i konstatimit

Nr	Përshkrimi i dëmit	Njësia e matjes	Sasia	Volumi (mst/m³)
1	Trajë druri φ 2,1- 10 cm	Cop	12	
2	Trajë druri φ 10,1- 22 cm	Cop	10	
3	Trajë druri φ > 22 cm	Cop	10	
	Shuma:		32	

Në lidhje me dëmin e kryer (Shpjegim i detajuar) nëse kapet kundravajtësi në flagrancë:

Për këtë shkelje është njoftuar: Përgjegjësi i Monitorimit i AdZM-së së Qarkut Tiranë z. Kostiut Shqyri dhe Përgjegjësi i Sektorit të Policisë Pyjore, ISHMP-së së Degës Rajonale të Qarkut —, Z. — me numër telefoni —

Ky proçes - Verbal hartohet në 4 kopje, një kopje i jepet kundravajtësit, një kopje në AdZM të Qarkut —, një kopje dërgohet ISHMP-së, një kopje dërgohet në AKZM-në pranë Zyrës së Monitorimit.

KUNDRAVAJTËSI DËSHMITARËT ROJA MJEDISORE

Agim Bala

Pra konstatojmë se nuk ka pa pasur as një dokument tjetër argumentues mbi ndjekjen e procedurave ligjore të kundërvajtësve.

Në detyrat funksionale në monitorimin e zonave të mbrojtura rezulton se: Sipas shkresës me Nr. 10. prot.dt.02.01.2019 gjatë detyrave funksionale të kryera në Pk "Mali Dajtit" Ekonomia Pyjore "Shkallë", ngastra nr.39 në datë 23.01.2019 janë konstatuar prerje të paligjshme të **105 drurëve** të llojit shkozë dhe lis.

Ne dokumentacionin e paraqitur konstatohet se në proces verbalin me nr. serial -0005584 të mbajtur nga roja mjedisore inspektori F. K., nuk ka fletë hyrje ose fletë dalje, si dhe asnjë dokument dorëzimi ISHMP por janë mjaftuar vetëm me një nr. tel të inspektorit të ISHMP të Degës Rajonale Tiranë.

Blloku me nr. serial 0005491 administruar nga inspektori i AdZM M. L. proces-verbale konstatimi 29 Proces-verbale konstatimi i administruar nga viti 2016 deri ne vitin 2020 blloku i pa cikluar, për numrin e fletëve dhe sasinë e proces-verbaleve nuk ka as vule, as nënshkrim nga titullari, nuk ka dokument dorëzimi nga inspektori, nuk ka as një vule nga istucioni përkatës, nuk janë ndjekur procedurat e hyrje daljes të bllokut të marrë në dorëzim dhe flet fyerjen në magazine mbas mbarimit të bllokut të konstatimeve.

Ne të gjitha rastet konstatohet se janë kryer vetëm konstatime në ZM për zona të djegura, për drurë të prerë me sasitë përkatëse, por nuk ka asnjë dokument dorëzimi ose "fletë hyrje dalje" konkretisht:

- Proces verbali me nr. Serial 0005520 janë konstatuar prerje pa autor sasia 9 copë, me dimension 50 cm në vendin Shkallaqë Kuqe Martanesh, nuk ka asnjë dokument njoftimi, nuk ka fletë hyrje ose dalje të mallit. Në procesverbal përshkruhet se është njoftuar përgjegjësi i Monitorimit të AdZM, z. K S.

Pra konstatojmë se funksionimi dhe bashkëpunimi i AdZM dhe ISHMP nuk ka qenë në nivelin e duhur dhe nuk ka dokumentacion shoqërues mbi hyrjet daljet e drurëve te zjarrit ah, pisha dhe shkure veprim në kundërshtim me ligjin 10296 date 08.07.2010 (me ndryshime) si dhe ne VKM ,nr.30 (pika 34 (dokumentimi i lëvizjes se aktiveve).

Në bllokun me nr. serial 0005581 deri në nr. 0005610 të marrë në dorëzim nga inspektori F.K dhe kaluar inspektorit A.B konstatohet se në procedurat e ndjekura nuk janë në përshtatshmëri me ligjin dhe nuk ka ndjekje te procedurave dhe konkretisht të dorëzimit dhe marrjes në dorëzim të proces verbalit nga një inspektor tek marrja në dorëzim e inspektorit A.B konstatojmë:

Nga blloku i inspektorit M.L në bllokun me nr. serial 0005491 deri 0005520 gjate vitit 2019 janë mbajtur 5 proces verbale konstatimi 2 prerje drurë ahu dhe 2 nga rrënja e zjarrit te gjitha pa adresë dhe pa ndjekje procedurash vetëm me një njoftim me nr. tel. ISHMP.

Sipas rasëtëve konstatojmë se nga 9 mujori, i vitit 2021 veprimet janë kryer formale, pa njoftuar istucionet e tjera, dhe pa mare masa administrative për dorëzimin nga ana dokumentare te kundërvajtjes

Pra konstatohet se nuk ka standarde dhe kritere mbi përcaktimin e sipërfaqes parkut natyror në ha që duhet të mbulojë një punonjës i AdZM si roje mjedisore, punonjës i menaxhimit dhe punonjës i monitorimit në vartësi llojit të parkut natyror kombëtar, faunës dhe florës në përbërje të saj, terrenit, shtrirjes së tij, etj, nuk ka ndjekje dhe dokumentacion për secilin rast të konstatuar me proces verbal dhe dokumentacion deri ne mbarimin e plote të procedurave .
-Nga verifikimi i dokumentacionit të adresuar nga Agjencisë Kombëtarë të Zonave të Mbrojtura drejtuar AdZM- Tiranë mbi problematikave e hasura në ndërtimin e objekteve për banim dhe aktivitete social- ekonomik e financiar në Zonë e mbrojtura është kërkuar informacion mbi përshtatshmëri me ligjshmërinë e këtyre objekteve, nëse janë në Zonë e mbrojture për të vazhduar procedurën e legalizimi ose në rrasëte " kur janë në kundërshtim me VKM nr.280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kritereve,

procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtime pa leje, shtesave anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje", i ndryshuar me VKM nr.756 datë 26.10.2016 dhe ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002 "Për zonave te mbrojtura", i ndryshuar, neni 9, pika 3, neni 5, pika 2 dhe neni 19 si dhe ne kundërshtim ne neni 9 pika (ç) dhe (F) ,neni , ligjin Nr.81/2017 si me poshtë konstatojmë:
Sipas te dhënave nga AZM kane marre informacion nga AdZM-Tirane shkresat te cilat nuk janë te protokolluara si dhe nuk kishin te paraqitur dokumentet argumentues ligjore si me poshtë:

* Në shkresën me nr.6649 Prot. Datë 22.09.2020, e protokolluar ne AKZM me nr.6319 Prot. datë 23.09.2020, ku kërkohej informacion nga istucioni përkatës nga AdZM për ndërtimin e një objekti i ndërtuar në zonën e mbrojtur Dajt – Tiranë të verifikuar nga specialistet e AdZM ku përshkruhej se "Objekti ndodhet në zonën e mbrojtur kategoria e II e shpallur sipas VKM. 402,datë 21.06.2006 të nderuar objekti nga z. M.S.D .
Në përgjigjen e dhënë me nr.994/1Prot. datë 09.10.2020 është shprehur pozitivisht për legalizimin e objektin të ndërtuar, nuk përben pengesë për vazhdimin e procedurave të legalizimin të shtesës së objekti, që ndodhej në zonën e Dajtit.
Pra në dosje nuk ka as një dokumente argumentues ligjor, verifikim nga specialistët përkatës si dhe hartën me formatin dixhital (AGIS) për të argumentuar se ky objektet ndodhet në Zonën e Mbrojtur dhe është i pajisur me leje etj.

Në shkresën se AKZM, nuk argument në përshtatshmëri e ligjërisht sipas VKM 402 date 21.06 .2006 pika 4 (Germa ç) ku shprehimisht thuhet :
" Zonë e përdorimit të qëndrueshëm, (e shënuar në hartë me "ZPQ" sipërfaqe 1184, 27 ha), në të cilën lejohen veprimtaritë ekonomike ekzistuese, me "ZPU", si dhe mund të hapen veprimtari të reja, **vetëm pas pajisjes me lejen përkatëse**. Në zonën e përdorimit të qëndrueshëm zbatohet shkalla e pestë e mbrojtjes".

* Në shkresën me nr.6609 Prot. Datë 21.09.2020, e protokolluar ne AKZM me nr.6302 Prot. datë 22.09.2020, ku kërkohet informacion nga istucioni përkatës nga AdZM për nderimin e një objekti i ndërtuar në zonën e mbrojtur Dajt – Tiranë të verifikuar nga specialiste e AdSHK ku përshkruhej se "Objekti ndodhej në zonën e mbrojtur kategoria e II e shpallur sipas VKM. 402,datë 21.06.2006 të ndërtuar objekti nga z. H.A.H.

Në përgjigjen e dhënë me nr.989/1Proë. datë 09.10.2020 është shprehur pozitivisht për legalizimin e objektin të ndërtuar, nuk përben pengesë për vazhdimin e procedurave të legalizimin të shtesës së objektit, që ndodhet në ketë zonë e Dajtit.

Pra në dosje nuk ka as një dokumente argumentues ligjor, verifikim nga specialiste përkatës si dhe hartën me formalin dixhital (AGIS) për të argumentuar se ky objekt ndodhet në Zonën e Mbrojtur dhe eshë i pajisur me leje .

Në shkresën se AKZM, nuk argumentohej në përshtatshmëri e ligjërisht sipas VKM 402 date 21.06 .2006 pika 4 (Germa ç) ku shprehimisht thuhet:

" Zonë e përdorimit të qëndrueshëm, (e shënuar në hartë me "ZPQ" sipërfaqe 27 ha), në të cilën lejohen veprimtaritë ekonomike ekzistuese, me "ZPU", si dhe mund të hapen veprimtari të reja, **vetëm pas**

pajisjes me lejen përkatëse. Në zonën e përdorimit të qëndrueshëm zbatohet shkalla e pestë e mbrojtjes" dhe nuk i janë përputhshmëri me neni 49, (**Nën zona e përdorimit tradicional dhe të qëndrueshëm) ku shprehimisht thuhet** "Në nënzonën e përdorimit tradicional dhe të qëndrueshëm të një zone të mbrojtur mjedisore zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes, ku janë të ndaluara" sipas ligjit 81 /2017 date 04.05.2017.

Në përgjigjen e dhënë me nr.856/1Prot. datë 08.09.2020 është shprehur pozitivisht për legalizimin e objekteve të nderuara, nuk përben pengesë për vazhdimin e procedurave të legalizimin të shtesës së objektit, megjithëse "kjo zonë është shpallur edhe si zonë e Trashëgimisë Botërorë (UNESCO) dhe Zonë me Përparësi të Zhvillimi të Turizmit dhe te merret mendimi dhe nga institucioneve te tjera.

Pra në dosje nuk ka as një dokumente argumentues ligjor, verifikim nga specialistët përkatës si dhe hartën me formatin dixhital (AGIS) për të argumentuar se ky objekt ndodhej në Zonën e Mbrojtur dhe eshë i pajisur me leje.

Në shkresës se AKZM, nuk argumentohej në përshtatshmëri e ligjërisë sipas VKM 402 date 21.06 .2006 pika 4 (Germa ç) .

Ne shkresat e dërguara nga Asgjësia Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, drejtuar AdZM- Tiranë rezultojnë se ana dokumentare nuk është e plote ne AdZM nuk ***nuk ka të riregjistruara këto prona dhe nuk kane as një te dhëne mbi regjistrimin e tyre nga Drejtorinë Vendore të Asgjësisë Shtetë***rore të Kadastrës dhe nuk na u paraqiten as një dokument për ndjekjen e procedurave ligjore të pronave sipas nenit 3,4,6, 8 dhe 12 të ligjit Nr.8743, datë 22.2.2001 (I ndryshuar me ligjin nr. 9558/2006) për pronat e palejueshme te shtetit në mbështetje të neneve 41, 78, 83 pika 1 dhe 113 të Kushtetutës, si dhe me ligjin ne 81/2017 date 04.05.2017, neni 3 (pika 3), neni7 (pika 2,a) dhe neni 32 pika (1).

1.Titulli i gjetjes: Inspektimet e kryera në zonat e mbrojtura Tiranë.
Situata: Administrata e zonave të mbrojtura Tiranë , në rastet e konstatimit për dënimet apo marrjet e vendimeve për kundërvajtje administrative për periudhën e audituar nuk rezulton të ketë përcaktuar vlerën e dëmit .
Kriteri: VKM Nr.128 datë 13.2.2020 " Për përcaktimin e vlerës së dëmit të shkaktuar në zonat e mbrojtura mjedisore , mënyrën e vlerësimit, mbledhjes dhe administrimit të saj.
Ndikimi/Efekti: Të gjitha procesverbalet e mbajtura nga rojet mjedisore mbeten në fazën e konstatimit dhe nuk është ndjekur procedura e mëtejshme.
Shkaku: Mbas shfuqizimit të Ligjit Nr. 8906 datë 06.06.2002 dhe hyrjen në fuqi i Ligjit me Nr. 81,datë 04.05.2017 "Për Zonat e Mbrojtura "nuk u ndryshua formati i modelit për procesverbalet për kundërvajtjet administrative.
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi: AdZM Tiranë të kërkojë përmirësime ligjore në drejtim të caktimit dhe zbatimit për të marrë masa për kryerjen e inspektimeve dhe të ndjekë të gjitha rrugët e duhura deri në nxjerrjen e vendimeve për masat administrative. AdZM Tiranë të vlerësojë dëmin e shkaktuar në zonën e mbrojtur Tiranë, bazuar në metoda standartë të matjes së sasisë apo sipërfaqes së dëmtuar.
Afati: Në vazhdimësi dhe menjëherë.

Pika 3. Auditim mbi masat e marra për vlerësimet periodike të situatave mjedisore në aktivitetin mjedisor e zhvillimor të zonave dhe ruajtjen e monumenteve të natyrës.

Në dokumentacionin e vënë në dispozicion për "Mbrojtja e monumenteve të natyrës" megjithëse figuron një listë me monumentet e natyrës (23 Monumente), nuk ka asnjë të dhënë në informacionet mbi gjendjen e këtyre monumenteve, si janë ruajtur, gjendja e tyre fizike, etj. pra rezulton si nje magazinë e rruajtjes pa pasur as një ndjekje te procedurave ose nuk ka një objektivi kryesorë të monitorimeve është promovimi i këtyre MN-ve tek turistët që shprehin interes për vizitimin e këtyre objekteve natyrore me vlera të larta turistike. Të gjithë këto monumente vizitohen nga turistë vendas dhe të huaj pasi secili prej tyre ka karakteristikat e tij të veçanta, por ndër më të vizituarat konkretisht për rrethin e Tiranës janë si me poshtë:

-Bokërrimat e Mnerit, Bokërrimat e Mustafa Kocajt, Gryka e Muradhit, Gryka e Skoranës, Karsti i Malit me Gropa, Rrapi Komka, Rrapi i Kranës, Rrapi i Ndroqit, Rrapi i Priskës, Rrapi i Zall Dajtit, Shkalla e Tujanit, Shpella e Valit, Shpella e Zezë ose Pëllumbasit, Ujëvara e Perroit të Kecit, etj.

Pra nuk ka as një veprim dhe bashkëpunim me mediat, impenjim i stafit në realizim të fotove në funksion të promovimit të burimeve natyrore.
Promovim i resurse natyrore
Promovimi në media vizive e të shkruar
Shpërndarje e broshurave dhe fletëpalosje, shpërndarja e fletëpalosjeve, broshurave si dhe ne facebook "Stafi i Sektorit të Menaxhimit dhe Monitorimit".
Pra konstatojmë se planet janë formale pa nxjerrë as një përgjegjësi dhe nuk justifikon punën dhe veprimtarinë e sektorëve përkatës të AdZM-Tirane dhe ne resurset natyrore nuk ka nje plan te detajuar per rritjen e te ardhurave ne vizitat qe mundet te kryeshin ne monumentet e natyrës.
Në pikat e programit vetëm e shkruar në letër dhe në asnjë rast nuk ka asnjë dokument mbi gjendjen, si dhe kontrollin e tyre.
Ne pikat e programeve te çdo muaji:
Gjatë vitit 2019-2021 rezulton se: AdZM Tiranë ka nën juridiksionin e saj këto zona të mbrojtura: Parkun Kombëtar "Mali i Dajtit" 28.000 ha, Parku Natyror "Mali me Gropa-Bizë-Martanesh" 26.000 ha, një pjesë të parkut kombëtar "Divjakë-Karavasta" rreth 600 ha.
Administrata e Zonave të Mbrojtura është në varësi të Agjencisë së Zonave të Mbrojtura dhe **nuk** ka sektor finance si AdZM Tiranë por është në vartësi të AZM si istucion kryesor në menaxhim sa më cilësor të parqeve natyrore kombëtare, si dhe të politikave në fushën e ruajtjes së biodiversitetit në to, ku mendimet e dhëna të respektojnë interesin kombëtar e rajonal si dhe trendin e integrimit, nga istucionet e vartësisë.
Për auditimet e kësaj pikë u mbështetëm në:

Ligjit Nr. 81/2017 " Për zonat e mbrojtura". ***VKM NR. 102, datë 04.02.2015*** *"Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe të administrative rajonale të zonave të mbrojtura).* ***Rregullore e Brendshme*** *"Për funksionimin dhe organizimin e AKZM dhe ADZM".* ***-Urdhri i KM nr. 48, datë 29.03.2016****"Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe administrative rajonale të zonave të mbrojtura".* ***-Urdhri i KM nr. 26, datë 03.02.2020****"Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe administrative rajonale të zonave të mbrojtura".*

Konkluzion: Këto monumente të natyrës si pjesë e zonave të mbrojtura janë burime për të garantuar të ardhura, por në fakt nuk janë vënë në eficencë,për shkak të vakumit ligjor dhe mungesës së udhëzimeve, për menaxhimin dhe administrimin e këtyre monumenteve**.** Në ligjin nr. 81/2017 datë 04.05.2017 nen17 pika 4 përcaktohet : "*Në përputhje me shkallën e mbrojtjes së monumentit dhe me potencialet turistike e rekreacionin e zonës, ministri miraton me urdhër e rregulla të veçanta për vizitat ose kalimin e vizitorëve a të turistëve për afate të shkurtra kohore".*

2.Titulli i gjetjes: Mos vënia në eficencë e Monumenteve të Natyrës.

Situata: Stafi AdZM Qarkut Tiranë zhvillon kontrolle dhe monitorime të Monumenteve të Natyrës në të Tiranës dhe Lushnjës. Objektivi kryesorë i monitorimeve është promovimi i këtyre MN-ve tek turistët që shprehin interes për vizitimin e këtyre objekteve natyrore me vlera të larta turistike. Të gjithë këto monumente vizitohen nga turistë vendas dhe të huaj pasi secili prej tyre ka karakteristikat e tij të veçanta, por ndër më të vizituarat konkretisht për rrethin e Tiranes janë:

-Bokërrimat e Mnerit, Bokërrimat e Mustafa Kocajt, Gryka e Muradhit, Gryka e Skoranës, Karsti i Malit me Gropa, Rrapi Komka, Rrapi i Kranës, Rrapi i Ndroqit, Rrapi i Priskës, Rrapi i Zall Dajtit, Shkalla e Tujanit, Shpella e Valit, Shpella e Zezë ose Pëllumbasit, Ujëvara e Perroit të Kecit, etj

Nga këto monumente të natyrës AdZM Tiranë nuk merr të ardhura, nga vizitorët drejt tyre.

Kriteri: Në ligjin nr. 81/2017 datë 04.05.2017 nen17 pika 4 përcaktohet : "*Në përputhje me shkallën e mbrojtjes së monumentit dhe me potencialet turistike e rekreacionin e zonës, ministri miraton me urdhër e rregulla të veçanta për vizitat ose kalimin e vizitorëve a të turistëve për afate të shkurtra kohore".*

Ndikimi: Këto monumente të natyrës si pjesë e zonave të mbrojtura janë burime për të garantuar të ardhura, por në fakt nuk janë vënë në eficencë, për shkak të vakumit ligjor dhe mungesës së udhëzimeve, për menaxhimin dhe administrimin e këtyre monumenteve.

Shkaku: Mos eficenca e monumenteve të natyrës vjen si pasojë e mos pasjes së infrastrukturës së duhur dhe investimit të duhur pranë tyre.

Rëndësia: E ulët.

Rekomandimi: AdZM Tiranë në bashkëpunim me Ministrinë e Linjës, ti japi prioritet promovimit të Monumenteve të Natyrës, si dhe gradualisht të bëhet e mundur vënia në eficencë e tyre.

Pika 4.Auditim mbi zbatimin e procedurave për planet zhvillimore të subjekteve private e vetë njësisë publike dhe zbatimin i ligjshmërisë të akteve te lidhura me subjektet private.

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit nuk është ushtruar asnjë auditim në Administratën e Zonave të Mbrojtura Tiranë, pasi ky institucion ka filluar aktivitetin me miratimin e VKM nr.102 datë 04.02.2015 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të Funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe të Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura".

Në AdZM-në e Tiranës, për vitet 2019, 2020 dhe 2021, janë lidhur **73 kontratë qiraje provizore** me afate 4 mujore ne vitin 2019 janë lidhur 23 kontrata ,në vitin 2020 janë lidhur 26 kontrata dhe në vitin 2021 janë lidhur 24 kontrata , nga këto vetëm një subjekt ka lidhur kontratë 10 vjeçare ndërsa subjektet e tjera kontrata 4 mujore me përsëritje.
Nga të dhënat në AdZM-Tiranë për dhënien me **Qira sezonale** për blegtorinë në zonat e mbrojtura kryesisht Parkun Kombëtar "Mali i Dajtit" 28.000 ha, parku natyror "Mali me Gropa-Bizë-Martanesh" 26.000 ha, si dhe parku kombëtar "Divjake-Karavasta" rreth 600 ha, që janë në reduksionin e AdZM - Tiranë për vitet 2019 deri ne vitin 2021 rezulton se janë në total 73 kontrata sezonale (shif tabelën si me poshtë)

Te dhënat e kontratave provizore sipas viteve 2019-2021

Nr.	Vitet	Dhene me **qira sezonale** .Subj.	Superfine ne ha te dhëna me qira	Vlera në lekë
1	2019	23	217.3	130900
2	2020	26	306	148840
3	2021	24	378.3	157600
	Totali	**73**	**901.6**	**473340**

Pra rezulton se janë dhënë sasi e pakta e kontratave provizore për blegtorinë dhe sipërfaqja që disponon AdZM në krahasim me kontratat e dhënat është shumë e madhe ne sipërfaqe totale 54 mije ha , pra rezulton se janë dhënë me kontrata provizore ne total me sipërfaqen janë ç! Frytëzuar vetëm 5.5 % e tyre në vit dhe sipas të dhënave rezulton se kontratat provizore janë lidhur për kullote për blegtorinë për **1029** (Krerë të kontraktuara sipas kontratave) ne një vit , ku sipas te dhënave nga Instat dhe AZHBR rezulton se Tirana ka 23 mijë gjedhe, 55 mijë të leshta (dhen) dhe 48 mije të dhirta.

Sipas sistemit "Ruda" te dhëna nga Ministria e Buqësisë rezultoi se **nuk** janë marre te dhëna për subjektet private mbi numrin e krerëve për lidhjen e kontratave provizore për te likuiduar detyrimin për kullotat në zonat e mbrojtura sipas krerëve që disponojnë dhe konkretisht sipas sistemit "Ruda" konstatojmë se:
Subjektit B. S. me Nr. aplikimi 31 dhe kod 3235 rezulton se kane pronësi 160 krerë dhen
Sipas kontratës se qirasë me ne 33/7 date 13.07.2020 rezulton se subjekti ka deklaruar se ka 87 krerë te imta ne vendin e quajtur Stanet e Lisit pra me një diference 73 krerë, pra ngelet pa likuiduar **për 73 krerë te imta x 100 lekë ne vit = 7,300 leke pa likuiduar për vitin 2020.**
Sipas kontratës se qirasë me ne 49/18 prot. date 12.07.2021 rezulton se subjekti B. S. ka deklaruar se ka 80 krerë te imta ne vendin e quajtur Lugu i Bredhit pra me një diference 80 krerë , pra ngelet pa likuiduar **për 80 krerë te imta x 100lekë për vitin 2021 = 8,000 lekë pa likuiduar ne vitin 2021, kontrata e firmosur nga ish/ drejtori I.V.**

-Subjekti F.D disponon **310 krerë** te imta sipas aplikimit ne sistem me nr 37 dhe kod aplikimi 3324 .

Sipas kontratës se qirasë me ne 33/12 date 13.07.2020 rezulton se subjekti ka deklaruar se ka 93 krerë te imta ne vendin e quajtur Shën Noi i Vogël pra me një diference 217 krerë , pra ngelet pa likuiduar **për 217 krerë te imta x 100lekë ne vit = 21,700 leke pa likuiduar për vitin 2020.**

Sipas kontratës se qirasë me ne 49/3 prot. date 07.07.2021 rezulton se subjekti ka deklaruar se ka 100 krerë te imta ne vendin e quajtur Shën Noi i Vogël pra me një diference 210 krese , pra ngelet pa

likuiduar **për 210 krerë te imta x 100 lekë për vitin 2021 = 21,000 lekë pa likuiduar ne vitin 2021, kontrata e firmosur nga ish/ drejtori I.V.**

Nga të dhënat nuk na u paraqitën rraste nga rrojet e zonave të mbrojtura, për subjekte te cilat kullosin të imtat dhe gjedhe ne Zonën e Mbrojtur Dajt "**pa lidhur kontrate", pra tregon se nuk kane kryer si duhet detyrën ne kundërshtim me nenin 3 pika 2 e ligjin 81/2017 si dhe rregullores me nr .72/1 date 15.06.2015(Fq/37 . Specialisti për administrimin dhe zbatimin e planit te menaxhimit).**

Kontrata Qiraje për dhënien në përdorim të sipërfaqeve së kullotës në zonën e mbrojtur, viti 2020

-**Subjekti L. V.** ka bërë aplikim për të marrë me qira sipërfaqen kullosore prej 1 ha në ekonominë kullosore "Mner-Bastar" me nr. parcele 49d dhe kapacitet 2 krerë gjedh.

Bashkangjitur kontratës së qirasë me nr.33 prot. datë 13.07.2020 ka dorëzuar: **mandatin e pagesës në bankë, kërkesën drejtuar AdZM Tiranë ku thuhet se ka 2 krerë gjedh si dhe procesverbalin e marrjes në dorëzim të kullotës.** Në këtë dosje që zotëron AdZM Tiranë mungojnë***: certifikata veterinare nga ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural që vërteton se krerët që subjekti zotëron janë të regjistruara dhe të matrikulluara nga veterineri i zonës, mungon regjistri i marrë nga sistemi "Ruda", fotokopja e pasaportës së subjektit, mungon dhe vërtetimi nga njësia administrative ku banon që vërteton se është banor i zonës.*** Pavarësisht se në kërkesë shkruhet se këto dokumente ndodhen bashkangjitur, ato nuk janë në dosjen e AdZM Tiranë.

-**Subjekti M.Ç.** ka bërë aplikim për të marrë me qira sipërfaqen 20m2 për ndërtim ngrehine për barinjtë në ekonominë kullosore "Mcek-Bastar-Shëmri-Selitë" me nr. parcele 1 dhe kapacitet 50 krerë dhen.
Bashkangjitur kontratës së qirasë me nr.33/1 prot. datë 13.07.2020 ka dorëzuar: **mandatin e pagesës në bankë**, **kërkesën drejtuar AdZM Tiranë ku thuhet se ka 50 krerë si dhe procesverbalin e marrjes në dorëzim të kullotës.** Në këtë dosje që zotëron AdZM Tiranë mungojnë***: certifikata veterinare nga ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural që vërteton se krerët që subjekti zotëron janë të regjistruara dhe të matrikulluara nga veterineri i zonës, mungon regjistri i marrë nga sistemi "Ruda", fotokopja e pasaportës së subjektit, si dhe vërtetimi nga njësia administrative ku banon që vërteton se është banor i zonës.*** Pavarësisht se në kërkesë shkruhet se këto dokumente ndodhen bashkangjitur, ato nuk gjenden në dosjen e AdZM Tiranë.

- **Subjekti Z.L.** ka bërë aplikim për të marrë me qira sipërfaqe në ekonominë kullosore "Mcek-Bastar-Shëmri-Selitë" me nr. parcele 2 dhe kapacitet 50 krerë dhen.
Bashkangjitur kontratës së qirasë me nr.33/5 prot. datë 13.07.2020 ka dorëzuar: **mandatin e pagesës në bankë**, **kërkesën drejtuar AdZM Tiranë ku thuhet se ka 50 krerë si dhe procesverbalin e marrjes në dorëzim të kullotës.** Në këtë dosje që zotëron AdZM Tiranë mungojnë***: sipërfaqja e tokës e dhënë me qira, certifikata veterinare nga ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural që vërteton se krerët që subjekti zotëron janë të regjistruara dhe të matrikulluara nga veterineri i zonës, mungon regjistri i marrë nga sistemi "Ruda", fotokopja e pasaportës së subjektit, si dhe vërtetimi nga njësia administrative ku banon që vërteton se është banor i zonës.*** Pavarësisht se në kërkesë shkruhet se këto dokumente ndodhen bashkangjitur, ato nuk janë në dosjen e AdZM Tiranë.

- **Subjekti A.J.** ka bërë aplikim për të marrë me qira sipërfaqen 20m2 për ndërtim ngrehine për barinjtë në ekonominë kullosore "Mcek-Bastar-Shëmri-Selitë" me nr. parcele 6 dhe kapacitet 50 krerë dhen.
Bashkangjitur kontratës së qirasë me nr.33/4 prot. datë 13.07.2020 ka dorëzuar: **mandatin e pagesës në bankë**, **kërkesën drejtuar AdZM Tiranë ku thuhet se ka 50 krerë dhen si dhe procesverbalin e marrjes në dorëzim të kullotës.** Në këtë dosje mungojnë***: certifikata veterinare nga ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural që vërteton se krerët që subjekti zotëron janë të regjistruara dhe të matrikulluara nga veterineri i zonës, mungon regjistri i marrë nga sistemi "Ruda", fotokopja e pasaportës së subjektit, gjithashtu mungon dhe vërtetimi nga njësia administrative ku banon që vërteton se është banor i zonës.*** Pavarësisht se në kërkesë shkruhet se këto dokumente ndodhen bashkangjitur, ato nuk janë në dosjen e AdZM Tiranë.

- **Subjekti M.K.** ka bërë aplikim për të marrë me qira sipërfaqe në ekonominë kullosore "Mcek-Bastar-Shëmri-Selitë" me nr. parcele 6 dhe kapacitet 20 krerë dhen.
Bashkangjitur kontratës së qirasë me nr.33/2 prot. datë 13.07.2020 ka dorëzuar: **mandatin e pagesës në bankë**, **kërkesën drejtuar AdZM Tiranë ku thuhet se ka 20 krerë dhen si dhe procesverbalin e marrjes në dorëzim të kullotës.** Në këtë dosje mungojnë***: certifikata veterinare nga ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural që vërteton se krerët që subjekti zotëron janë të regjistruara dhe të matrikulluara nga veterineri i zonës, mungon regjistri i marrë nga sistemi "Ruda", fotokopja e pasaportës së subjektit, si dhe vërtetimi nga njësia administrative ku banon që vërteton se është banor i zonës.*** Pavarësisht se në kërkesë shkruhet se këto dokumente ndodhen bashkangjitur, ato nuk gjenden në dosjen që administron AdZM Tiranë.

- **Subjekti R.L.** ka bërë aplikim për të marrë me qira sipërfaqe 34 m2 për ndërtim ngrehinë për barinjtë dhe qendër stani në ekonominë kullosore "Mcek-Bastar-Shëmri-Selitë" me nr. parcele 2 dhe kapacitet 80 krerë dhen.
Bashkangjitur kontratës së qirasë me nr.33/3 prot. datë 13.07.2020 ka dorëzuar: **mandatin e pagesës në bankë**, **kërkesën drejtuar AdZM Tiranë ku thuhet se ka 80 krerë dhen si dhe procesverbalin e marrjes në dorëzim të kullotës.** Në këtë dosje mungojnë***: certifikata veterinare nga ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural që vërteton se krerët që subjekti zotëron janë të regjistruara dhe të matrikulluara nga veterineri i zonës, mungon regjistri i marrë nga sistemi "Ruda", fotokopja e pasaportës së subjektit si dhe vërtetimi nga njësia administrative që vërteton se është banor i zonës.*** Pavarësisht se në kërkesë shkruhet se këto dokumente ndodhen bashkangjitur, ato nuk gjenden në dosjen e AdZM Tiranë.

- **Subjekti A. S.** ka bërë aplikim për të marrë me qira sipërfaqe 16 m2 për ndërtim ngrehinë për barinjtë dhe qendër stani në ekonominë kullosore "Linos-Brosh, Gryka Valit-Bizë" me nr. parcele 2 dhe kapacitet 50 krerë dhen.
Bashkangjitur kontratës së qirasë me nr.33/6 prot. datë 13.07.2020 ka dorëzuar: **mandatin e pagesës në bankë**, **kërkesën drejtuar AdZM Tiranë ku thuhet se ka 50 krerë dhen si dhe procesverbalin e marrjes në dorëzim të kullotës.** Në këtë dosje mungojnë***: certifikata veterinare nga ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural që vërteton se krerët që subjekti zotëron janë të regjistruara dhe të matrikulluara nga veterineri i zonës, mungon regjistri i marrë nga sistemi "Ruda", fotokopja e pasaportës së subjektit, gjithashtu mungon dhe vërtetimi nga njësia administrative që tregon se është***

banor i zonës. Pavarësisht se në kërkesë shkruhet se këto dokumente ndodhen bashkangjitur, ato nuk gjenden në dosjen e administruar nga AdZM Tiranë.

- **Subjekti B.S.** ka bërë aplikim për të marrë me qira sipërfaqe 16 m^2 për ndërtim ngrehinë për barinjtë dhe qendër stani në ekonominë kullosore "Linos-Brosh, Gryka Valit-Bizë" me nr. parcele 1 dhe kapacitet 87 krerë dhi.
Bashkangjitur kontratës së qirasë me nr.33/7 prot. datë 13.07.2020 ka dorëzuar: **mandatin e pagesës në bankë**, **kërkesën drejtuar AdZM Tiranë ku thuhet se ka 87 krerë dhi si dhe procesverbalin e marrjes në dorëzim të kullotës.** Në këtë dosje mungojnë***: certifikata veterinare nga ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural që vërteton se krerët që subjekti zotëron janë të regjistruara dhe të matrikulluara nga veterineri i zonës, mungon regjistri i marrë nga sistemi "Ruda", fotokopja e pasaportës së subjektit, gjithashtu mungon dhe vërtetimi nga njësia administrative që tregon se është banor i zonës.*** Pavarësisht se në kërkesë shkruhet se këto dokumente ndodhen bashkangjitur, ato nuk janë në dosjen që administrohet nga AdZM Tiranë.

- **Subjekti M.A.** ka bërë aplikim për të marrë me qira sipërfaqe në ekonominë kullosore "Linos-Brosh, Gryka Valit-Bizë" me nr. parcele 1 dhe kapacitet 48 krerë dhen.
Bashkangjitur kontratës së qirasë me nr.33/8 prot. datë 13.07.2020 ka dorëzuar: **mandatin e pagesës në bankë**, **kërkesën drejtuar AdZM Tiranë ku thuhet se ka 48 krerë dhen si dhe procesverbalin e marrjes në dorëzim të kullotës.** Në këtë dosje mungojnë***: certifikata veterinare nga ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural që vërteton se krerët që subjekti zotëron janë të regjistruara dhe të matrikulluara nga veterineri i zonës, mungon regjistri i marrë nga sistemi "Ruda", fotokopja e pasaportës së subjektit, si dhe vërtetimi nga njësia administrative ku banon që vërteton se është banor i zonës.*** Pavarësisht se në kërkesë shkruhet se këto dokumente ndodhen bashkangjitur, ato nuk janë në dosjen e administruar nga AdZM Tiranë.

- **Subjekti L.B.** ka bërë aplikim për të marrë me qira sipërfaqe 18 m^2 per te ngritur një qender përpunimi bulmeti në ekonominë kullosore "Linos-Brosh, Gryka Valit-Bizë" me nr. parcele 7.
Bashkangjitur kontratës së qirasë me nr.33/9 prot. datë 13.07.2020 ka dorëzuar: **mandatin e pagesës në bankë**, **kërkesën drejtuar AdZM Tiranë ku thuhet se sipërfaqja e cila do merret me qira është 18 m2 dhe procesverbalin e marrjes në dorëzim të kullotës.** Në këtë dosje mungojnë***: fotokopja e pasaportës së subjektit, si dhe vërtetimi nga njësia administrative ku banon që vërteton se është banor i zonës.***

- **Subjekti H.D.** ka bërë aplikim për të marrë me qira sipërfaqe në ekonominë kullosore "Linos-Brosh, Gryka Valit-Bizë" me nr. parcele 10 dhe kapacitet 18 krerë dhen.
Bashkangjitur kontratës së qirasë me nr.33/10 prot. datë 13.07.2020 ka dorëzuar: **mandatin e pagesës në bankë**, **kërkesën drejtuar AdZM Tiranë ku thuhet se ka 18 krerë dhen si dhe procesverbalin e marrjes në dorëzim të kullotës.** Në këtë dosje mungojnë***: certifikata veterinare nga ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural që vërteton se krerët që subjekti zotëron janë të regjistruara dhe të matrikulluara nga veterineri i zonës, mungon regjistri i marrë nga sistemi "Ruda", fotokopja e pasaportës së subjektit, si dhe vërtetimi nga njësia administrative ku banon që vërteton se është banor i zonës.*** Pavarësisht se në kërkesë shkruhet se këto dokumente ndodhen bashkangjitur, ato nuk janë në dosjen e administruar nga AdZM Tiranë.

- **Subjekti F.D.** ka bërë aplikim për të marrë me qira sipërfaqe 20 m^2 për ndërtim ngrehinë për barinjtë dhe qendër stani në ekonominë kullosore "Linos-Brosh, Gryka Valit-Bizë" me nr. parcele 10 dhe kapacitet 93 krerë dhen.
-Disponohet kërkesa e subjektit pika turistike *"P"* shpk nr. 102 date 26.10.2018 për marrjen e sipërfaqes 1,08 ha me qira për turizëm malor.
-Disponohet miratimi i kontratës nga drejtori përgjithshëm AKZM z. Z.D, sipas urdhrit nr. 117 date 08.05.2019.
-Disponohet Memo e drejtorit ADZM nr. 102/1 date 06.11.2018, për drejtorin e përgjithshëm te AKZM.
-Disponohen plan-rivelimi, plan biznesi, hartat, projekti, plan vendosja, planimetria etj, nënshkruar nga specialistet e fushës dhe subjekti, për parcelën 1,08 ha ne përdorim brenda ZM.
- Disponohet procesverbali dorëzimit 15.05.2019, për subjektin qe i jepet ne përdorim sipërfaqen 1,08 ha, nënshkruar nga dy palët, përkatësisht: për subjektin K.D dhe për palën qiradhënëse përgjegjësi i sektorit menaxhimit H.D dhe roja mjedisore Sh.D, ku nder te tjera citohet: "*Brenda sipërfaqes 1,08 ha marre me qira ndodhen rrugica shtruara me pllaka guri me llaç e beton si dhe 2 vatra vogla me mure guri, punime kryera ne vitet mëparshme"*, në kundërshtim me kushtet e kontratës dhe kërkesat e nenit 16 te ligjit 81/2017 "*Për zonat mbrojtura".*
-Ne origjine:
Disponohet **procesverbali dorëzimit 22.06.1995,** për subjektin qe **i jepet ne përdorim *sipërfaqja 1200 m2* me afat kohor 49 vite,** me status juridik **"***livadh dhe shkëmb*", ndërsa **ne thyerje te këtij kushti kjo sipërfaqe ka kaluar ne pronësi te subjektit,** truall 1200 m2 ku ndodhet *restorant motel e vila druri* komuna Dajt, **sipas vërtetimit hipotekor date 25.04.2018**. Gjithashtu disponohet vendimi R-13326/3 date 19.08.2022 i Bashkisë Tirane nënshkruar nga kryetari bashkisë Tirane dhe drejtoresha DPPZHT, për *" leje rikonstruksioni dhe riparim objektit 2-kat+2-kat podrum te dëmtuar pa shtim volume e sipërfaqe".*
Pagesat e qirasë 2019-2022, paraqitet sipas këtyre dokumenteve te bankës:
* Disponohet Mandat pagesa date 15.05.2019 "*R. bank"* fotokopje, për likuidimin e tarifës qirasë vjetore 97,200 leke për vitin **2019** (*14.05.2019 deri 14.05.2020)*, sipas kërkesave te kontratës 48/1 date 14.05.2019.
*Disponohet Mandat pagesa date 16.07.2020 "*R. bank"* fotokopje, për likuidimin e tarifës qirasë vjetore 97,200 leke për vitin **2020** (*14.05.2020 deri 14.05.2021),* por duhej 99600 leke sipas amendamentit nr. 1 te kontrate lidhur, pasi viti 2020 paraqet tarifa tjera nga ndryshimi ligjor, pra diferenca 2,400 leke nga kjo 1,700 leke likuiduar 24.09.2021, ndërsa **pa paguar <u>diferenca 700 leke</u>** nga subjekti K.D.
* Nuk disponohet mandat pagesa bankare për shlyerjen e qirasë vjetore për vitin **2021** (*14.05.2021 deri 14.05.2022),* pra **<u>detyrimi</u> <u>99,600 leke</u>** pa likuiduar nga K.D..
* Disponohet Mandat pagesa bankare 13.06.2022 "*BKT" fotokopje e palexueshme*, për likuidimin e tarifës qirasë vjetore 99,600 leke për vitin 2022 (*14.05.2022 deri 14.05.2023).*
Dosja e subjektit rezulton pa inventarë, pa numerizim te dokumenteve, pa marrës dhe dorëzues, për periudhën 2019-2021, në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

3. ADZM Tirane ka lidhur kontrate qiraje nr. 45 date 24.04.**2019** me subjektin "A" shpk B.H "*Për dhënien ne përdorim te sipërfaqes se zonës mbrojtur Mali Dajtit, Zallherr, parcela 43/a*", për **19,900 m2** për aktivitet "*Vendosje kënd lojërash për fëmije njësi aktivitete sportive, çlodhje, argëtim dhe*

vrojtim natyror te vizitoreve/turisteve", me afat 5 vjeçar (2019-2024), nënshkruar nga drejtori I. V dhe subjekti qiramarrës B. H.

Ne kontratën nr. 45 date 24.04.2019 neni 4, përcaktohet vlera e qirasë vjetore 179,100 leke, sipas VKM nr. 391 date 21.06.2006 ndryshuar me VKM nr. 1064 date 22.12.2010 "*Për përcaktimin e tarifave ne sektorin pyjor dhe kullotave*".

Ne Amendamentin nr. 1 date 10.09.2021 (te kontratës nr. 45 date 24.04.2019) neni 4 bëhen ndryshime ne vlerën e qirasë vjetore nga 179,100 leke behet 213,925 leke/vit, pasi ka ndryshuar VKM nr. 1064 date 22.12.2010 "*Për përcaktimin e tarifave ne sektorin pyjor dhe kullotave*" me VKM nr. 1156 date 24.12.2020 *"Për përcaktimin e ardhurave gjeneruara nga tarifat qe paguhen ne zonat mbrojtura te masës dhe kritereve përdorimit tyre",* lidhja 1, pika 3/a/1, pika 3/b/1 dhe pika 3/c/1..

Disponohet urdhri i drejtorit nr. ekstra date 07.03.2019 për krijimin e grupit punës (*H.D, N. V dhe E. K.)* për studimin e kërkesës dhe vlerësimin teknik-ekonomik te sipërfaqes 1,99 ha ne ZM për përdorim, si dhe raport–vlerësimi përkatës.

-Disponohet kërkesa e subjektit nr. 29 date 04.03.2019 për marrjen e sipërfaqes 1,99 ha me qira për turizëm malor.

-Disponohet miratimi i kontratës nga drejtori përgjithshëm AKZM z. Z.D., sipas urdhrit tij nr. 102 date 18.04.2019.

-Disponohet Memo dhe opinion i drejtorit DZM nr. ekstra date 18.04.2019 dhe nr. 29/1 date 15.03.2019, për drejtorin e përgjithshëm AKZM.

-Disponohen plan-rivelimi, plan biznesi, hartat, projekti, plan vendosja, planimetria etj, nënshkruar nga specialistet e fushës dhe subjekti, për parcelën 1,99 ha ne përdorim brenda ZM.

- Disponohet procesverbali dorëzimit 26.04.2019, për subjektin qe i jepet ne përdorim sipërfaqja 1,99 ha, nënshkruar nga dy palët subjekti B.H dhe qiradhënësi H.D dhe roja mjedisore G.H**.**

Pagesa e qirasë 2019-2021, paraqitet:

* Disponohet mandat pagesa bankare 24.04.2019 "*R. bank"* fotokopje, për likuidimin e tarifës qirasë vjetore 179,100 leke për vitin **2019** (*24.04.2019 deri 24.04.2020),* sipas kërkesave te kontratës 45 date 24.04.2019.

* Disponohet mandat pagesa bankare 01.04.2021 "*union bank"*, për likuidimin e tarifës qirasë vjetore 179,100 leke për vitin **2020** (*24.04.2020 deri 24.04.2021),* por duhej 213,925 leke sipas amendamentit nr. 1 te kontrate lidhur, pasi viti 2021 paraqet tarifa tjera nga ndryshimi ligjor, pra **diferenca 34,825 leke** e pa paguar nga subjekti B.H për periudhën 4 muj-I 2021. ***Disponohet një mandat arkëtim kopje e palexueshme për pagesën e kësaj vlere, ne vend te origjinalit,*** ne kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik* ", pika 36, ku thuhet:

> ***dokumentacioni quhet i rregullt kur*** *përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen,* ***përmban të dhëna*** *për shkakun e veprimit datën dhe vendin e kryerjes,objektin ,* ***treguesit sasiorë*** *dhe ato të vlerës ,* ***personat që kanë urdhëruar*** *dhe ekzekutuar veprimin dhe* ***të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative****. Dokumentet* ***duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime****.*

* Disponohet mandat pagesa bankare për shlyerjen e tarifës qirasë vjetore 213**,**925 leke për vitin **2021** (*14.05.2021 deri 14.05.2022).* ***Sipas dokumentacionit tekniko-ligjor***, u konstatua se:

Sipërfaqja e bar-restorantit dhe kabinave përcaktohet gjithsejtë 516 m2 *(340 m2+176 m2)* **dhe jo 170 m2** *(bar-restoranti është 340 m2 dhe jo 170 m2 qe është përllogaritur si dhe sipërfaqja e kabinave*

është 176 m2), për rrjedhoje **diferenca 173,000 leke** *(516-170=346 m2 x 500 leke/m2)* e pa paguar për vitin 2021 nga subjekti B.H.

Dosja e subjektit rezulton pa inventarë, pa numerizim te dokumenteve, pa marrës-dorëzues, në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

4. ADZM Tirane ka lidhur kontratën e qirasë nr. 2/1 date 18.01.**2019** me subjektin "**T.E" shpk** G. Xh "*Për dhënien ne përdorim te sipërfaqes se zonës mbrojtur Mali Dajtit, Zall-Herr Priske, parcela 44b*", për **500 m2** për aktivitet "*Hidrocentral Mali ",* lumi i Tërkuzës, Boville, me afat 5 vjeçar *(2019-2024),* nënshkruar nga drejtori I.V dhe subjekti qiramarrës, me vlerën e qirasë vjetore 7,500 leke.

Dosja përbehet nga këto dokumente:

Disponohet urdhri i drejtorit nr. ekstra date 24.09.2018 për krijimin e grupit punës *(H.D, N.V dhe E. K)* për studimin e kërkesës dhe vlerësimin teknik-ekonomik te sipërfaqes 0,05 ha ne ZM për përdorim, si dhe raport–vlerësimi përkatës.

-Disponohet raport–vlerësimi i grupit punës, sipas urdhrit te drejtorit ADZM Tirane,

-Disponohet miratimi i kontratës nga drejtori përgjithshëm AKZM z. Z.D, sipas urdhrit nr. 6 date 04.01.2019.

-Disponohet opinion nr. 90/1 date 25.09.2018, për drejtorin e përgjithshëm AKZM.

- Disponohet procesverbali dorëzimit 10.01.2019, për subjektin qe i jepet ne përdorim sipërfaqen 0,05 ha, nënshkruar nga dy palët qiramarrësi dhe qiradhënësi.

-Disponohen plan biznesi, hartat, projekti, plan vendosja, etj,

a. Disponohen dokumentet për pagesën e qirasë për vitin 2019-2020-2021, ku rezulton se subjekti "*T-E*" shpk ka likuiduar te plota detyrimet, përjashtuar 1 rast për vitin 2021, pasi është likuiduar pjesërisht qiraja vjetore 166,667 leke**,** ne vend qe te likuidohej vlera 500,000 leke, ose nuk është likuiduar **diferenca 333,333 leke** *(duhej 500,000–166,667 likuiduar),* sipas kërkesave te nenit 4 te Amendamenti nr. 1 date 17.09.2021 *(te kontratës nr. 2/1 date 18.01.2019),* ku bëhen ndryshime ne vlerën e qirasë vjetore nga **7**,500 leke behet 500,000 leke/vit, mbështetur ne VKM nr. 1156 date 24.12.2020 *"Për përcaktimin ardhurave gjeneruara nga tarifat qe paguhen zonat mbrojtura te masës e kritereve përdorimit tyre",* lidhja 1, pika 3/c/4.

Likuidimet janë kryer sipas këtyre mandat pagesave, sipas viteve, sa vijon:

** Disponohet mandat pagesa bankare 08.01.2019 "R. bank" fotokopje, për likuidimin e tarifës qirasë vjetore 7,500 leke për vitin 2019 (18.01.2019 deri 18.01.2020), ne përputhje me kërkesat e kontratës 2/1 date 18.01.2019.*

** Disponohet mandat pagesa bankare 07.01.2020 "R. bank" fotokopje, për likuidimin e tarifës qirasë vjetore 7,500 leke për vitin 2020 (18.01.2020 deri 18.01.2021), ne përputhje me kërkesat e kontratës 2/1 date 18.01.2019.*

** Disponohet mandat pagesa bankare 20.09.2021 "BKT" fotokopje, për likuidimin e tarifës qirasë vjetore 166,667 leke për vitin 2021 (18.01.2021 deri 18.01.2022)***.**

** Disponohet mandat pagesa bankare date 08.02.2022 "otpbank" fotokopje, për likuidimin e tarifës qirasë vjetore 500,000 leke për vitin 2022 (18.01.2022 deri 18.01.2023), sipas kërkesave te amendamentit nr. 1 date 17.09.2021 (te kontratës 2/1 date 18.01.2019).*

** Disponohet vendimi i KKRRT nr. 35 date 16.03.2022, për miratimin e lejes ndërtimit te HEC.*

b. Dosja rezulton pa inventarë, pa numerizim te dokumenteve, pa marrës dhe dorëzues, për periudhën 2019-2021**,** në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

5. AKZM Tirane ka lidhur kontrate qiraje nr 49/3 date 24.08.**2020** me subjektin **G.M** "*Për dhënien ne përdorim te sipërfaqes se zonës mbrojtur Mali Dajtit, Shëngjergj*", për **3,500 m^2** për aktivitet "*Vendosje njësi portative druri, te çmontueshme pa themel, bar – restorant, çadra provizore, kënd lojërash",* me afat 5 vjeçar, zgjatur me tej ne 10 vjeçare, sipas shtesës kontratës nr. 96 date 20.08.2021, nënshkruar nga drejtori I.V dhe subjekti qiramarrës G. M.

Nga auditimi rezultoi:

a. Ne kundërshtim me kërkesat e kontratës nr. 49/3 date 24.08.2020, neni 4, **është shtyre afati i kontratës nga 5 vjet ne 10 vjet** *(2021-2031,* sipas shtesës kontratës nr. 96 date 20.08.2021, pasi **duhej shtyre 3 muaj para mbarimit te afatit te kontratës 5 vjeçare** *(2020-2025).*

b. Mungon akt kolaudimi i objektit te përfunduar nga specialist i fushës i pajisur me licence si dhe **mungon akt verifikimi ne terren i objektit** nga komisioni i ADZM, pra mungon dokumentacioni përfundimtar qe vërteton se nuk ka shkelje ne ndërtimin e objektit prej druri, se nuk ka ne përbërje te tij mure ose beton si dhe **nuk justifikohet sipërfaqja e objektit *(bar-restorante dhe kabina druri),* mbi bazën e se cilës përllogaritet pagesa e tarifës** për sipërfaqen e ndërtimit, ne kundërshtim me kërkesat ligjore dhe kriteret e kontratës.

Fenomen ky edhe për rastet tjera, pasi ADZM kërkon subjektit dokumentet fillestare te cituara me larte, ndërsa nuk kërkon dhe nuk siguron dokumentet përfundimtare te objekteve.

<u>Përllogaritje</u>.

-Për vitin 2020 tarifa e pagesës qirasë prej 42,263 leke është llogaritur për 0,35 ha x 120750 leke/ha, e cila është arkëtuar.

-Për vitin 2021 tarifa e pagesës qirasë prej 83,370 leke e cila është arkëtuar, përkatësisht:

* *bar-restorant 120 m2* x 500 leke sipas lidhjes nr. 1, pika 3/c/1 te VKM 1156 date 24.12.2020 *"Për përcaktimin e te ardhurave te gjeneruara nga tarifat qe paguhen ne zonat e mbrojtura te masës dhe kritereve te përdorimit tyre",* pra ka aplikuar sakte tarifën për 500 leke/m2, **por sipërfaqja 120 m2 paraqet problem, pasi nuk ka dokument qe justifikon ketë sipërfaqe** te objektit *"bar – restorant".*

* kënd lojërash, mjedise sportive dhe çlodhëse 400 m2 x 10 leke/ m2, sipas lidhjes nr. 1, pika 3/a/1 te VKM 1156 date 24.12.2020.

* kënd lojërash, mjedise sportive dhe çlodhëse 2980 m^2 x 6,5 leke/ m^2, sipas lidhjes nr. 1, pika 3/b/1 te VKM 1156 date 24.12.2020 *"Për përcaktimin e te ardhurave te gjeneruara nga tarifat qe paguhen ne zonat e mbrojtura te masës dhe kritereve te përdorimit tyre".*

<u>Dosja përbehet nga këto dokumente:</u>

-Disponohet urdhri i drejtorit date 03.08.2020 për krijimin e grupit punës *(H.D, N.V dhe E.K)* për studimin e kërkesës dhe vlerësimin teknik-ekonomik te sipërfaqes 3500 m^2 ne ZM për përdorim si dhe raport–vlerësimi.

-Disponohet 2 kërkesat e subjektit date 30.07.2020 për marrjen e sipërfaqes 0,35 ha me qira dhe 30.08.2021 për shtesën e afatit nga 5 vjet ne 10 vjet (2020 deri 2030).

-Disponohet miratimi i kontratës nga drejtori përgjithshëm AKZM z. Z.D, sipas urdhrit nr. 843 date 13.08.2020.

-Disponohet Memo e drejtorit ADZM nr. 843/1 date 03.08.2020, për drejtorin e përgjithshëm AKZM Tirane.

-Disponohet procesverbali i dorëzimit date 26.08.2020, për subjektin qe i jepet sipërfaqja 0,35 ha.

-Disponohen plan biznesi, hartat, projekti, plan vendosja, planimetria etj, nënshkruar nga specialistet e fushës dhe subjekti, për parcelën 0,35 ha ne përdorim brenda ZM.

-Disponohet tarifa e pagesës është 42,263 leke *(0,35 ha x 120750 leke/ha)* , e cila është likuiduar e plote sipas MA date 14.09.2020 si dhe vlera 83,370 leke sipas MA date 23.09.2022.

c. Dosja e subjektit rezulton pa inventarë, pa numërim te dokumenteve, pa marrës dhe dorëzues, për periudhën 2019-2021, në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

6. AKZM Tirane ka lidhur kontrate qiraje nr. 65/6 date 09.12.**2020** me subjektin **E.K** "*Për dhënien ne përdorim te sipërfaqes se zonës mbrojtur Mali Dajtit, parcela 14c, ZK 3347, pasuria pyll nr. 565, vol 3, faqe 137, fshati Shëngjin i madh dhe Shëngjergj njësia administrative*", për **4,800 m2** për aktivitet "*Vendosje njësi portative druri, te çmontueshme pa themel, çadra kampingu",* me afat 5 vjeçar (2020-2025), nënshkruar nga drejtori I.V dhe subjekti qiramarrës E. K.

Dosja përbehet nga këto dokumente:

Ne kontratën nr. 65/6 date 09.12.2020 neni 4, përcaktohet vlera e qirasë vjetore 57,960 leke, sipas VKM nr. 391 date 21.06.2006 ndryshuar me VKM nr. 1064 date 22.12.2010 "*Për përcaktimin e tarifave ne sektorin pyjor dhe kullotave*".

Ne Amendamentin nr. 1 te kontratës nr. 65/6 date 09.12.2020 neni 4 bëhen ndryshime ne vlerën e qirasë vjetore nga 57,960 leke behet 90,945 leke/vit, pasi ka ndryshuar VKM nr. 1064 date 22.12.2010 "*Për përcaktimin e tarifave ne sektorin pyjor dhe kullotave*" me VKM nr. 1156 date 24.12.2020 *"Për përcaktimin e ardhurave gjeneruara nga tarifat qe paguhen ne zonat mbrojtura te masës dhe kritereve përdorimit tyre",*

Disponohet urdhri i drejtorit nr. 65/3 date 11.11.2020 për krijimin e grupit punës *(H.D, N.V dhe E. K)* për studimin e kërkesës dhe vlerësimin teknik-ekonomik te sipërfaqes 4,800 m^2 ne ZM për përdorim, si dhe raport–vlerësimi.

-Disponohet kërkesa e subjektit date 09.11.2020 për marrjen e sipërfaqes 0,48 ha me qira për turizëm malor.

-Disponohet miratimi i kontratës nga drejtori përgjithshëm AKZM z. Z.D, sipas urdhrit te tij nr. 65/5 date 02.12.2020.

-Disponohet Memo e drejtorit ADZM nr. 65/4 date 13.11.2020, për drejtorin e përgjithshëm AKZM.

-Disponohet procesverbali i dorëzimit date 14.12.2020, për subjektin qe i jepet sipërfaqja 0,48 ha.

-Disponohen plan-rivelimi, plan biznesi, hartat, projekti, plan vendosja, planimetria etj, nënshkruar nga specialistet e fushës dhe subjekti, për parcelën 0,48 ha ne përdorim brenda ZM.

a. *Pagesa e tarifës qirasë vjetore 2021, paraqitet*:

Për vitin dhjetor 2021 është likuiduar nga subjekti vlera 90,945 leke, sipas mandat pagesës date 16.03.2022 dhe ne përputhje me kontratën e lidhur, por ka problem sipërfaqja e objekteve, pasi është përllogaritur me 120 m2 ne vend te 300 m2, konkretisht:

Ne amendamentin nr. 1 është përllogaritur vlera 90,945 leke *(60,000+1,500+29,445),* ne vend te vlerës 180,000 leke/vit *(150,000+1,500+29,445),* pasi sipas plan biznesit te subjektit dhe projektit arkitektonik përcaktohet sipërfaqja e objekteve gjithsej 300 m2 *(100 m2 sipërfaqja e bar-restorantit dhe 150 m2 sipërfaqja e 10 kabina pushimi druri me nga 15-20 m2/secila)* dhe jo 120 m2 qe është përllogaritur, pra **diferenca** 180 m2x500=**90,000 leke**.

-Disponohet 3 mandat pagesa bankare për likuidimin e tarifës qirasë vjetore, përkatësisht:

për vitin dhjetor 2020- dhjetor 2021, sipas mandat pagesës date 09.12.2020 derdhur ne banke vlera 57,960 leke (0,48 ha x 120750 leke/ha), Brenda kësaj periudhe dhjetor 2020- dhjetor 2021 është likuiduar nga subjekti diferenca 8,915 leke, sipas mandat pagesës date 18.10.2021,

b. Dosja ka mangësi dokumentare për objektin e përfunduar, konkretisht mungon situacioni përfundimtar, akt kolaudimi nga specialisti fushës i licencuar dhe akt verifikimi ne terren i objektit nga komisioni i AKZM, te domosdoshme këto dokumente për efekt te vërtetimit se nuk ka shkelje ne

ndërtimin e objektit prej druri (*nuk ka ne përbërje te tij mure ose beton)*, për te justifikuar sipërfaqen e objektit ndërtimit**,** mbi bazën e se cilës është përllogaritur pagesa e tarifës qirasë, ne zbatim te kushteve te kontratës dhe kërkesave ligjore.
Dosja e subjektit rezulton pa inventarë, pa numerizim te dokumenteve, pa marrës dhe dorëzues, për periudhën 2019-2021**,** në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

7. ADZM Tirane ka lidhur kontrate qiraje nr. 34/3 date 19.08.**2020** me subjektin **K.K** "*Për dhënien ne përdorim te sipërfaqes se zonës mbrojtur Mali Dajtit, parcela 70b Zall Bastar*", për **672 m2** për aktivitet "*Vendosje njësi portative druri, te çmontueshme pa themel, çadra provizore",* me afat 5 vjeçar (2020-2025), nënshkruar nga drejtori I.V dhe subjekti qiramarrës K. K.
Ne kontratën nr. 34/3 date 19.08.2020 neni 4, përcaktohet vlera e qirasë vjetore 8,115 leke, sipas VKM nr. 391 date 21.06.2006 ndryshuar me VKM nr. 1064 date 22.12.2010 "*Për përcaktimin e tarifave ne sektorin pyjor dhe kullotave*".
Ne Amendamentin nr. 1 date 16.09.2021 te kontratës nr. 34/3 date 19.08.2020 neni 4 bëhen ndryshime ne vlerën e qirasë vjetore nga 8,115 leke behet 6,720 leke/vit (kënd lojërash, mjedise sportive dhe çlodhëse 672 m2 x 10 leke), pasi ka ndryshuar VKM nr. 1064 date 22.12.2010 "*Për përcaktimin e tarifave ne sektorin pyjor dhe kullotave*" me VKM nr. 1156 date 24.12.2020 *"Për përcaktimin e ardhurave gjeneruara nga tarifat qe paguhen ne zonat mbrojtura te masës dhe kritereve përdorimit tyre",* lidhja 1, pika 3/a/1.
-Disponohet një vendim gjykate date 04.11.2021 fotokopje "pushim çështjes" marre formën e prere 07.01.2022, për një mur mbajtës për mbrojtjen ne rrëshqitja e pjesës me qira.
Disponohet urdhri i drejtorit nr. ekstra date 16.07.2020 për krijimin e grupit punës *(H.D, N.V dhe E. K)* për studimin e kërkesës dhe vlerësimin teknik-ekonomik te sipërfaqes 672 m^2 ne ZM për përdorim, disponohet raport–vlerësimi përkatës.
-Disponohet kërkesa e subjektit nr. 34 date 13.07.2020 për marrjen e sipërfaqes 0,0672 ha me qira për turizëm malor.
-Disponohet miratimi i kontratës nga drejtori përgjithshëm AKZM z. Z.D, sipas urdhrit nr. 138/5 date 13.08.2020.
-Disponohet Memo e drejtorit ADZM nr. 844/1 date 13.08.2020, për drejtorin e përgjithshëm AKZM.
-Disponohet procesverbali dorëzimit 21.08.2020, për subjektin qe i jepet sipërfaqja 0,0672 ha.
-Disponohen plan-rivelimi, plan biznesi, hartat, projekti, plan vendosja, planimetria etj, nënshkruar nga specialistet e fushës dhe subjekti, për parcelën 0,0672 ha ne përdorim brenda ZM.
Nga auditimi rezultoi:
a. Nuk është përllogaritur tarifa e qirasë për sipërfaqen e ndërtimit bar-restorant, pasi nuk ka dokument. Theksojmë se sipas plan biznesit dhe projektit te subjektit përcaktohet ndërtim me dru i bar-restorantit. Gjithashtu ADZM nuk ka kërkuar dokumente tjera fillestare për përfundimin e objektit, për respektimin e kushtit prej druri dhe jo beton e mur te ndërtesës, ku ne rastin konkret ka mur dhe beton dhe ndërtese, sipas vendimit gjykatës sipërcituar.
-Disponohet 2 Mandat pagesa bankare "*R. bank"* fotokopje, për likuidimin e tarifës qirasë vjetore, përkatësisht:
* **Për vitin 2020**, sipas MA 17.06.2021 është paguar qiraja vjetore (*19.08.2020 deri 19.08.2021)* për vlerën 8,115 leke *(pa vlerën e tarifës bar-restorantit*), por AKZM nuk ka llogaritur dhe arkëtuar nga subjekti penalitetet 0,01 % nga data 19 korrik 2020 deri 17 qershor 2021 ose 10% te vlerës pagesës prej

811,5 leke kamatëvonesa *(8,115x10%)* për K. K., ne kundërshtim me nenin 5 /5.5 te kontratës qiraje nr. 34/3 date 19.08.2020.

* **Për vitin 2021**, sipas MA 08.09.2022 është paguar sipas Amendamentit nr. 1 date 16.09.2021 periudha 1–vjeçare date 19.08.2021 deri 19.08.2022 për vlerën 6,720 leke *(pa vlerën e tarifës bar-restorantit*), rezulton se nuk janë përllogaritur dhe arkëtuar penalitetet për mbi 1 vit tejkalim afati *(19.08.2021 deri 08.09.2022)* ose për vlerën **672 leke kamatëvonesa***(6720x10%)* për K.K, ne kundërshtim me nenin 5 /5.5 te kontratës qiraje nr. 34/3 date 19.08.2020.

b. Dosja e subjektit rezulton pa inventarë, pa numërim te dokumenteve, pa marrës dhe dorëzues, për periudhën 2019-2021**,** në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

8. ADZM Tirane ka lidhur kontratën e qirasë nr. 55/3 date 13.11.**2020** me subjektin **A.Sh** "*Për dhënien ne përdorim te sipërfaqes se zonës mbrojtur Mali Dajtit, Shupal-Selite, parcela 3/a*", për **3,200 m2** për aktivitet "*Vendosje njësi portative druri te çmontueshme pa themel, çadra kampingu",* me afat 5 vjeçar (2020-2025), nënshkruar nga drejtori I. V. dhe subjekti qiramarrës A. Sh., me vlerën e qirasë vjetore 16,640 leke.

Në Amendamentin nr. 1 date 16.09.2021 *(te kontratës nr. 55/3 date 13.11.2020)* neni 4 bëhen ndryshime ne vlerën e qirasë vjetore nga 16,640 leke behet 49,660 leke/vit, bazuar ne VKM nr. 1156 date 24.12.2020 *"Për përcaktimin e ardhurave gjeneruara nga tarifat qe paguhen ne zonat mbrojtura te masës dhe kritereve përdorimit tyre",* lidhja 1, ***por amendamenti duhej mbajtur ne dhjetor 2020 me ndryshimet ligjore dhe jo pas 9 muajve ne shtator 2021.***

Disponohet urdhri i drejtorit nr. 55/1 date 23.09.2020 për krijimin e grupit punës (*H.D, N.V dhe E. K)* për studimin e kërkesës dhe vlerësimin teknik-ekonomik te sipërfaqes 0,32 ha ne ZM për përdorim, disponohet dhe raport–vlerësimi përkatës.

-Disponohet kërkesa e subjektit nr. 55 date 17.09.2020 për marrjen e sipërfaqes 0,32 ha me qira për turizëm malor.

-Disponohet mendimi i pushtetit vendore nr. 1629 date 21.09.2020 i Njësise administrative Zall-Bastar.

-Disponohet miratimi i kontratës nga drejtori përgjithshëm AKZM z. Z.D, sipas urdhrit nr. 1169 date 06.11.2020.

-Disponohet Memo dhe opinion i drejtorit ADZM nr. ekstra date 06.11.2020 dhe nr. 55/1 date 25.09.2020, për drejtorin e përgjithshëm AKZM.

-Disponohen plan-rivelimi, plan biznesi, hartat, projekti, plan vendosja, planimetria etj, nënshkruar nga specialistet e fushës dhe subjekti, për parcelën 0,32 ha ne përdorim brenda ZM.

- Disponohet procesverbali dorëzimit 16.11.2020, për subjektin qe i jepet ne përdorim sipërfaqen 0,32 ha, nënshkruar nga dy palët qiramarrësi A. Sh. dhe qiradhënësi H.D. dhe roja mjedisore R.K

Pagesat e kryera te qirasë:

a. Për vitin 2021 (*13.11.2020 deri 13.11.2021)* **subjekti nuk ka likuiduar <u>diferencën 27,511 leke</u>** (*49,660-22149 =27,511 leke),* pasi ka likuiduar 22,149 leke, ne vend te 49,660 leke, sipas kërkesave te amendamentit nr. 1, date 16.09.2021 *(te kontratës nr. 55/3 date 13.11.2020)* neni 4 ku bëhen ndryshime ne vlerën e qirasë vjetore nga 16,640 leke behet 49,660 leke/vit, bazuar ne VKM nr. 1156 date 24.12.2020 *"Për përcaktimin e ardhurave gjeneruara nga tarifat qe paguhen ne zonat mbrojtura te masës dhe kritereve përdorimit tyre",* lidhja 1, pra hyn ne fuqi nga dhjetori i vitit 2020.

Kështu, për vitin 2021 disponohen 2 mandat pagesa për likuidimin e qirasë prej 22,149 leke, përkatësisht: MA date 13.11.2020 "*R. bank"* fotokopje për 16,640 leke dhe MA date 17.09.2021 "*BKT"* për 5,509 leke, ose gjithsejtë 22,149, ne vend te vlerës 49,660 leke pra diferenca 27,511 leke

Për vitin **2022** (*13.11.2021 deri 13.11.2022),* subjekti ka likuiduar te plote tarifën e qirasë vjetore prej 49,660 leke, sipas mandat pagesës 18.11.2021 *"BKT*".

b. Për vitin **2021** sipas dokumentacionit tekniko-ligjor, tarifa është përllogaritur dhe likuiduar për **sipërfaqen 80 m2 te restorantit, ne vend te sipërfaqes faktike prej 90 m2,** ndërsa **sipërfaqja 45 m2 e 3 kabinave druri nuk është përllogaritur fare**, pasi sipërfaqja e bar-restorantit përcaktohet 90 m2 dhe jo 80 m^2 qe si dhe sipërfaqja e 3 kabinave është 45 m2, e cila nuk është llogaritur. Për pasoje **diferenca 27,500 leke (**55 m2 (10+45) x 500 leke/m2=27,500).**e pa paguar** nga subjekti A. Sh.

c. Ne mënyre te paligjshme është shtyre afati i kontratës nga 5 vjet ne 10 vjet *(2021-2031),* sipas amendamentit nr. 2 date 20.10.2021, **pasi duhej shtyre 3 muaj para mbarimit te afatit te kontratës 5 vjeçare** *(2020-2025),* ne kundërshtim me nenin 3, pika 3.1 dhe 3.2 te kontratës nr. 55/3 date 13.11.2020 neni 4. Disponohet kërkesa e subjektit nr. 80 date 27.08.2021 dhe miratimi nr. 80/1 date 18.10.2021 nga Z.D drejtor i AKZM.

d. Dosja e subjektit rezulton pa inventarë, pa numerizim te dokumenteve, pa marrës dhe dorëzues, për periudhën 2019-2021**,** në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

9. ADZM Tirane ka lidhur kontratën e qirasë nr. 13/3 date 06.04.**2020** me subjektin **G.L** "*Për dhënien ne përdorim te sipërfaqes se zonës mbrojtur Mali Dajtit, Shupal-Selite, parcela 17/d*", për **3,500 m2** për aktivitet "*Vendosje portative druri te çmontueshme pa themel, bar-restorant 140 m2 dhe disa kabina 10-15 m2, për kamping hapur ne natyre",* me afat 5 vjeçar (2020-2025), nënshkruar nga drejtori I. V dhe subjekti qiramarrës G. L., me vlerën e qirasë vjetore 18,200 leke.

Disponohet urdhri i drejtorit nr. ekstra date 02.03.2020 për krijimin e grupit punës *(H.D, K.S dhe E. K)* për studimin e kërkesës dhe vlerësimin teknik-ekonomik te sipërfaqes 0,35 ha ne ZM për përdorim si dhe raport–vlerësimi përkatës.

-Disponohet miratimi i kontratës nga drejtori përgjithshëm AKZM z. Z.D, sipas urdhrit nr. 299/1 date 02.04.2020.

-Disponohet Memo dhe opinion i drejtorit ADZM nr. 299/2 date 02.04.2020 dhe nr. 13/1 date 04.03.2020, për drejtorin e përgjithshëm AKZM.

-Disponohen plan biznesi, hartat, projekti, plan vendosja, etj, nënshkruar nga specialistet e fushës dhe subjekti, për parcelën 0,35 ha ne përdorim brenda ZM,

- Disponohet procesverbali dorëzimit 08.04.2020, për subjektin qe i jepet ne përdorim sipërfaqen 0,35 ha, nënshkruar nga dy palët qiramarrësi G.L dhe qiradhënësi H.D dhe roja mjedisore R.K.

- Disponohet Mandat pagesa bankare 06.04.2020 "*R. bank"* fotokopje, për likuidimin e tarifës qirasë vjetore 18,200 leke për vitin **2020** (*16.04.2020 deri 16.04.2021),* sipas kërkesave te kontratës 13/3 date 06.04.2020.

* Disponohet 2 Mandat pagesa *"BKT"* për likuidimin e tarifës qirasë vjetore për 31,500 leke te vitit **2021** (*16.04.2021 deri 16.04.2022),* sipas Amendamenti nr. 1 date 21.09.2021 *(te kontratës nr. 13/3 date 06.04.2020)* neni 4, ku bëhen ndryshime ne vlerën e qirasë vjetore nga 18,200 leke behet 31,500 leke/vit, përkatësisht: MA date 19.03.2021 për 23,967 leke dhe MA date 21.09.2021 për 7,760 leke.

* Disponohet Mandat pagesa bankare 30.03.2022 "*R. bank"* fotokopje, për likuidimin e tarifës qirasë vjetore 31,500 leke për vitin **2022** (*16.04.2022 deri 16.04.2023),* sipas kërkesave te amendamentit nr. 1 te kontratës 13/3 date 06.04.2020. Theksojmë se ne pagese nuk është përfshire qiraja e sipërfaqes restorantit dhe kabinave drurit.

Nga auditimi rezultoi:

a. Subjekti për vitin 2021 nuk ka përllogaritur dhe paguar qiranë vjetore për <u>80,000 leke,</u> për sipërfaqen 140 m^2 **te restorantit dhe 20 m2 kabinat drurit** *(160 m2 x 500= 80,000 leke)*, bazuar ne dokumentacionin tekniko-ligjor. Theksojmë se mungojnë dokumentet përfundimtare për sipërfaqen e restorantit dhe kabinave**,** dokumente baze për përllogaritjen tarifës tyre.

b. Mungon mendimi i pushtetit vendor, nëse kjo pjese e zonës mbrojtur dhëne ne përdorim preket nga projekti madhor i rrugës "Arbrit", ne fakt ajo preket ku ZM 0,35 ha është ndare ne 2 pjese nga rruga, fakt për ketë është kërkesa e subjektit nr. 127 date 19.09.2022 dhe miratimi i kësaj kërkese për interes publik nga AKZM, për sipërfaqen 1900 m^2 te zëne nga rruga dhe marrjen ne një vend tjetër te saj. Pra kontrata nuk duhej lidhur ne ketë zone, pasi rruga e Arbrit kishte nisur dhe kalonte neper ketë parcele.

c. Dosja e subjektit rezulton pa inventarë, pa numerizim te dokumenteve, pa marrës dhe dorëzues, për periudhën 2019-2021**,** në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

10. ADZM Tirane ka lidhur kontratën e qirasë nr. 44/4 date 16.06.**2021** me subjektin **A.K** "*Për dhënien ne përdorim te sipërfaqes se zonës mbrojtur Mali Dajtit, Shupal-Selite, parcela 28/b*", për **2,460 m2** për aktivitet *"qendër rekreacioni, pushimi, argëtim, shëndetësore për zhvillimin e turizmit pa cenuar natyrën",* me afat 5 vjeçar (2021-2026), nënshkruar nga drejtori I.V dhe subjekti qiramarrës A. K, me vlerën e qirasë vjetore 16,022 leke.

Vlera e qirasë vjetore ka ndryshuar nga 16,022 leke ne 16,930 leke, sipas Amendamentit nr. 1 date 17.09.2021 neni 4, bazuar ne VKM nr. 1156 date 24.12.2020 *"Për përcaktimin e ardhurave gjeneruara nga tarifat qe paguhen ne zonat mbrojtura te masës dhe kritereve përdorimit tyre",* por ky ndryshim duhej bere tek kontrata 44/4 date 16.06.2021, pasi VKM ka hyre ne fuqi ne dhjetor 2020.

- Disponohet urdhri i drejtorit nr. 44/1 date 10.05.2021 për krijimin e grupit punës *(H.D, N. V dhe E. K.)* për studimin e kërkesës dhe vlerësimin teknik-ekonomik te sipërfaqes 0,246 ha ne ZM për përdorim, si dhe raport–vlerësimi perkates.
- Disponohet miratimi i kontratës nga drejtori përgjithshëm AKZM z. Z.D, sipas urdhrit nr. 703 date 11.06.2021.
- Disponohet Memo dhe opinion nr. ekstra date 11.06.2021 dhe nr. 44/2 date 11.05.2021, për drejtorin e përgjithshëm AKZM.
-Disponohen plan biznesi, hartat, projekt studimi dhe arkitekturës, plan vendosja, mendimi i njësisë vendore.
- Disponohet procesverbali dorëzimit 17.06.2021, për subjektin qe i jepet ne përdorim sipërfaqen 0,246 ha, nënshkruar nga dy palët qiramarrësi A.K dhe qiradhënësi H. D dhe roja mjedisore A.B.

<u>*Pagesa e qirasë është kryer sa vijon*</u>:

* Disponohen 2 mandat pagesa date 16.06.2021 *"BKT"* dhe date 20.09.2021 fotokopje, për likuidimin e tarifës qirasë vjetore 16,930 leke për vitin **2021** (*16.06.2021 deri 16.06.2022),*
* Disponohet mandat pagesa date 11.06.2022 për vlerën 16,930 leke për vitin **2022** (*16.06.2022 deri 16.06.2023),* sipas amendamentit nr. 1.

Disponohet mandat pagesa bankare"R. bank" 28.02.2022 për 30,000 leke për VNM.

a. Subjekti për vitin 2021 nuk ka likuiduar diferencën <u>118,000 leke,</u> pasi nuk është përllogaritur dhe arkëtuar qiraja e sipërfaqes ndërtimit bar-restorant dhe kabinat prej 236 m2 x 500 lek/m2 =118,000 leke.

Kjo sipërfaqe është bazuar ne te dhënat e këtyre dokumenteve, përkatësisht:

* ***Vendimi i VNM*** date 30.06.2022***, ku përcaktohet gjurma e ndërtimit 236 m2*** (*bar restorant =110 m2 dhe disa kabina druri= 126 m2 ose gjithsejtë 236 m2 njolla e ndërtimit*) etj.
* ***Leja e ndërtimit elektronike*** date 14.04 2022, për strukture shërbimi dhe akomodimi 1-kat prej konstruksion druri ndërtimi, ***ku përcaktohet gjurma e ndërtimit 236 m2*** (*bar restorant =110 m2 dhe disa kabina druri= 126 m2 ose gjithsejtë 236 m2 njolla e ndërtimit*).
Theksojmë se ne rastet tjera nuk disponohen këto dokumente me këto te dhënat mbi sipërfaqet e ndërtesave te përfunduara.
b. Dosja e subjektit rezulton pa inventarë, pa numerizim te dokumenteve, pa marrës dhe dorëzues, për periudhën 2019-2021**,** në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

11. ADZM Tirane ka lidhur kontratën e qirasë nr. 9/4 date 18.03.**2021** me subjektin **A.E,** për dhënien ne përdorim te sipërfaqes se zonës mbrojtur Mali Dajtit, Shupal-Selite, parcela 8/c", për **1,960 m2** për aktivitet **"***Vendosje njësi portative druri te çmontueshme pa themel, dhe materiale tjera ndërtimi Zall-Bastar*" me afat 5 vjeçar (2021-2026), nënshkruar nga drejtori I. V. dhe subjekti qiramarrës A. E., me vlerën e qirasë vjetore 23,667 leke.
Vlera e qirasë vjetore ka ndryshuar nga 23,667 leke ne 31,045 leke, sipas Amendamentit nr. 1 date 17.09.2021 neni 4, bazuar ne VKM nr. 1156 date 24.12.2020 *"Për përcaktimin e ardhurave gjeneruara nga tarifat qe paguhen ne zonat mbrojtura te masës dhe kritereve përdorimit tyre".*
Nga auditimi rezultoi:
a. Dokumentacioni ka mospërputhje, pasi sipas projekt studimit subjektit sipërfaqja e bar-restorantit pasqyrohet 120 m2, ndërsa sipas Amendamentit nr. 1 ajo pasqyrohet 30 m2 pa dokument justifikues. Për rrjedhoje nga përllogaritjet rezulton se për vitin **2021** subjekti nuk ka likuiduar **diferencën <u>32,337 leke</u>** (60,000-27,663). *Përfundimisht*, për llogaritja dhe arkëtimi i qirasë sipërfaqes ndërtimit bar-restorant është bere i pasakte dhe i pjesshëm. *Kështu,* duhej përllogaritur për 120 m2 x 500 lek/m2 = 60,000 leke/vit qira vjetore e bar-restorantit dhe jo sipas amendamenti nr. 1 për 30 m2 x 500 = 15,000 leke/vit.
Disponohet 2 MA për likuidimin e vlerës 27,663 leke, sipas mandat pagesa bankare 18.03.2021 "BKT" për likuidimin e vlerës 23,667 leke dhe mandat pagesa date 17.09.2021 fotokopje, për likuidimin e vlerës 3,996 leke , sipas amendamentit nr. 1, për vitin 2021 (18.03.2021 deri 18.03.2022,
b. Dokumentacioni ne dosje përbehet nga këto dokumente:
- Disponohet kërkesa e subjektit A.E nr. 9 date 27.01.2021.
- Disponohet urdhri i drejtorit nr. 9/1 date 28.01.2021 për krijimin e grupit punës *(H.D,N.V,E.K)*për studimin e kërkesës dhe vlerësimin teknik-ekonomik te sipërfaqes 0,196 ha ne ZM për përdorim, si dhe raport–vlerësimi përkatës.
- Disponohet miratimi i kontratës nga drejtori përgjithshëm AKZM z. Z.D, sipas urdhrit nr. 59 date 09.03.2021.
- Disponohet Memo dhe opinion i drejtorit ADZM nr. ekstra date 09.03.2021 dhe nr. 9/2 date 03.02.2021, për drejtorin e përgjithshëm AKZM.
-Disponohen plan biznesi, hartat, projekt studimi dhe arkitekturës, plan vendosja, mendimi i njësisë vendore.
- Disponohet procesverbali dorëzimit 24.03.2021, për subjektin qe i jepet ne përdorim sipërfaqen 0,196 ha, nënshkruar nga dy palët qiramarrësi A.E dhe qiradhënësi H.D dhe roja mjedisore R.K.

c. Dosja e subjektit rezulton pa inventarë, pa numerizim te dokumenteve, pa marrës dhe dorëzues, për periudhën 2019-2021**,** në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

12. ADZM Tirane ka lidhur kontratën e qirasë nr. 39/5 date 18.05.**2021** me subjektin **"F" shpk,** për dhënien ne përdorim te sipërfaqes se zonës mbrojtur Mali Dajtit, Shupal-Selite, parcela 56, për **3,000 m2** për aktivitet *"qendër rekreacioni, pushimi, argëtim, shëndetësore për zhvillimin e turizmit pa cenuar natyrën",* me afat 5 vjeçar (2021-2026), nënshkruar nga drejtori I. V., dhe subjekti qiramarrës "F" shpk, F.D, me vlerën e qirasë vjetore 27,000 leke.
Vlera e qirasë vjetore ka ndryshuar nga 27,000 leke ne 28,250 leke, sipas Amendamentit nr. 1 date 21.09.2021 neni 4, bazuar ne VKM nr. 1156 date 24.12.2020 *"Për përcaktimin e ardhurave gjeneruara nga tarifat qe paguhen ne zonat mbrojtura te masës dhe kritereve përdorimit tyre".* Nga auditimi rezultoi:
a. Me shkresën nr. 122 date 15.09.2022 te AKZM është njoftuar subjekti qiramarrës *"F" shpk*, F. D, për **zgjidhjen e kontratës date 18.05.2021, pasi subjekti nuk ka kryer pagesën e qirasë dhe nuk ka zhvilluar aktivitet** sipas kushteve te kontratës *(Disponohet mandat pagesa bankare 23.09.2021 "BKT" fotokopje për likuidimin e vlerës 885 leke dhe mandat pagesa date 19.05.2021 fotokopje, për likuidimin e vlerës 27,000 leke , sipas amendamentit nr. 1, për vitin 2021* (*18.05.2021 deri 18.05.2022).*
b. Dokumentacioni ne dosje:
- Disponohet kërkesa e subjektit nr. 34 date 22.04.2021.
- Disponohet urdhri i drejtorit nr. 39/1 date 05.05.2021 për krijimin e grupit punës *(H.D, N.V dhe E. K)* për studimin e kërkesës dhe vlerësimin teknik-ekonomik te sipërfaqes 0,3 ha ne ZM për përdorim, si dhe raport–vlerësimi perkates.
- Disponohet miratimi i kontratës nga drejtori përgjithshëm AKZM z. Z.D, sipas urdhrit nr. 105 date 12.05.2021.
- Disponohet Memo dhe opinion i drejtorit ADZM nr. ekstra date 12.05.2021 dhe nr. 39/2 date 07.05.2021, për drejtorin e përgjithshëm AKZM Tirane.
-Disponohen plan biznesi, hartat, projekt studimi, mendimi i njësisë vendore,
- Disponohet procesverbali dorëzimit 20.05.2021, për subjektin qe i jepet ne përdorim sipërfaqen 0,196 ha, nënshkruar nga dy palët qiramarrësi dhe qiradhënësi.
c. Dosja e subjektit rezulton pa inventarë, pa numerizim te dokumenteve, pa marrës dhe dorëzues, për periudhën 2019-2021, në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

13. ADZM Tirane ka lidhur kontratën e qirasë nr. 43/4 date 31.05.**2021** me subjektin **E.B,** për dhënien ne përdorim te sipërfaqes se zonës mbrojtur Mali Dajtit, parcela 86, për **120 m2** për aktivitet *"**P- A**, qitje ne natyre me arme sportive",* me afat 5 vjeçar (2021-2026), nënshkruar nga drejtori I.V dhe subjekti qiramarrës E. B., me vlerën e qirasë vjetore 9,000 leke.
Vlera e qirasë vjetore ka ndryshuar nga 9,000 leke ne 19,500 leke, sipas Amendamentit nr. 1 date 22.08.2021 neni 4, bazuar ne VKM nr. 1156 date 24.12.2020 *"Për përcaktimin e ardhurave gjeneruara nga tarifat qe paguhen ne zonat mbrojtura te masës dhe kritereve përdorimit tyre".*
Dokumentacioni ne dosje përbehet nga këto shkresa:
- Disponohet kërkesa e subjektit nr. 43 date 06.05.2021.

- Disponohet urdhri i drejtorit nr. 43/1 date 07.05.2021 për krijimin e grupit punës *(H.D,N.V,E.K)*për studimin e kërkesës dhe vlerësimin teknik-ekonomik te sipërfaqes 0,0120 ha ne ZM për përdorim si dhe raport–vlerësimi.
- Disponohet miratimi i kontratës nga drejtori përgjithshëm AKZM z. Z.D, sipas urdhrit nr. 109 date 17.05.2021 *për 0,3 ha gabimisht*, duhej 0,012 ha sipas kontratës lidhur.
- Disponohet Memo e drejtorit ADZM nr. ekstra date 17.05.2021 dhe nr. 43/2 date 10.05.2021, për drejtorin e përgjithshëm AKZM.
-Disponohen plan biznesi, hartat, projekt studimi, mendimi i njësisë vendore.
- Disponohet procesverbali dorëzimit 02.06.2021, për subjektin qe i jepet ne përdorim sipërfaqen 0,012 ha, nënshkruar nga dy palët qiramarrësi dhe qiradhënësi.
-Subjekti ka likuiduar te plota detyrimet e qirasë për vitin 2021 dhe 2022 sipas kërkesave te kontratës dhe amendamentit te lidhur. Kështu disponohen mandat pagesa bankare 31.05.2021 *"BKT"* fotokopje për 9,000 leke te derdhura dhe mandat pagesa date 22.09.2021 fotokopje, për likuidimin e tarifës qirasë vjetore 19,500 leke për vitin 2021 (31.*05.2021 deri 31.05.2022),* si dhe mandat arketimi date 05.01.2022 *"U-bank*" për 19500 leke.

Dosja e subjektit rezulton pa inventarë, pa numerizim te dokumenteve, pa marrës dhe dorëzues, për periudhën 2019-2021**,** në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

14. Për vitin 2020 dhe 2021 ne ZM "Parku Kombëtar Mali Dajtit", ADZM Tirane ka lidhur kontratën me qira me subjektin **D. P.,** rezulton se:

a. Pa baze ligjore ka lidhur 4 kontrata e amendamente me subjektin *D. P.* me përfaqësues A. Sh., **ne vend te 1 kontrate,** kështu **duke ndryshuar** dhe **shtuar sipërfaqet me qira te ndodhura ne te njëjtin vend** ne zonat e mbrojtura, konkretisht:

- Kontratën e qirasë nr. 35/3 date 14.09.**2020** për dhënien ne përdorim te sipërfaqes se zonës mbrojtur Parku Kombëtar Mali Dajtit, parcela 75 dhe 76a, për sipërfaqen **13,449** m^2 për aktivitet *"qendër rekreacioni, pushimi, argëtim, shëndetësore, shoqërore, kënd lojërash, mjedise sportive etj",* me afat 5 vjeçar (2020-2025), nënshkruar nga drejtori I. V. dhe subjekti qiramarrës A. Sh. me vlerën e qirasë vjetore 121,014 leke.
- Kontratës baze *pas 1 viti i* ***shtohet sipërfaqja*** **33,885 m2**, parcela 74a, 75 dhe 76a, sipas kontratës nr. 30/6 date 21.07.**2021** me afat 5 vjeçar *(2021-2026*) me vlerën e qirasë vjetore 304,965 leke.
- Kontratës pas 1 muaji përsëri i ***shtohet sipërfaqja*** **47,334 m2**, parcela 74a, 75 dhe 76a, sipas amendamentit nr. 1 date 26.08.**2021**, me vlerën qirasë vjetore 426,006 leke.

b. Ne kundërshtim me nenin 3, pika 3.2 te kontratave nr. 35/3 date 14.09.2020 dhe nr. 30/6 date 21.07.2021, **pa mbaruar afati 5-vjeçar i kontratës ose pas 1 muaji është shtyre afati kohor nga 5 vjet qe ishte ne 10 vjet** *(2021- 2031),* sipas amendamentit nr. 2 date 13.09.2021 (*me vlere te qirasë vjetore 497,938 leke* për 47,334 m2***)***, nënshkruar nga drejtori I. V. dhe subjekti qiramarrës.

* **Dosja përbehet nga këto dokumente**, sa vijon:

- Disponohet kërkesa e subjektit nr. 30 date 20.04.2021 dhe kërkesa për bashkimin e 2 kontratave 14.09.2020 dhe 21.07.2021 ne 1 te vetme.
-Disponohet kërkesa e subjektit nr. 67 date 26.08.2021 për zgjatje afatit kontratës nga 5 vjet ne 10 vjet dhe kthim përgjigje nr. 1024/1 date 03.09.2021 te AKZM.
- Disponohet urdhri i drejtorit nr. 30/2 date 28.04.2021 për krijimin e grupit punës *(H.D,N.V,E.K)*për studimin e kërkesës dhe vlerësimin teknik-ekonomik te sipërfaqes 3,388 ha ne ZM për përdorim, si dhe raport vlerësimi perkates.

c. Disponohet raport–vlerësimi 28.04.2021 i grupit punës ne terren, ku **përllogaritja e tarifës qirasë vjetore është 304,965 leke (***3,388846 ha x 90,000/ha= 304,965***)**, sipas VKM nr. 391 date 21.06.2006 ndryshuar me VKM nr. 1064 date 22.12.2010 "*Për përcaktimin e tarifave ne sektorin pyjor dhe kullotave*", **ne vend qe te përllogaritej sipas VKM nr. 1156 date 24.12.2020** *"Për përcaktimin e ardhurave gjeneruara nga tarifat qe paguhen ne zonat mbrojtura te masës dhe kritereve përdorimit tyre",* lidhja 1, **pasi është ne fuqi kjo e fundit** ***(****VKM nr. 1156 date 24.12.2020)* **dhe jo 2 VKM e para** *(VKM nr. 391 date 21.06.2006 dhe VKM nr. 1064 date 22.12.2010).*

- Disponohet njoftimi i ADZM për subjektin për lidhjen kontratës për 3,388 ha.
- Disponohet miratimi i kontratës nga drejtori përgjithshëm AKZM z. Z.D, sipas urdhrit nr. 108 date 17.05.2021 për 3,388 ha.
- Disponohet Memo e drejtorit ADZM nr. ekstra date 17.05.2021 dhe nr. 43/2 date 10.05.2021, për drejtorin e përgjithshëm AKZM si dhe opinioni për zhvillimin e projektit te subjektit nr. 30/3 date 30.04.2021.
-Disponohen plan biznesi, hartat, projekt studimi, mendimi i njësisë vendore,
- Disponohet procesverbali dorëzimit 26.07.2021, për subjektin qe i jepet ne përdorim sipërfaqen 3,388 ha, nënshkruar nga dy palët qiramarrësi A. Sh. dhe qiradhënësi H. D. dhe E. D.
- Disponohet kthim përgjigje subjektit nga AKZM nr. 574 date 28.04.2022, për miratimin dhe vendosjen e strukturës lejes provizore ne PK "Mali Dajtit", nënshkruar nga drejtori përgjithshëm i komanduar L. B
- Disponohet kthim përgjigje subjektit nga AKZM nr. 1734/1 date 13.09.2022, nënshkruar nga drejtori përgjithshëm i komanduar D.P., për miratimin e zëvendësimit çatise prishur, ne vend qe miratimi dhe leja te merrej nga pushteti vendor, pasi objektet ndërtimore disa shtëpiza prej druri janë me leje ndërtimi te KKRT Tirane nr. 33 date 10.07.1996.

d. Subjekti nuk ka likuiduar <u>diferencën 277,685 leke</u> *(775,623–497,938)* për vitet *2020-2021-2022*, sipas kushteve te përcaktuara ne kontratat dhe amendamentet, konkretisht sipas viteve:

Likuidimi i detyrimeve nga subjekti paraqitet për 497,938 leke, konkretisht:

- Subjekti ka likuiduar 304,965 leke detyrimet e qirasë për vitin 2021, sipas mandat pagesës bankare date 21.07.2021 *"BKT"* fotokopje.
- Subjekti ka likuiduar 121,041 leke detyrimet e qirasë, sipas mandat pagesës bankare date 26.08.2021 *"BKT"* fotokopje , lidhur me Amendamentin nr. 1.
- Subjekti ka likuiduar 71,932 leke detyrimet e qirasë, sipas mandat pagesës bankare date 16.09.2021 *"BKT"* fotokopje , lidhur me Amendamentin nr. 2 date 13.09.2021.

Ne fakt subjekti duhej te likuidonte 775,623 lekë detyrime 2020-2021-2022, bazuar ne kontratat, amendamentet përkatëse dhe VKM nr. 391 date 21.06.2006 ndryshuar me VKM nr. 1064 date 22.12.2010 "*Për përcaktimin e tarifave ne sektorin pyjor dhe kullotave*", ndryshuar me VKM 1156 date 24.12.2020 *"Për përcaktimin e ardhurave gjeneruara nga tarifat qe paguhen ne zonat mbrojtura te masës dhe kritereve përdorimit tyre",* lidhja 1, konkretisht:

- *120,960 leke*, për periudhën 3 mujorit 2020 (shtator-dhjetor), sipas kontratën e qirasë nr. 35/3 date 14.09.2020 për sipërfaqen 13,449 m2 **(***1,344 ha x 90,000/ha= 120,960***)**, sipas VKM nr. 391 date 21.06.2006 ndryshuar me VKM nr. 1064 date 22.12.2010 "*Për përcaktimin e tarifave ne sektorin pyjor dhe kullotave*",
- *156,725 leke* (277,685-120,960) për periudhën 9 mujorit 2021 (janar- shtator), sipas kontratën e qirasë nr. 35/3 date 14.09.2020 për sipërfaqen 13,449 m2, bazuar ne VKM 1156 date 24.12.2020 *"Për përcaktimin e ardhurave gjeneruara nga tarifat qe paguhen ne zonat mbrojtura te masës dhe kritereve përdorimit tyre",* lidhja 1, përkatësisht:

^ 382 m2 (bar-restorant hotel) x 500 leke = 191,000 leke,
^ 500 m2 x 10 = 5,000 leke,
^ 12,567 m2 x 6,5 leke = 81,685 leke,
- *497,938 leke* për periudhën 2022 (shtator 2021–shtator 2022), sipas amendamentit nr. 2 date 13.09.2021 për sipërfaqen 47,334 m2, bazuar ne VKM 1156 date 24.12.2020 *"Për përcaktimin e ardhurave gjeneruara nga tarifat qe paguhen ne zonat mbrojtura te masës dhe kritereve përdorimit tyre",* lidhja 1, përkatësisht:
^ 382 m2 (bar-restorant hotel) x 500 leke = 191,000 leke,
^ 500 m2 x 10 = 5,000 leke,
^ 46,452 m2 x 6,5 leke = 301,938 leke,

e. Mungon dokumenti përfundimtare qe pasqyron sipërfaqet ndërtimore te objekteve, për efekt te përllogaritjes tarifës qirasë, përkatësisht:
- 1 vile 2-kat bar-restorant,
- vile 3-kat hoteleri-suit,
- 5 vila hotelerie disa shtëpiza druri,

k. Dosja e subjektit rezulton pa inventarë, pa numerizim te dokumenteve, pa marrës dhe dorëzues, për periudhën 2019-2021, në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

15. ADZM Tirane ka lidhur kontratën e qirasë nr. 13/4 date 03.08.**2021** me subjektin **E.K,** për dhënien ne përdorim te sipërfaqes se zonës mbrojtur Mali Dajtit, parcela 71b, për **6,500 m2** për aktivitet *"Qendër rekreacioni, pushimi, argëtim, shëndetësore, për zhvillimin e turizmit pa cenuar vlerat natyrore",* me afat 5 vjeçar (2021-2026), nënshkruar nga drejtori I. V. dhe subjekti qiramarrës E. K., me vlerën e qirasë vjetore 49,000 leke.
Vlera e qirasë vjetore ka ndryshuar nga 49,000 leke ne 54,000 leke, sipas Amendamentit nr. 1 date 03.08.2021 neni 4, bazuar ne VKM nr. 1156 date 24.12.2020 *"Për përcaktimin e ardhurave gjeneruara nga tarifat qe paguhen ne zonat mbrojtura te masës dhe kritereve përdorimit tyre",*përkatësisht:
- 1500 m2 x 10 = 15,000 leke,
- 2000 m2 x 7 = 1,950 leke,
- 2500 m2 x 6,5 = 16,250 leke,
- 500 m2 x 4 = 3,250 leke.

Dokumentacioni ne dosje përbehet nga këto shkresa:
- Disponohet kërkesa e subjektit nr. 13 date 22.02.2021.
- Disponohet vërtetimi i tatimeve Tirane date 08.05.2021, për shlyerjen e detyrimeve fiskale për aktivitetin bar-restorant adresa Dreje Qafe Molle Dajt.
- Disponohet projekt studimi i subjektit për bar-restorant prej druri,
- Disponohet urdhri i drejtorit nr. 13/1 date 24.02.2021 për krijimin e grupit punës *(H.D,N.V,E.K)*për studimin e kërkesës dhe vlerësimin teknik-ekonomik te sipërfaqes 0,65 ha ne ZM për përdorim, si dhe raport–vlerësimi perkates.
- Disponohet miratimi i kontratës nga drejtori përgjithshëm AKZM z. Z.D, sipas urdhrit nr. 85 date 07.04.2021 *për 0,65 ha* me afat 5 vjeçar.
- Disponohet Memo e drejtorit DZM nr. ekstra date 17.04.2021 dhe opinioni për zhvillimin e projektit nr. 13/2 date 01.03.2021, për drejtorin e përgjithshëm AKZM.
-Disponohen plan biznesi, hartat, projekt studimi, mendimi i njësisë vendore date 29.01.2021,

- Disponohet procesverbali dorëzimit 06.08.2021, për subjektin qe i jepet ne përdorim sipërfaqen 0,65 ha, nënshkruar nga dy palët qiramarrësi dhe qiradhënësi.
- Disponohet **kërkesa e subjektit nr. 35/1 date 27.04.2021**, **për zgjatje afati nga 5 vjet ne 10 vjet te kontratës, e cila nuk është miratuar,** sipas shkresës 35/3 date 21.05.2021 te DP AKZM**.**
-Subjekti ka likuiduar detyrimet e qirasë për vitin 2021 sipas kërkesave te kontratës dhe amendamentit te lidhur. Kështu disponohen mandat pagesa bankare 03.08.2021 *"BKT"* fotokopje për 49,000 leke dhe mandat pagesa date 23.09.2021 fotokopje "*R. BANK*" për 5,000 leke, pra gjithsejtë 54,000 leke qira vjetore për vitin 2021 (3*.08.2021 deri 3.08.2022).* Po kështu ka likuiduar 54,000 leke qira vjetore për vitin 2022 (3*.08.2022 deri 3.08.2023).*
Nuk është përllogaritur dhe arkëtuar tarifa për sipërfaqen e bar-restorantit, për te cilin nuk disponohet asnjë dokument, përjashtuar vërtetimin tatimeve 08.05.2021 dhe projekt studimin e subjektit *për ekzistencën e lokalit pa përcaktuar sipërfaqen*.
Dosja e subjektit rezulton pa inventarë, pa numerizim te dokumenteve, pa marrës dhe dorëzues, për periudhën 2019-2021**,** në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

16. ADZM Tirane ka lidhur kontratën e qirasë nr. 57/4 date 16.09.**2021** me subjektin **A.D,** për dhënien ne përdorim te sipërfaqes se zonës mbrojtur Mali Dajtit, parcela 36b, për **191,5 m2** për aktivitet *"**Vendosje Antene**",* me afat 5 vjeçar (2021-2026), nënshkruar nga drejtori I. V. dhe subjekti qiramarrës A. D., me vlerën e qirasë vjetore 191,500 leke, bazuar ne VKM nr. 1156 date 24.12.2020 *"Për përcaktimin e ardhurave gjeneruara nga tarifat qe paguhen ne zonat mbrojtura te masës dhe kritereve përdorimit tyre".* Nga auditimi u konstatua:
a. Dokumentacioni ne dosje përmban te gjitha shkresat e duhura**, por rezulton pa inventarë,** pa numerizim te dokumenteve, në kundërshtim me kërkesat nenit 3 dhe 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".
b. Subjekti A.D nuk ka arkëtuar 191,500 leke tarifë qirasë Antenës për vitin 2021 *(16.09.2021 deri 16.09.2022*), ndërsa për vitin 2022 ka likuiduar te plote qiranë prej 191,500 leke, sipas mandat arkëtimit date 11.10.2022 te C.-bank.

17. ADZM Tirane ka lidhur kontratën e qirasë nr. 110/4 date 17.12.**2021** me subjektin **Sh. A,** për dhënien ne përdorim te sipërfaqes se zonës mbrojtur Mali Dajtit, parcela 71a dhe 72b, për sipërfaqen **10,994 m2** për aktivitet *"Qendër rekreacioni, pushimi, argëtim, shëndetësore, për zhvillimin e eko-turizmit pa cenuar vlerat natyrore",* me afat 5 vjeçar (2021-2026), nënshkruar nga drejtori I.V dhe subjekti qiramarrës Sh. A.
Vlera e qirasë vjetore është përcaktuar ne kontrate për shumen 58,323 leke, bazuar ne VKM nr. 1156 date 24.12.2020 *"Për përcaktimin e ardhurave gjeneruara nga tarifat qe paguhen ne zonat mbrojtura te masës dhe kritereve përdorimit tyre",* vlere e cila është arkëtuar, sipas mandat pagesës date 20.12.2021 te "BKT" *(fotokopje).*
Nga auditimi u konstatua se:
a. Nuk ka përllogaritje te tarifës qirasë vjetore për sipërfaqen e ndërtesës 274 m2, pasi godina soc-ekonomike 1-kat dhe 2-kat është **ndërtim pa leje**, ndërsa **padrejtësisht është legalizuar nga ASHK Rurale 1, sipas lejes legalizimit nr. 139606 date 29.06.2020 dhe pajisur me certifikate pronësie date 10.09.2021,** pasi pozicionohet mbi zonën e mbrojtur, ne kundërshtim me nenin 22/3/b te ligjit 20/20 date 05.03.2020 "*Për përfundimin e proceseve kalimtare pronësisë ne RSH",* me nenin 19/3 dhe neni 9/dh te vendimit nr. 408 date 13.05.2015 "*Për miratimin e rregullores se zhvillimit territorit",* me

planin vendor të miratuar, pasi zona ku ndodhet objekti nuk përcakton për ndërtime, por për aktivitete social–kreative.

Pra, s**ubjekti ne zonën e mbrojtur ka ndërtuar pa leje,** nga ASHK është **legalizuar dhe pajisur me certifikate pronësie,** ndërsa nga **ADZM me miratim te AKZM i jepet subjektit edhe 1 ha sipërfaqe tjetër ne përdorim**, ne kundërshtim me ligjin nr. 81/2017 "*Për zonat e mbrojtura*", neni 2 dhe 16/2/a *"Parku Kombëtar"*, me nenin 35 te ligjit ALUIZNI i ndryshuar, me Kodin Civil pika 19, me kreun II/ë te VKM 756, me ligjin 20/2020 "*Për përfundimin e proceseve kalimtare pronësisë ne RSH*", me VKM nr. 1040 date 25.11.2020 *"Për përcaktimin rregullave zbatimit kritereve legalizimit dhe miratimin modelit aktit legalizimit, për ndërtimet pa leje",* pika 18/ë, ku thuhet:

Ndërtimi pa leje nuk legalizohet kur është ngritur brenda territorit te zonës mbrojtur...

b. Dosja e subjektit rezulton pa inventarë, pa numerizim te dokumenteve, në kundërshtim me kërkesat nenit 3 dhe 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

Dokumentacioni ne dosje përbehet nga këto shkresa:

- Disponohet kërkesa e subjektit nr. 110 date 21.10.2021.
- Disponohet urdhri i drejtorit nr. 110/1 date 21.10.2021 për krijimin e grupit punës *(H.D,N.V,E.K)*për studimin e kërkesës dhe vlerësimin teknik-ekonomik te sipërfaqes 1,0994 ha ne ZM për përdorim, si dhe raport–vlerësimi perkates.
- Disponohet miratimi i kontratës nga drejtori përgjithshëm AKZM z. Z.D, sipas urdhrit nr. 261 date 10.12.2021 *për 1,0994 ha* me afat 5 vjeçar.
- Disponohet opinioni i ADZM për zhvillimin e projektit nr. 110/2 date 25.10.2021, për drejtorin e përgjithshëm AKZM.
-Disponohen plan biznesi, hartat, projekt studimi,
- Disponohet procesverbali dorëzimit 23.12.2021, për subjektin qe i jepet ne përdorim sipërfaqen 1,0994 ha, nënshkruar nga dy palët qiramarrësi dhe qiradhënësi (*H.D. dhe A.B.).*

c. Mungon mendimi i pushtetit vendor (*njësia administrative Shëngjergj***),** ndërsa ne rastet tjera disponohet mendimi i pushtetit vendor, pasi zona e mbrojtur është pjese e juridiksionit tij**.**

18. ADZM Tirane ka lidhur kontratën e qirasë nr. 115/4 date 30.12.**2021** me subjektin "**H" shpk,** për dhënien ne përdorim te sipërfaqes se zonës mbrojtur Mali Dajtit, parcela 79a, dhe ekonomia pyjore Verri 1b,c, 12b, 13b dhe 72b, për sipërfaqen **53,640 m2** për aktivitet *"Qendër rekreacioni, pushimi, argëtim, shëndetësore, për zhvillimin e eko-turizmit pa cenuar vlerat natyrore",* me afat 5 vjeçar *(2021-2026*), nënshkruar nga drejtori I.V dhe subjekti qiramarrës E.B.

Vlera e qirasë vjetore është përcaktuar ne kontrate për 357,410 leke, bazuar ne VKM nr. 1156 date 24.12.2020 *"Për përcaktimin e ardhurave gjeneruara nga tarifat qe paguhen ne zonat mbrojtura te masës dhe kritereve përdorimit tyre",* vlere e cila është arkëtuar, sipas mandat pagesës date 07.01.2022 te "Fibank" *(fotokopje).*

a. Dosja rezulton pa inventarë, pa numerizim te dokumenteve, në kundërshtim me nenin 3 dhe 29 ligjit 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*". Dosja përbehet nga këto dokumente, sa vijon:

* Disponohet kërkesa e subjektit nr. 115 date 01.11.2021 dhe kërkesa nr. 5 date 10.01.2022 për zgjatje afati 10 vjeçar te kontratës..
* Disponohet urdhri i drejtorit nr. 115/1 date 05.11.2021 për krijimin e grupit punës *(H.D,N.V,E.K)*për studimin e kërkesës dhe vlerësimin teknik-ekonomik te sipërfaqes 5,364 ha ne ZM për përdorim, si dhe raport–vlerësimi përkatës.
* Disponohet miratimi i kontratës nga drejtori përgjithshëm AKZM z. Z.D, sipas urdhrit nr. 268 date 24.12.2021 *për 5,364 ha* me afat 5 vjeçar.

* Disponohet Memo nr. extra date 24.12.2021 dhe opinioni për zhvillimin e projektit nr. 115/2 date 08.11.2021, për drejtorin e përgjithshëm AKZM.
*Disponohen plan biznesi, hartat, projekt studimi.
* Disponohet procesverbali dorëzimit 06.01.2022, për subjektin qe i jepet ne përdorim sipërfaqen 5,364 ha, nënshkruar nga dy palët qiramarrësi dhe qiradhënësi *(H.D dhe A.B).*

b. Mungon mendimi i pushtetit vendor (njësia administrative Shëngjergj**)**

c. Sipas dokumenteve fillestare tekniko-ligjore te sipërcituara, rezulton se:
Nuk është përllogaritur dhe arkëtuar vlera **<u>520,000 leke</u>**, **tarifa qiraje për sipërfaqen ndërtimore gjithsejtë 1040 m2** *(300 m2 +200 m2 + 540 m2)* përkatësisht te bar-restorantit, te 10 kabinave dhe te 6 bujtinave**,** për periudhën 30.12.2021 deri 30.12.2022, përkatësisht:
* *150,000 leke, për sipërfaqen 300 m2 te bar-restorantit* prej druri, për tu shërbyer vizitoreve me ushqim tradicional (*300x500=150,000 leke*), sipas projektit subjektit për përdorimin e sipërfaqes pyjore për eko-turizëm,
* *100,000 leke, për sipërfaqen 200 m2 te 10 kabinave* druri me nga 20 m2/secila, për qellim pushimi te vizitoreve *(200x500=100,000 leke*), sipas projektit subjektit për përdorimin e sipërfaqes pyjore për eko-turizëm,
* *270,000 leke, për sipërfaqen 540 m2 te 6 bujtina* druri secila 90 m2, për akomodim me sipërfaqe 90 m2, sipas projektit subjektit për përdorimin e sipërfaqes pyjore për eko-turizem.

Theksojmë se:
Për vërtetimin e sipërfaqeve te këtyre objekteve nuk disponohet asnjë dokument përfundimtar nga subjekti, i cili detyrohet ti paraqesë këtë dokument me nënshkrimin e specialistit licencuar ashtu siç ka paraqitur dokumentet fillestare, por edhe nga ADZM nuk disponohen dokumente për te dhënat e sipërfaqeve ndërtimore te objekteve.

19. ADZM Tirane ka lidhur kontratën e qirasë nr. 114/4 date 26.11.**2021** me subjektin "**S.S" shpk** A. M**,** për dhënien ne përdorim te sipërfaqes zonës mbrojtur Mali Dajtit, parcela 61b, për **227,4 m2** për aktivitet *"**Vendosje Antene**",* me afat 5 vjeçar *(2021-2026*), nënshkruar nga drejtori i ADZM z. I. V. dhe subjekti qiramarrës A. M. me vlerën e qirasë vjetore 227,400 leke (*227,4 m2 x 1000 leke/m2*), bazuar ne VKM nr. 1156 date 24.12.2020 *"Për përcaktimin e ardhurave gjeneruara nga tarifat qe paguhen ne zonat mbrojtura te masës dhe kritereve përdorimit tyre".*
Nga auditimi rezulton se subjekti ka arkëtuar 227,400 leke tarifë qirasë Antenës për vitin 2021 (*26.11.2021 deri 26.11.2022*), sipas mandat arkëtimit date 26.11.2021 te R. BANK.
Dosja përmban dokumentacionin e duhur**,** por **nuk ka inventarë,** pa inventarizim te dokumenteve, në kundërshtim me kërkesat nenit 3 dhe 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

20. ADZM Tirane ka lidhur kontratën e qirasë nr. 85/1 date 24.09.**2021** me subjektin "**A- t" SHA,** B. A., për dhënien ne përdorim te sipërfaqes se zonës mbrojtur Mali Dajtit, parcela 17/d, për **43,8 m2** për aktivitet*"**Vendosje Aparati Marrëse-Dhënëse** GSM/UMTS",* me afat 5 vjeçar (2021-2026), nënshkruar nga drejtori i ADZM z. I.V dhe subjekti qiramarrës B. A.
ADZM ka përllogaritur sakte vlerën e qirasë vjetore 43,800 leke *(43,8 m2 x 1000 leke/m2),* bazuar ne VKM nr. 1156 date 24.12.2020 *"Për përcaktimin e ardhurave gjeneruara nga tarifat qe paguhen ne zonat mbrojtura te masës dhe kritereve përdorimit tyre".*
Nga auditimi rezulton se: subjekti ka arkëtuar 43,800 leke tarifë e qirasë Aparatit marres-dhënës për vitin 2021 (*24.09.2021 deri 24.09.2022*), sipas mandat arkëtimit date 15.10.2021 te BKT.

Dosja përmban te gjithë dokumentacionin e duhur**,** por **rezulton pa inventarë,** në kundërshtim me kërkesat nenit 3 dhe 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

Pretendimi i subjektit:
Observacion i ADZM Tirane nr. 137/5, date 6.01.2023, për projekt raportin e auditimit te KLSH, është përsëritje e observimeve te akt konstatimit nr. 1, për disa kundërshtime lidhur me mangësitë ne dokumentacion, shtyrjen e afateve kontratave, diferenca tarifash, me kohen e hyrjes ne fuqi te VKM 1156 date 24.12.2020 etj, ku një pjese e tyre janë marre parasysh ne projekt raport, ndërsa përsëri janë observuar.

Qëndrimi i grupit auditimit:
Observacioni i ADZM ***qëndron pjesërisht*** *dhe është marre parasysh pjesërisht, duke u reflektuar ne projekt raport auditimit, ndërsa për rastet tjera te observuar, por te pa justifikuara me dokumente i qëndrojmë trajtimeve tona ne, konkretisht:*
- ndërtimet pa leje nuk ka pas vitit 2015, por pavarësisht kësaj ka pasur 3 legalizime ne vitin 2019-2021, dhe qëndron se përgjegjësia i takon ASHK Tirana 1.
- dosjet ne ADZM duhet te inventarizohen, pasi është kërkese ligjore.
- nuk qëndron observimi lidhur me mangësitë ne dokumentacion, pasi dokumentacioni duhet i plote sipas kërkesave ligjore.
-Lidhur me dokumentin e pëlqimit pushtetit vendor ka 2 standarde, pasi për disa disponohen, ndërsa për disa subjekte tjera nuk disponohen.
- lidhur me shtyrjen e afateve te kontratave i lihet përgjegjësia AKZM, por ne fakt kemi shkelje te kushteve kontraktore te vendosura nga 2 palët Qiramarrës dhe Qiradhënës ose ADZM dhe s,ka lidhje qendra nëse jep urdhër apo nuk jep urdhër.
- nuk qëndron observimi, lidhur me diferencat e tarifave qirasë për subjektet, nen pretekstin se VKM nr. 1156 date 24.12.2020 ka hyre ne fuqi pas 1 viti ne shtator 2021, pasi vendimi ka hyre ne fuqi 15 dite pas botimit ne gazetën zyrtare.
Gjithashtu jeni kontradiktor, pasi thoni VKM 1156 ka hyre ne fuqi ne shtator 2021, ndërsa ndryshimet e tarifave për disa raste i keni pasqyruar para shtatorit 2021, sipas amendamenteve trajtuara tek pika 13 dhe 15 e akt konstatimit nr. 1, konkretisht:
** kontrata e qirasë nr. 43/4 date 31.05.2021 me subjektin E.B. me vlerën e qirasë vjetore 9,000 leke ka ndryshuar sipas Amendamentit 1 date 22.08.2021 nga 9,000 ne 19,500 leke.*
** kontrata e qirasë nr. 13/4 date 03.08.2021 me subjektin E.K**,** me vlerën e qirasë vjetore 49,000 leke ka ndryshuar nga 49,000 leke ne 54,000 leke, sipas Amendamentit nr. 1 date 03.08.2021.*
- qëndron observacioni, lidhur me sipërfaqen 500 m2 dhëne për Hec subjektit "T" shpk, pasi disponohet leje e KRRT dhe VNM pa ndikim ne mjedis, madje shfrytëzimi i ujit behet me tubacion, pa dëmtuar sipërfaqen ZM. Gjithashtu për ketë problem është konstatuar me pare paqartësi ligjore, sipas raportit KLSH tek rekomandimi nr. 3 i lëne me pare. Observacioni nuk qëndron lidhur me diferencën e tarifës vitit 2021.
- lidhur me sipërfaqen 1200 m^2 te kaluar ne pronësi private qëndron observimi , lidhur me periudhën, pasi i përket para periudhës se auditimit, çka nuk ju ngarkon me përgjegjësi.
- lidhur me detyrimet për penalitetet e 2 subjekteve merret parasysh dhe nuk rekomandohen detyrime, pasi edhe vlerat janë minimale, por ti shërbej zbatimit kamatëvonesave ne ardhmen, ne zbatim te kushteve te kontratave.
- nuk qëndron observimi për sipërfaqet ndërtimore, pasi aplikimi i tarifave tyre behet bazuar ne dokumente, te cilat mungojnë dhe jo ne komente.

- qëndron observacioni tek D- P, pasi drejtori ka qene me leje dhe ka autorizuar person tjetër për firmosje kontratave, sipas vërtetimit bashkëngjitur.

Situata: Në AdZM Tiranë, nuk janë hartuar plane Menaxhimi nga Ministriae Mjedisit dhe Turizmit.

Kriteri: Ligjin nr. 81/2017 datë 04.05.2017, "Për zonat e Mbrojtura".

Ndikimi/Efekti: Menaxhimi i zonave të mbrojtura.

Shkaku: Mos hartim i planit të menaxhimit nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit.

Rekomandimi: AdZM Tiranë në bashkëpunim me AKZM Tiranë të kërkojë pranë Ministrisë së Linjës për përcaktimin e vendosjen e pikave të kalimit në pjesët turistike të Zonave të mbrojtura, si dhe të japë kontributin e saj në hartimin e projekt-drafteve për miratimin pikave te rreja te kalimit dhe të subjekteve qe kryejnë aktivitet ne këto zona, për vjeljen e të ardhura nga AdZM.

Afati: Në vazhdimësi

2.Titulli gjetjes: Në zonat e mbrojtura ushtrojnë aktivitet individ privat banorë të zonës si dhe një numër i konsiderueshëm biznesesh, që shfrytëzojnë këto burime natyrore fitimprurëse.

Situata: Nga AdZM ka një evidentim dhe regjistrim të subjekteve të biznesit të cilat kryejnë veprimtari të ndryshme me karakter ekonomik dhe social si bujqësia tradicionale, agro-pylltaria dhe të gjitha aktivitetet artizanale, kulturore, sportive dhe shërbimet turistike. Nuk ka të dhëna për to në lidhje me aktivitetet e tyre (licencimi, koha e ushtrimit të aktivitetin, lejet mjedisore, territoret apo dhe veprimtaritë e të cilëve përfshihen në zonën e mbrojtur ose në atë buferike. Nga Qeveria Qendrore dhe Pushteti Vendor nuk është zgjidhur problem i taksimit specifik të personave fizik dhe juridik që shfrytëzojnë vlerat natyrore, historike dhe kulturore të zonave të mbrojtura, nëpërmjet përfshirjes së tyre në paketat fiskale.

Kriteri: Në kundërshtim me nenin 56të ligjit nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura".

Ndikimi/Efekti: Mos arkëtim i të ardhurave.

Shkaku: Mos hartim i planit të menaxhimit nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit.

Rëndësia: E Ulët

Rekomandimi: AdZM Tiranë të marrë masa që në çdo raste të ketë informacionin e duhur nëpërmes monitorimeve për aktivitete që kryhen brenda zonës së mbrojtur.

Afati: Në vazhdimësi

Pika 5 . Hartimi dhe zbatimi i planeve të menaxhimit për Zonat e Mbrojtura

Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë, është institucion vartës i Agjencisë Kombëtare të Zonave te Mbrojtura dhe ana dokumentare dhe buxhetore mbahet nga AKZM dhe zbaton urdhrat e dhëna prej saj.

Sipas funksionimit të saj, rezulton se për secilin punonjës të Administratës të Zonave të Mbrojtura Tiranë (AdZM) rezulton se janë **24 punonjës që punojnë në Qarkun e Tiranës** dhe dosjet e secilit punonjës dhe detyrat dhe funksionin e secilit punonjësi janë pranë "Burimeve Njerëzore në Asgjësinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura Tiranë si institucioni qëndror i saj.

AdZM- Tirana ka funksionuar në dy sektorë: "Sektori i Monitorimit" dhe "Sektori i Menaxhimit" si dhe pikat e hyrjes së vizitorëve në Parkun Kombëtar "Mali i Dajtit " sipas shkresës Nr. prot. 173 dt.15.01.2019 lëshuar nga Prefektura e Qarkut Tiranë.

Funksionimi dhe veprimtaria e saj rezulton:

Nga viti 2019-2021 AdZM ka planifikuar një Plan Pune dhe Plan Masash për çdo muaj mbi masat për menaxhimin e zonave të mbrojtura. Planet e punës të muajve janë të të njëjtit format dhe pa vënë afate kohore për zbatimin dhe realizimin e tyre. Në vitin 2020 si rezultat i pandemisë "Covid 19" funksionimi i AdZM-Tiranë nuk ka funksionuar rregullisht.

"Planet e sektorëve të Monitorimit dhe Menaxhimit janë detyra të cilat duhet të realizohen si një dokument bazë që realizohen gjatë muajit dhe në të ardhmen në zonat e mbrojtura me synimet sa më realiste dhe të realizueshme me afatet kohore të një periudhe të caktuar, si dokument strategjik afatshkurtër dhe afatgjatë të tyre" gjithashtu duhet të planifikohen dhe plane strategjike afatgjatë për këto zona .

Sipas programeve mujore të paraqitura nga sektori i monitorimit rezulton se **nuk** ka të justifikuar realizimin e pikave të programit dhe nuk ka informacion shpjegues mbi realizimin e tyre dhe konkretisht Në Pikat e Programit të rishkruar në çdo muaj dhe dokumentimi përkatës i tyre :

Takime me, shkollat që përfshihen brenda zonës së mbrojtur si dhe jashtë saj për ndërgjegjësim në kuadër të ditëve të ndryshme të kalendarit mjedisor, "Nuk ka as një dokumentacion të bashkangjitur programit " nuk ka personat përgjegjës për kryerjen e kësaj veprimtarie.

Në pikën e programit "Takim me kryetarët e fshatrave dhe sensibilizimi i komunitetit për parandalimin e paligjshmërisë në ZM", rezulton si pikë e programit vetëm e shkruar në letër dhe në asnjë rast nuk ka asnjë dokument kur janë takuar, datën, konkluzionet, grupet e ngritura, etj.

Në pikën e programit "Mbrojtja e monumenteve të natyrës" megjithëse figuron një listë me monumentet e natyrës (23 Monumente), nuk ka asnjë të dhënë në informacionet mbi gjendjen e këtyre monumenteve, si janë ruajtur, gjendja e tyre fizike, etj. pra rezulton si pikë e programit vetëm e shkruar në letër dhe në asnjë rast nuk ka asnjë dokument mbi gjendjen, si dhe kontrollin e tyre.

Ne pikat e programeve te çdo muaji: Bashkëpunim me mediat, impenjim i stafit në realizim të fotove në funksion të promovimit të burimeve natyrore.

Promovim i resurse natyrore

Promovimi në media vizive e të shkruar.

Shpërndarje e broshurave dhe fletëpalosje

Shpërndarja e fletëpalosjeve, broshurave si dhe ne Facebook "Stafi i Sektorit të Menaxhimit dhe Monitorimit"

Pra konstatojmë se planet janë formale pa nxjerrë as një përgjegjësi dhe nuk justifikon punën dhe veprimtarinë e sektorëve përkatës të AdZM-Tirane.

Gjatë vitit 2019-2021 rezulton se: AdZM Tiranë ka nën juridiksionin e saj këto zona të mbrojtura: Parkun Kombëtar "Mali i Dajtit" 28.000 ha, Parku Natyror "Mali me Gropa-Bizë-Martanesh" 26.000 ha, një pjesë të parkut kombëtar "Divjakë-Karavasta" rreth 600 ha.

Administrata e Zonave të Mbrojtura është në varësi të Agjencisë së Zonave të Mbrojtura dhe **nuk** ka sektor finance si AdZM Tiranë por është në vartësi të AZM si istucion kryesor në menaxhim sa më cilësor të parqeve natyrore kombëtare, si dhe të politikave në fushën e ruajtjes së biodiversitetit në to, ku mendimet e dhëna të respektojnë interesin kombëtar e rajonal si dhe trendin e integrimit, nga istucionet e vartësisë.

Ky auditim përputhshmërie ka në qendër të vëmendjes ndihmesën për të përmirësuar situatën në sistemin e menaxhimit të zonave të mbrojtura e veçanërisht atë të parqeve kombëtare, duke analizuar problematikën aktuale dhe instrumentet që strukturat shtetërore kanë në dispozicion, që të ndihmojë të qytetarët në mbrojtje të natyrës, në kthimin e saj në shërbim të njeriut, krijimit të kushteve për të bërë biznes dhe për të ardhmen. Të kontribuojmë në mbrojtjen e të drejtës së secilit që i takon gjeneratës së tashme, por edhe të ardhme, për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe për mirëqenien e saj.

Auditimi kërkon të nxisë përsosjen dhe zhvillimin e menaxhimit të parqeve kombëtare në mënyrë që ato të jenë sipas standardeve bashkëkohore, duke bërë të mundur përmirësimin e performancës. Ndërmjet tij synohet të përftohet një qasje e re në vlerësimin e punës me rritjen e besimit të opinionit publik, sipërmarrjes dhe aktorëve të ndryshëm për t'i besuar institucioneve publike të menaxhimit të parqeve kombëtare për të ardhmen e tyre profesionale në lidhje direkt me kërkesat e qytetarit dhe të brezave që po vijnë për ruajtjen dhe zhvillimin e natyrës në shërbim të njeriut. Gjithashtu auditimi synon të garantojë të drejtën e publikut, për të pasur informacion për mjedisin, për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve mjedisore dhe për t'ju drejtuar institucioneve përkatëse e gjykatave, në lidhje me çështjet mjedisore.

Veprimtaria e AdZM-Tiranë:

Me anë të shkresës Nr. Prot. 173 Dt.15.01.2019 lëshuar nga Prefekti i Qarkut Tiranë, AdZM Tiranë është e ndarë në dy sektorë që janë: Sektori i Monitorimit dhe Sektori i Menaxhimit.

Sipas urdhrit të ish/drejtorit I. V. përgjegjës sektori i monitorimit është caktuar K. S. dhe në sektorin e menaxhimit është vendosur H. D. me urdhër të brendshëm me Nr. Prot. 95,96 Dt.04.11.2019.

Në funksionimin dhe veprimtarinë e AdZM- Tiranë, për monitorimin e zonës dhe menaxhimin e saj urdhëresat si dhe ndarjen e detyrave të inspektorëve dhe rojeve të mjedisit është kryer nga ish /Drejtori I.V, në të cilën autorizon përgjegjësit e sektorëve për zbatimin e tyre ,por theksojmë se nuk sanksionon saktë zonën, kufijtë përkatës dhe subjektet të cilët kanë lidhur kontrata si definitive dhe provizore , për të menaxhuar sa më saktë dhe ruajtur zonën nga dëmtimet, nga zjarret etj, po mjafton me shënimet si "Zona e Mbrojtur Parku Kombëtar Mali Dajtit, pjesa mbrapa".

Pra nuk ka funksionuar si duhet dhe dorëzimet, dalja në pension e inspektorëve ,ose dorëheqjeve nga puna dhe janë mjaftuar vetëm me urdhra pa sanksionuar gjendjen e zonave të marra në dorëzim nga inspektori përkatës.

Në detyrat funksionale të secilit sektor rezulton: Sipas ligjit Nr.81/2017 (Për zonat e mbrojtura) shkresës me Nr.Prot.1485 Dt.09.01.2019 të lëshuar nga ish drejtori i përgjithshëm i AKZM Z.D me VKM Nr.402 Dt.21.06.2006 si dhe VKM Nr.49 Dt.31.01.2007 për marrje informacioni të 12 fshatrave të Pk "Mali i Dajtit" dhe Pk "Mali me Gropa-Bizë-Martanesh", më konkretisht: Derje, Domje, Façesh, Shënmëri, Shëngjin, Vërri, Skrep, Urë dhe Bizë.

Për sa më sipër rezulton: Zonat e Mbrojtura Mali Dajtit dhe një pjese e zonës së Karavastasë nuk na u paraqitën dokumente ligjore të regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës kryesisht Drejtorinë Vendore të Kadastrës Tiranë dhe Drejtorinë Vendore të Kadastrës Lushnjë, po këto zona funksionojnë me numra parcelash të cilësuar nga vetë AdZM dhe kufij sipas fshatrave të **pa pajisur me certifikatë pronësie që ti administrojë AdZM-Tiranë , pa zona kadastrale si dhe nr. pasurie në kundërshtim me, neni 52 Pronësia mbi zonat e mbrojtura, pika 1. Ku shprehimisht thuhet "Zonat e mbrojtura mjedisore në territorin e Republikës së Shqipërisë janë pasuri kombëtare. 2. Zonat e mbrojtura në Republikën e Shqipërisë janë pasuri e paluajtshme, pronë publike ose private" sipas ligjit 81/2017.**

Pavarësisht nga mos pasja e dokumentit të pronësisë, në këto zona janë lidhur kontrata provizore me afate 3 deri 4 muaj për kullota dhe kontrata vjetore nga Administrata e Zonave të Mbrojtura Tirane , megjithëse këto pasuri nuk janë të regjistruara pranë ASHK.

Funksionimi ndërinstitucional ka ngelur vetëm në letër pa marrë përgjigje dhe pa ndjekur procedurat ligjore të regjistrimit të këtyre pronave pranë **ASHK Tiranë** dhe pa bashkëpunuar për të nxjerrë problematikat e lindura në zonat e mbrojtura kryesisht në zënien e territoreve të zonave të mbrojtura dhe ndërtimeve pa leje në këto zona.

Pika 5/1 e programit:
Hartimi dhe zbatimi i planeve te menaxhimit për zonat e mbrojtura.

Auditimi u ushtrur në Administratën e Zonave të Mbrojtura Tiranë (ADZM), sipas Programit të auditimit nr. 892/1, datë 13/10/2022 e protokolluar ne subjekt me nr. 145, datë 17.10.2022 është kryer për periudhën 2019, 2020 dhe 2021.

ADZM Tiranë ka nën juridiksionin e saj këto zona të mbrojtura:
- **Parku kombëtar** "***Mali i Dajtit***" 28,000 ha,
- **Parku natyror** "***Mali me Gropa-Bizë-Marta*nesh**" 26,000 ha,
- **Parku kombëtar "*Divjake-Karavasta*"** rreth 600 ha (një pjese).

Zona e mbrojtur Dajt dhe Bize kane 12 fshatra (*Pk "Mali i Dajtit" dhe Pk "Mali me Gropa-Bizë-Martanesh"),* konkretisht: Derje, Domje, Façesh, Shënmëri, Shëngjin, Vërri, Skrep, Urë dhe Bizë.

ADZM Tiranë është e ndarë në dy sektorë, sipas shkresës nr. 173, date 15.01.2019 të Prefektit Qarkut, përkatësisht:
- ***Sektori i Monitorimit,***
- ***Sektori i Menaxhimit***.

Në sektorin e monitorimit përgjegjës sektori është caktuar K. S.,
Në sektorin e menaxhimit është vendosur H. D.,
Sa sipër, sipas urdhrit të brendshëm nr. 95 e 96 date 04.11.2019 të ish drejtorit I. V.

Punonjësit e ADZM Tirane sipas detyrave funksionale të tyre, për punën e kryer kane mbajtur dokumentacionin tekniko-ligjor përkatës, te cilin e kane administruar.

Gjithashtu është vlerësuar mbrojtja dhe ruajtja e këtyre zonave mbrojtura.

Është mbajtur edhe dokumentacioni i te ardhurave, i cili është administruar ne dosjet përkatëse, lidhur me kontratat për sipërfaqet e marra me qira në zonën e mbrojtur nga subjektet.

Dokumentacioni tekniko-ligjor për sipërfaqet e marra me qira në ZM nga subjektet**,** përbehet:
* kërkesat e subjekteve për marrjen e sipërfaqes me qira për turizëm malor.
* urdhrat e drejtorit për krijimin e grupit punës, për studimin e kërkesës dhe vlerësimin teknik-ekonomik te sipërfaqes ne ZM për përdorim,
* raport–vlerësimi i grupit punës,
* memot dhe opinionet e drejtorit ADZM, për drejtorin e përgjithshëm AKZM,
* shkresat te AKZM për miratimin e kontratave te qirasë për sipërfaqet e marra ne ZM,
* miratimi i kontratave nga drejtori përgjithshëm AKZM,
* kontratat e lidhura me subjektet me afate kohore dhe tarifa qiraje te përcaktuara,
* amendamentet për ndryshimet ligjore te vlerës qirasë vjetore, sipas VKM nr. 1064 date 22.12.2010 "*Për përcaktimin e tarifa vene sektorin pyjor dhe kullotave*", ndryshuar me VKM nr. 1156 date 24.12.2020 *"Për përcaktimin e ardhurave gjeneruara nga tarifat qe paguhen ne zonat mbrojtura te masës dhe kritereve përdorimit tyre",*

* pëlqimi dhe mendimi i pushtetit vendor për ngritjen e objekteve prej druri ne ZM,
* procesverbali i dorëzimit nga ADZM për sipërfaqet e marra ne përdorim me qira për subjektin,
* plan-rivelimi, plan biznesi, hartat, projekti, plan vendosja, planimetria etj, nënshkruar nga specialistet e fushës dhe subjekti, për parcelën ne përdorim brenda ZM,
* faturat dhe mandat arkëtimet për pagesën e tarifave ligjore nga subjektet, sipas kushteve kontraktore përkatëse, bazuar ne ligjin nr. 81/2017 "*Për zonat e mbrojtura*", ne VKM nr. 1064 date 22.12.2010. "*Për përcaktimin e tarifave ne sektorin pyjor dhe kullotave*", ndryshuar me VKM nr. 1156 date 24.12.2020 *"Për përcaktimin e ardhurave gjeneruara nga tarifat qe paguhen ne zonat mbrojtura te masës dhe kritereve përdorimit tyre" etj*.

ADZM ka mbajtur evidenca vjetore për realizimin e te ardhurave, përkatësisht:
Për vitin 2019.
Te ardhurat janë realizuar ne total për vlerën 4,146,108 leke, përkatësisht:
* te ardhura nga dhënia ne përdorim e fondit pyjor për vlerën 2,797,808 leke,
* te ardhura nga kullotat = 195,900 leke, te ardhura nga vizitoret për vlerën 1,152,400 leke,
* subjekte debitorë për sipërfaqet me qira ne ZM, paraqiten për 631,533 leke.

Për vitin 2020.
Te ardhurat janë realizuar total për vlerën 4,769,376 leke te ardhura, përkatësisht:
* te ardhura nga vizitor te huaj dhe vendas për vlerën 1,405,500 leke,
* te ardhura nga 35 kontratat (progresive) lidhur me sipërfaqet me qira paraqiten 3,215,036 leke.

Për vitin 2021.
Te ardhurat janë realizuar ne total për vlerën 7,678,570 leke, përkatësisht:
* te ardhura nga vizitor te huaj dhe vendas për vlerën 1,405,500 leke,
* te ardhura nga 42 kontratat (progresive) lidhur me sipërfaqet me qira paraqiten 6,146,970 leke.

Konkluzion: Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë nuk ka bashkëpunuar me institucionet e kërkuara në rregulloren e brendshme të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura. Veprimete mësipërme bien në kundërshtim me Nenin 30 të rregullores së brendshme të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

14.Titulli i gjetjes: Bashkëpunimi mes AdZM Tiranë dhe institucioneve të tjera ligj zbatuese .
Situata: Nuk ka gjurmë të bashkëpunimit me institucionet si: inspektoratin e peshkimit , inspektoratin e ndërtimit, tatimet,institucionet kërkimore shkencore , institute dhe katedra të specializuara etj.
Kriteri:Në kundërshtim merregulloren e brendshme të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.
Ndikimi/Efekti: Mungesa e bashkëpunimit me institucionet ligj zbatuese ka sjellë monitorim jo efecientë në zonat e mbrojtura Tiranë.
Shkaku: Mungesa e programeve të bashkëpunim me institucionet ligj zbatuese.
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi: AdZM Tiranë të marrë masa dhe të bashkëpunojë sipas legjislacionit në fuqi, me të gjitha institucionet ligjzbatuse për parandalimin e aktiviteteve të paligjshme në zonat e mbrojtura .
Afati: Në vazhdimësi.
Konkluzion: Për këto problematika AdZM i ka bërë evidente në AKZM,por nuk është bërë analizë fakto rialë në mënyrë të detajuar si dhe nuk janë përcaktuar rrugët për zgjidhjen e tyre, nëpërmjet masave konkrete dhe vendosjen e urave të bashkëpunimit konkret me institucionet përgjegjëse si dhe mungon mbështetja institucionale në nivel ministror për përgatitjen e projekt-drafteve të udhëzimeve dhe marrëveshjeve të përbashkëta me institucionet e licencimit dhe që kanë tagrin e dhënieve të lejeve për

zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme si dhe taksimin e tyre në mënyrë që të bashkërendohet puna për zvogëlimin e veprimtarive të paligjshme dhe përfitimit nga të ardhurat e krijuara nga institucionet që menaxhojnë ZM.

Pika 6.Auditime mbi bashkëpunimin me organet e tjera të kontrollit si ARM.,etj ,për kryerjen e kontrolleve dhe inspektimeve të përbashkëta në zonat e mbrojtura.

Në AdZM – Tiranë megjithëse është istucion në vartësi të AKZM ne planet e detajuara si mujore dhe vjetore nuk kane planifikuar në planet e tyre kontrolle te përbashkëta, si nga sektori i monitorimit dhe sektori i menaxhimit, në as një rast nuk kanë planifikuar kontrolle të përbashkëta dhe të vazhdueshme, në zbatim të Ligjit Nr.81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura " dhe Rregullores e brendshme "Për organizimin dhe funksionimin të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratës rajonale të zonave të mbrojtura". Referuar Nenit 30 të rregullores së brendshme të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, në zonat problematike dhe të dëmtuara ose në zonat e djegura si dhe problematika të tjera të konstatuar se në pikat e mbetjeve urbane, ndotja e sipërfaqeve nga mbetjet e ngurta etj.

Megjithëse problematikat kane qenë nga me të ndryshmet, kemi konstatime te gërmimeve të sipërfaqeve, të prerjes se drurëve ahore dhe shkurreve, djegie të sipërfaqeve të mbrojtura, hedhje mbeturinash etj, dhe nuk ka as një dokument bashkëpunimi dhe ndjekje te problematikave te ndodhura ne zonat e mbrojtura që mbulon AdZM-Tirane me istucionet përkatës, policinë, bashkitë , me AZM etj dhe të ketë nxjerrë përgjegjësitë nga se kane ndodhur këto dëmtime.

Megjithatë konstatojmë se ne baze te dokumentacionit rezulton se;

Nuk janë saktësuar kufijtë natyrorë të habitateve për shpërndarjen e faunës me AdZM kufitare ;

- Nuk ka përfunduar inventarizimi dhe vlerësimi i gjendjes së treguesve të habitateve, florës dhe faunës, brenda parqeve dhe në të gjithë sistemin e zonave të mbrojtura;
- Nuk është punuar mirë këto vitet e fundit për të parandaluar ndërhyrjen e njeriut e cila ka qenë sa abuzive flagrante aq edhe e pastudiuar, çka ka sjellë rritjen e numrit të habitateve të rralla e të kërcënuara është shtuar;
-Janë marrë vetëm disa masa sporadike për eliminimin dhe rigjenerimin e pasojave nga dëmtimet natyrore në parqet natyrore kombëtar;
- Nuk ka ndjekje të mëtejshme ligjore mbi proces-verbaleve të konstatimit të dëmeve në ZM të mbajtura nga ana e AdZM-ve në qarqe nga ana e ISHMP;

Unifikimin e harmonizim në mbledhjen e të dhënave, reduktimin e raportimit dhe mbingarkesave nga institucionet përgjegjëse, parandalimi i dëmtimeve nga faktorët natyrore ku parësore është rritja e bashkëpunimit me pushtetin vendor dhe me institucionet e tjera, marrja e masave mbrojtëse për parandalimin e zjarreve nga AdZM-Tirane të cilat me ardhjen e stinës së verës, bëhen më evidente, ndihmon në ruajtjen e florë dhe të faunës, të cilat kryesisht duhet të përqendrohen në, ngritjen e sistemit të vrojtim sinjalizimit për parandalimin e rënies së zjarreve në zonat e mbrojtura dhe bashkëpunim me personat qe kane lidhur kontrata qiraje ne këto zona si dhe me komunitetin dhe hartimin e skemave dhe grafikëve të skuadrave zjarrfikëse të AdZM-ve në qarqe në bashkëpunim me pushtetin vendor;

Pra bashkëpunimi me strukturat lokale e të specializuara para fillimit të zjarreve dhe parandalimi i dëmtimeve nga ndërhyrjet e paligjshme është faktor tjetër i domosdoshëm që ndihmon në zhvillimin dhe ruajtjen e ZM nëpërmjet, zhvillimit të inspektimit me grup pune mbi problematikat dhe parandalimin e prerjeve të paligjshme, gjuetisë, dëmtim të biodiversitetit dhe ushtrim aktivitetesh të

paligjshme nga subjekte private brenda zonave të mbrojtura të qarqeve, përgjegjësia dhe e qytetareve qe kane marre me kontrate këto zona etj.
Gjithashtu konstatojmë se nuk ka kritere, si dhe plane ose shkresa te nisura AKZM, për përcaktimin e numrit të rojtarëve, përzgjedhjes së tyre dhe vendndodhjes së administratës të zonave të mbrojtura si dhe ndarjes territoriale dhe numrit te tyre sipas zonave kadastrale .Në ditët e sotme burimet njerëzore janë një nga asetet më të rëndësishme të një organizate e aq më të tepër të institucioneve shtetërore sepse ato ndikojnë direkt në performancën e veprimtarisë të tyre, në zonat AdZM. Në institucionet shtetërore burimet njerëzore kanë rolin kryesor, ato duhet të gjejnë, strategji për identifikimin, inkurajimin, matjen, vlerësimin, provimin dhe shpërblimin e performancës së punonjësit.
-**Nga AdZM- Tiranë** nuk na u paraqiten dokumente mbi trajnime dhe kualifikimi të punonjësve është burim i pashtershëm që ndikon në rritjen e performancës së institucionit dhe në menaxhimin e tij, ai është nga problemet më të neglizhuar të menaxhimit, sepse është e vështirë të ngarkosh dikë me përgjegjësi për një funksion nëse nuk është i trajnuar. Shoqëria dhe tregu i punës, janë të interesuar të investojnë për pajisjen e anëtarëve të tyre me nivelin e domosdoshëm të dijeve dhe aftësive, përgatitjen e specialistëve përherë e më të kualifikuar, e kryesisht të "rojeve mjedisore", "specialistëve të monitorimit dhe menaxhimit" etj. Gjithashtu duke qenë se administrata e zonave të mbrojtura ka specifika në realizimin e detyrave të saj duhet që gjatë trajnimeve mund të merren në konsideratë disa metodat që devijojnë disi nga ato tradicionale të tij si;
- Kryerja e inspektimeve dhe udhëtimeve;
- Vajtja në terren;
- Demonstrimet;
- Simulimi i situatave;
- Luajtja e roleve;
- Diskutime;
- Ushtrime dhe demonstrime me pjesëmarrje;
- Rotacion i detyrave;
- Ushtrime me prodhues dhe produkt përfundimtar.

Konkluzion: Për këto nuk ka dokumentacion shkresor evidentues për lënien e gjurmës së konstatimit te auditimit, që vërteton kryerjen e këtyre veprimtarive, te cilat janë në kundërshtim me *"Rregulloren e brendshme për organizmin dhe funksionimin' e AdZM", neni 30 pika 1,ku përcaktohet se: Administrata kryen këto detyra dhe shërbimet kryesore.* ***Dokumenton veprimtari,*** *kërkime shkencore të kryera në territorin e zonës së mbrojtur* ''. Ndërsa ekzistojnë imai-le për ftesat për takime, trajnime si dhe për programet dhe axhendat e tyre të zhvillimit.
10.Titulli i gjetjes: Mungesa e dokumentacionit vërtetues për kryerjen e veprimtarisë së AdZM Tiranë.
Situata: Nga stafi i AdZM që ka marrë pjesë në to janë evidentuar vetëm si veprimtari, por nuk ka relacione se si janë reflektuar dhe si kanë ndikuar njohuritë dhe përvojat e marra në këto trajnime në punën menaxhuese të mjedisit të ZM.Gjthashtu nga AdZM për vitet 2019, 2020 dhe 2021 janë zhvilluar një numër i madh veprimtarish për edukimin mjedisor dhe aktivitetesh në dite te shënuara mjedisore e turistike me nxënësit e shkollave apo komunitetin vendas të ZM, të cilat janë evidentuar si veprimtari dhe aktivitete,por nuk janë shoqëruar me materiale mbështetëse dhe dokumente vërtetues të aktivitetit(fotografi apo video). Edhe për veprimtaritë këshillimore të kryera sipas relatimit në raportin vjetor të

punës së AdZM nuk ka një dokumentim më të specifikuar që të përshkruajë veprimin e kryer dhe të lërë gjurmën e realizimit të tij.
Kriteri:Në kundërshtim kjo, me *"Rregulloren e brendshme për organizmin dhe funksionimin' e AdZM", neni 30 pika 1,ku përcaktohet se: Administra kryen këto detyra dhe shërbime kryesore.....**dokumenton veprimtari,** kërkime shkencore të kryera në territorin e zonës së mbrojtur*".
Ndikimi: Kjo mënyrë e mos evidentimit të dokumentacioneve vërtetuese dhe shoqëruese, nuk jep informacionin e saktë rreth kryerjes së detyrave që i përkasin AdZM Tiranë.
Shkaku: Gjatë mbledhjeve, trajnimeve dhe detyrave të AdZM Tiranë, nuk janë evidentuar nga ata, procesverbale, foto, video duke mos i dhënë rëndësinë e duhur mbajtjes së tyre gjatë veprimtarive.
Rëndësia: E ulët.
Rekomandimi: AdZM Tiranë gjatë veprimtarive që ajo kryen, të bëjë të mundur mbajtjen e dokumentacioneve vërtetuese dhe shoqëruese.

Pika 6/1 e programit:
Auditim mbi probleme te ndryshme qe mund te dalin gjate auditimit.
"Mbi zbatimin rekomandimeve mëparshme lenë AKZM nga KLSH, qe i përkasin ADZM Tirane".

1. Rekomandimi:
Objekti "*Qendrës Vizitorëve Dajt*" *të rehabilitohet* dhe vizitohet nga turistet.
1.1.Zbatimi: *Ky rekomandim është zbatuar, lenë me pare nga KLSH ne adrese AKZM dhe ADZM.*

2. Rekomandimi**:**
Nga AdZM Tiranë të vihet në funksion sistemi i kamerave në postbllok si dhe instalimi i sistemit të ndriçimit në ambientin e jashtëm. Në postbllok te bëhet monitorimi dhe regjistrimi i të gjitha mjeteve që transportojnë lëndë drusore, nga pyjet e Tiranës, apo dhe jashtë tyre. Ky postbllok, ka një efektivitet në parandalimin e kontrabandës së lëndës drusore, jo vetëm të peizazhit të mbrojtur, por dhe zonave te tjera të Bulqizës, Matit apo Librazhdit.
2.1. Zbatimi: Ky rekomandim është zbatuar, lenë me pare nga KLSH per AKZM dhe ADZM.

3. Rekomandimi:
Ndërtimi i veprave të reja pavarësisht projekteve në miratim në zonat e kategorisë II-të-(Parku Kombëtar Dajt), të jepen me VNM sipas përcaktimit të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
Nga AKZM dhe ADZM në kuadrin e përmirësimeve ligjore, të shprehet specifikisht në ligjin për zonat e mbrojtura, që në kategoritë II dhe tjerat për të gjitha shkallët e mbrojtura: të jetë e ndaluar ndërtimi i veprave si: HEC, gurore, tjera, pasi referuar veprimtarive të tyre të vërtetuara nga praktikat e deritanishme, sjellin dëme te natyrës dhe vlerave të zonës mbrojtur.
3.1. Zbatimi: Ky rekomandim ka zbatim te pjesshëm, pasi në kuadrin e përmirësimeve ligjore nuk ka ndryshime në ligjin për zonat e mbrojtura, çka nuk është ne kompetencën e ADZM , por te legjislacionit.

Për problemet e trajtuara ne projekt-raportin e auditimit ne ADZM Tirana mbajnë përgjegjësi:
z. I. V., me detyre drejtor i ADZM Tirane nga viti 2019-2020-2021, z. Z.D., me detyre drejtor i përgjithshëm i AKZM Tirane si dhe z. H.D**,** me detyre përgjegjës i sektorit menaxhimit nga viti 2019 në vazhdim si dhe kryetar i grupit punës, për studimin e kërkesës dhe vlerësimin teknik-ekonomik te sipërfaqeve ne ZM në përdorim.

Titulli: *Mbi auditimin e kryer për veprimtarinë e Administratës të Zonave të Mbrojtura Tiranë (ADZM) "Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë, sipas problematikave qe dalin gjate auditimit", për periudhën nga viti 2019 -2021. Ardhurat.*
Gjetje 7, 6 masa organizative dhe 1 masa zhdëmtimi.
Situata: *Nga auditimi në ADZM Tirane, u konstatua:*
I. Nuk janë regjistruar pranë ASHK Tirane, sipërfaqet e zonave te mbrojtura, nga Administrata e zonave të mbrojtura Tiranë (ADZM), ne kundërshtim me nenin 55 "Regjistrimi i sipërfaqeve zonave mbrojtura" te ligjit 81/2017 "Për zonat e mbrojtura",
II. Nuk ka asnjë listë mbi ndërtimet e paligjshme në këto zona mbrojtura nga ADZM Tiranë përkatësisht: Pk "Mali i Dajtit", Pk "Mali me Gropa-Bizë-Martanesh", Pk "Divjakë-Karavasta" dhe fshatrat tjera, pasi në këto zona ka ndërtime pa leje, të cilat janë vet deklaruar nga subjektet pranë ASHK Tiranë dhe ASHK Lushnjë, për aktivitete ekonomiko-financiare dhe shtëpi banimi.
III. Ne 20 raste, dosjet e subjekteve rezultojnë pa inventarë, për periudhën 2019-2021, për sipërfaqet e zonave mbrojtura te marra me qira, në kundërshtim me neni 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat".
III. Ne 2 raste, ne zonën mbrojtur "Parku Kombëtar Dajt" jashtë kritereve ligjore janë legalizuar 3 ndërtime pa leje dhe janë pajisur me certifikate pronësie nga ASHK 1 Tirane për vitet 2019-2020-2021, ndërsa nga ADZM me miratim te AKZM u është dhëne subjekteve edhe sipërfaqe tjera për rreth ne përdorim,
IV. Ne 1 rast, është dhëne ne përdorim ne zonën e mbrojtur "Parku Kombëtar Dajt , sipërfaqja 1200 m^2 me afat kohor 49 vite, me status juridik "livadh dhe shkëmb", ndërsa ne thyerje te këtij kushti kjo sipërfaqe ka kaluar ne pronësi te subjektit, sipas vërtetimit hipotekor date 25.04.2018 te ZRRPP Tirane (para periudhës nen auditim).
V. Dokumentacioni i dosjeve te subjekteve, për sipërfaqet e marra me qira ne zonat e mbrojtura, ne disa raste paraqet mangësi konkretisht:
a. mandat arkëtimet për likuidimin tarifave qirasë vjetore janë fotokopje, ne vend te origjinaleve,
b. mungojnë dokumentet për penalitetet për ditë vonesat në pagesën e qirasë,
c. mungojnë akt verifikimet ne terren, lidhur me respektimin e ndërtimeve prej druri te çmontueshme dhe provizore, ose nëse ato kane përbërje muri dhe beton, ne kundërshtim me kërkesat ligjore dhe kushtet e kontratave.
d. mungon dokumentet qe vërteton respektimin e sipërfaqes zëne, sipas kontratave lidhura,
e. mungon dokumentet për rehabilitimin e zonës mbrojtur ne përfundim te afatit te kontratave.
k. mungon dokumentet përfundimtare qe pasqyrojnë sipërfaqet ndërtimore te objekteve (akt kolaudimi, akti terrenit etj), kriter baze për përllogaritjen e tarifës qirasë,
l. mungon dokumenti qe te shprehet pushteti vendor për këto objekte, ndryshe nga rastet tjera qe disponohet pëlqimi i bashkisë, njësisë ose kryeplakut fshatit, konkretisht:
VI. Ne 3 raste, padrejtësisht është shtyre afati i kontratës nga 5 vjet ne 10 vjet pa mbaruar afati 5 vjeçar i saj, ne vend qe te shtyhej 3 muaj para mbarimit te afatit kontratës 5 vjeçare, ne kundërshtim me nenin 3, pika 3.1 dhe 3.2 te kontratave përkatëse, konkretisht:
** kontratë 49/3 date 24.08.2020, neni 4, është shtyre afati i kontratës nga 5 vjet ne 10 vjet (2021-2031, sipas shtesës kontratës nr. 96 date 20.08.2021, subjekti G.M.*
** kontratë 55/3 date 13.11.2020 neni 4 është shtyre afati i kontratës nga 5 vjet ne 10 vjet (2021-2031), sipas amendamentit 2 date 20.10.2021, A.Sh.*

** kontrata 35/3 date 14.09.2020 dhe 30/6 date 21.07.2021, pa mbaruar afati 5-vjeçar i kontratës është shtyre afati kohor nga 5 vjet qe ishte ne 10 vjet (2021- 2031), sipas amendamentit 2 date 13.09.2021, subjekti D-P.*

VII. Ne 1 rast, pa baze ligjore ADZM ka lidhur 4 kontrata e amendamente (2020-2021), ne vend te 1 kontrate, duke ndryshuar dhe shtuar sipërfaqet me qira (nga 1,3 ha ne 33,8 ha dhe 47,3 ha) ne zonën e mbrojtur "Parku Kombëtar Mali Dajtit".

VIII. Ne disa raste paraqiten vonesa ne mbajtjen e Amendamenteve te kontratave baze, për ndryshimet ligjore te tarifave qirasë vjetore, sipas VKM 1156 date 24.12.2020, lidhja 1, ne vend qe te mbahen ne momentin e zbardhjes aktit ligjore.

IX. Te ardhurat për periudhën 2019-2020-2021 sipas raporteve vjetore nuk janë zbërthyer analitikisht. Raporti vjetor nuk ka analize te faktorëve qe kane ndikuar ne mosrealizimin e te ardhurave për sipërfaqet me qira, madje nuk identifikohen emrat e subjekteve debitorë, por është mjaftuar me terma përgjithshme pa emra konkret dhe pa përgjegjësi te askujt. Kështu nuk ka plan vjetor te ardhurave, për efekt krahasimi me faktin e realizuar.

- Për vitin 2019 subjektet debitorë për sipërfaqet me qira paraqiten 631,533 leke, por nuk përcaktohen emrat e subjekte dhe numri i tyre. Gjithashtu nuk përcaktohen te ardhurat e planifikuara vjetore, për efekt krahasimi me realizimin e tyre.

- Për vitin 2020 te ardhura nga 35 kontratat e lidhura (progresive) për sipërfaqet ne përdorim me qira paraqiten 3,215,036 leke, por nuk pasqyrohen subjektet debitor. Gjithashtu nuk pasqyrohen te ardhurat e planifikuara sipas kontratave përkatëse etj.

- Për vitin 2021 te ardhura nga 42 kontratat e lidhura (progresive) për sipërfaqet ne përdorim me qira paraqiten 6,146,970 leke, por nuk pasqyrohen subjektet debitor,

X. Ne 11 raste, për vlerën 1,955,991 leke nuk janë shlyer detyrimet e kontratave për qiranë objekteve (për sipërfaqet ndërtimore te bar-restorante, kabina druri etj) mbi zonën e mbrojtur.

(Trajtuar më hollësisht në faqet ..., Projekt Raportit Auditimit).

Kriteri:

- Ligjit 81/2017 "Për zonat e mbrojtura",

- VKM nr. 1064 date 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave ne sektorin pyjor dhe kullotave",

- VKM nr. 1156 date 24.12.2020 "Për përcaktimin e ardhurave gjeneruara nga tarifat qe paguhen ne zonat mbrojtura te masës dhe kritereve përdorimit tyre" etj,.

- Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat".

- UMF 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin aktiveve njësitë sektorit publik".

Efekti: *Shkelje 10 raste gjithsej,*

Shkaku: *Neglizhenca, mungesa e përvojës në punë, arsye tjera, hapësira ligjore.*

Rëndësia: *I Mesëm.*

Rekomandime: *7 rekomandime grupuara, nga këto: 6 masa organizative dhe 1 mase zhdëmtimi.*

Për përmirësimin e gjendjes ne ADZM Tirane, rekomandojmë këto masa:

Në observacion e paraqitur nga AdZM –Tirane, i protokolluar në Administratën Rajonale të Zonave të Mbrojtura Tiranë Nr. 137/1, datë 9.12.2022, mbi pretendimet e specialisteve per pikat si me poshtë .

Në fuksionimin dhe veprimtaritë e AdZM Tiranë, për monitorimin dhe menaxhimin e saj urdhëresat si dhe ndarjet e detyrave të inspektorëve dhe rojeve të mjedisit është kryer nga ish/drejtori I. V., në të cilën autorizon përgjegjësit e sektorëve për zbatimin e tyre, por theksojmë se nuk sanksionon saktë zonën,

kufitë përkatës dhe subjektet të cilët kanë lidhur kontratat si definitive dhe provizore, për të menaxhuar sa më saktë dhe ruajtur zonën nga dëmtimet, nga zjarret etj, por mjafton me shënimin si Zona e mbrojtur Parku Kombëtar Mali I dajtit , pjesa mbrapa".

Pretendimi nga AdZM: *Të gjithë punonjësit janë me detyra të qarta dhe rojet mjedisore kanë të ndara me ish-ekonomitë pyjore me kufij natyror të qartë.*

Brenga këtyre zonave rojet kanë në monitorim dhe subjektet të cilët kanë lidhur kontratë definitive dhe ato provizore (kullotat verore).

Nga grupi i auditimit u kostatua se përgjigjja AdZM nuk ka as nje dokument ligjor argumentues nuk merret parasysh.

Mendimi nga grupi i punës së KLSH thuhet se: Të pa pajisur me certificate pronësie që ti administrojë AdZM Tiranë, pa zona kadastrale si dhe nr. Pasurie në kundërshtim me, nenin 52 Pronësia mbi zonat e mbrojtura, pika 1. Ku shprehimisht thiuhet "Zonat e mbrojtura mjedisore në territorin e Republikës së Shqipërisë janë pasuri Kombëtare. 2. Zonat e mbrojtura në Republikën e Shqipërisë janë pasuri e paluajtshme, prone publike ose private" sipas ligjit 81/2017.

Pretendimi nga AdZM: *Sipas Neni 55 Regjistrimi i sipërfaqeve të zonave të mbrojtura "Në bazë të vendimeve të Këshillit të Ministrave, që miratojnë zonat e mbrojtura mjedisore, AKZMja bën regjistrimin e sipërfaqes së tyrenë Skedarin Kombëtar të Zonave të Mbrojtura dhe në zyrat vendore të regjistrimit të pasurive tëpaluajtshme, duke formuar fondin e sipërfaqeve të mbrojtura në shkallë qarku e republike". Pra AKZM-ja është organi përgjegjës për regjistrim e ponave të zonave të mbrojtura.*

Nga grupi i auditimit u kostatua se përgjigjja nga AdZM, se janë në vartesi të AKZM pavarsisht mos ndjekjes se procedurave nga istucioni pergjegjës pretendimi i juaj meret pjeserisht në konsiderate nga grupi i auditimit.

Mendimi nga grupi i punës së KLSH thuhet se: Sipas pasqyrave dhe informacioneve të mara nga AdM Tiranë rezulton se janë mbajtur gjithsej 40 proçes- verbale nga viti 201902021 nga këto rezulton se 32 raste janë shënimet "i pa identifikuar" ose 80%e proçes-verbaleve janë pa autor dhe "zbatimi dhe ruatja e zones së mbrojtur nuk ka qenë efektive".

Pretendimi nga AdZM: *Këto proces-verbale janë pa autor për shkak se nga rojet mjedisore nuk është gjetur asnjë person në vendin ku janë mbajtur si proces- verbali. Sigurisht rojet gjithmonë ju është thënë se proçesverbalet duhen të jenë me autor. Për për këto raste është kërkuar dhe ndihma e policisë të zonës.*

Nga grupi i auditimit u konstatua se përgjigjja AdZM nuk ka as një dokument ligjor argumentues nuk merret parasysh.

Mendimi nga grupi i punës së KLSH thuhet se: Sipas të dhënave nga AKZM ka marrë informacion nga AdZM Tiranë shkresat të cilat nuk janë të protokolluara si dhe nuk kishin paraqitur dokumetet argumentues ligjorë si më poshtë:

"Në shkresën me nr. 6649 Prot. Datë 22.09.2020 e protokolluar në AKZM me nr. 6319 Prot. Datë 23.09.2020 ku kërkohej informacion nga institucioni përkatës nga AdZM për ndërtimin e një objekti I ndërtuar në zonën e mbrojtur Dajt- Tiranë të verifikuar nga specialistët e AdZM ku përshkruhej se objekti ndodhet në zonën e mbrojtur kategoria e II e shpallur sipas VKM. 402, datë 21.06.2006 të ndërtuar nga z. M. S. D.".

Nga grupi i auditimit u konstatua se përgjigjja e shkresës ishte i sakte por nuk kish dokumente argumentues të vend ndodhjes të objektit " harta si dhe vendodhja" dhe pretendimi i juaj merret ne konsiderate pjesërisht.

Për kontratat provizore të sipas viteve 2019-2021

Mendimi nga grupi i punës së KLSH thuhet se: Ku sipas të dhënave janë lidhur, kontrata provizore për kullotje blegtorinë për 1029 krerë në vit, ku sipas të dhënave nga Instat dhe AZHBR rezulton se Tirana ka 23 mijë gjedhë, 55 mijë të leshta dhe 48 mijë të dhirta.

Sipas sistemit "Ruda" të dhënat nga Ministria e Bujqësisë rezultoi se nuk janë marrë të dhëna për subjektet private.

Pretendimi i AdZM: *Këto të dhëna nuk janë marrë se nuk kemi patur mundësinë për shkak të mungesës së internetit dhe këtë sistem do të përdorët për vitet në vazhdim si mundësi për të gjithë subjektet të cilët duan të marrin sipërfaqe për kullotje në zonë të mbrojtur por gjithashtu do të kërkojmë dhe pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural informacion të detajuar lidhur me blegtorët që janë të pajisur me Certifikatë veterinarie dhe vërtetim nga njësia administrative ku banon.*

-Rojet mjedisore kanë kryer detyrën duke monitoruar zonën por nuk kanë evidentuar asnjë rast për kullotje pa leje në këto zona.

Nga grupi i auditimit pavarësisht pretendimeve nga ana juaj për mungesë internet, si dhe pretendimeve të tjera, nuk kini paraqitur as një shkrese të nisur istucioneve përkatëse për të marrë informacion të sakte mbi numrin e krerëve sidomos te atyre subjekteve qe kane lidhur kontrata provizore nga grupi i punës nuk u muar parasysh .

[15] ISA 200-ISSAI 1200 Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve të tij/saj.

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar u konstatua se nga Administrata e Zonave të Mbrojtura nuk ka evidentim dhe regjistrim të subjekteve dhe individëve privatë të cilët kryejnë veprimtari të ndryshme me karakter ekonomik, social dhe shërbime turistike në zonat e mbrojtura. Nuk ka të dhëna për to në lidhje me aktivitetet e tyre (licencimi, koha e ushtrimit të aktivitetin, vendime, territoret apo dhe veprimtaritë e të cilëve përfshihen në zonën e mbrojtur ose në atë buferike) në kundërshtim me neni 9 pika 5 i ligjet nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura".
- nuk është zgjidhur problem i taksimit specifik të personave fizik dhe juridik që shfrytëzojnë vlerat natyrore, historike dhe kulturore të zonave të mbrojtura,
- Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë **nuk** ka të evidentuar dhe raportuar ndërtimet pa leje të kryera në ZM të Qarkut Tiranë dhe Lushnjë,
- ka patur shumë ndërtime pa leje në zonat e mbrojtura konstatuar nëpërmjet vetë deklarimeve për legalizim, gjë që ka sjellë shpalljen e tyre në Zona Informale, gjithashtu legalizimet janë bërë në mungesë të planit të menaxhimit të zonës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën faqen 15-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë dhe Lushnjë, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë e Shtetit, Bashkitë Tiranë dhe Lushnjë, Agjencinë Shtetërore të Kadastrës të kryejnë verifikimin e ndërtimeve pa leje dhe prishjen e tyre në zonat e mbrojtura si dhe vendosjen e taksave specifike për shfrytëzimin e peizazhit natyror ndaj individëve dhe bizneseve që ushtrojnë aktivitet brenda tyre.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar u konstatua se Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë ka mungesë bashkëpunimi me organet ligj zbatuese si: Inspektoratin e Mbrojtjes të Territorit, Bordet e Kullimit, Agjencinë Rajonale Mjedisore, Veprim në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura "Për organizimin dhe funksionimin të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratës rajonale të zonave të mbrojtura". *(Më hollësisht trajtuar në faqen 19-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë në bashkëpunim me organet ligj zbatuese të marrë masat të ndaloj veprimtaritë e paligjshme brenda zonave të mbrojtura Tiranë dhe Lushnjë. **Menjëherë**

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë nuk ka bërë analizë të detajuar duke përcaktuar dhe rrugët për zgjidhjen e tyre, nëpërmjet masave konkrete në bashkëpunimin me institucionet përgjegjëse në raportin e menaxhimit të qëndrueshëm të zonës së mbrojtur paraqitur në fund të vitit si dhe këto të dhëna nuk publikohen dhe nuk i dërgohen Bashkisë Tiranë. Gjithashtu mungon mbështetja institucionale në nivel ministror për përgatitjen e projekt-drafteve të udhëzimeve dhe marrëveshjeve të përbashkëta me institucionet e licencimit dhe dhënieve të lejeve për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme, me qëllim zvogëlimin e veprimtarive të paligjshme. *(Më hollësisht trajtuar në faqen 57-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë marrë masa që në raportet e vjetore të veprimtarisë dhe të gjendjes së zonave të mbrojtura, të trajtohen të detajuara problematikat e shfaqura në ruajtjen dhe mbrojtjen e burimeve natyrore si dhe të jepen rrugët konkrete dhe të propozojë plan-masash për ruajtjen dhe rimëkëmbjen e tyre si dhe raporte të bëhen publike dhe të njohura dhe për Bashkinë Tiranë. ***Menjëherë dhe nëvazhdimësi***

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar u konstatua se në Administratën e Zonave të Mbrojtura Tiranë janë kryer takime me banorët takime këshilluese informuese por nuk ka dokumentacion shkresor evidentues për lënien e gjurmës së auditimit, që vërteton kryerjen e këtyre veprimtarive (takime) te cilat janë në kundërshtim me *"Rregulloren e brendshme për organizmin dhe funksionimin' e AdZM", neni 30 pika 1.* Ndërsa nuk ekzistojnë e-mail për ftesat për takime, trajnime si dhe për programet dhe axhendat e tyre të zhvillimit. *(Më hollësisht trajtuar në faqe 42-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë, të marrë masa të evidentojnë dhe dokumentojë çdo takim të kryer për në terren zhvillimin e zonave të mbrojtura me banorët apo organizata të ndryshme. ***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

5.Gjetje nga auditimi: Në Administratën e Zonave të Mbrojtura nuk kane dale urdhra për inventarët, dokumentacioni i inventarit është formal dhe i pa kontabilizuar saktë me diferenca ne kartelat personale sipas pasqyrave dhe të pa firmosura nga dorëzuesi dhe marsi ne dorëzim. Konkretisht rezulton se në vitin 2021 gjendja kontabilitetit është 153,647,089 lekë, pra me diference të pa kontabilizuar ne **17 artikuj në vlerë 6,319,273 lekë,** veprime te cilat janë në kundërshtim me *"Rregulloren e brendshme për organizmin dhe funksionimin' e AdZM", neni 30 pika 1 dhe* në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12. 2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Kreu IV "Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve" pikat 73,74. *(Më hollësisht trajtuar në faqen 7-8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë, të nxjerrë urdhra për ngritjen e komisionit dhe inventarizimin e aseve të saj. ***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar u konstatua se Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë ka burime te tjera te të ardhura te pa arkëtuara dhe te munguara në buxhetin e shtetit Të ardhura këto nga lëvizja e vizitorëve në drejtimin tjetër të portës hyrës që kalojnë "**pa paguar as një detyrim** në Zonën e Mbrojtur Dajt, nga lëvizja e vizitorëve "ndërmjet teleferikut "D. E" si dhe ne zonën e Karavastasë, objekteve të natyrës dhe antenat televizive te vendosura ne Zonat e Mbrojtura e nuk kanë as një plan për menaxhimin dhe rritjen e te ardhurave me Ministrinë e vartësisë duke krijuar te ardhura te munguara mesatarisht **200,000,000 lekë.** (llogaritur sipas të dhënave të mara nga faqja e web-it e D-E).

Veprime në kundërshtim me VKM nr.881 date 14.12.2016 "Për miratimin e Planit te Përgjithshëm te Territorit" si dhe me nenin 41 (Pika 1) dhe neni 42 i ligjit nr.81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura". *(Më hollësisht trajtuar në faqen 25-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1.Rekomandimi: Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë të ushtrojnë kontrolle të vazhdueshme për arkëtimin e detyrimeve nga vizitorët që hyjnë në Zonën e Mbrojtur.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se **nuk janë regjistruar ne ASHK Tiranë sipërfaqet e zonave të mbrojtura** nga Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë (ADZM), ne kundërshtim me nenin 55 *"Regjistrimi i sipërfaqeve zonave mbrojtura*" te ligjit 81/2017 "*Për zonat e mbrojtura*". *(Trajtuar me hollësisht ne faqet 10- të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura të marrë masa për regjistrimin në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës**,** të sipërfaqeve të zonave të mbrojtura. ***Brenda qershor 2023***

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se **ADZM Tirane në disa raste nuk ka kompletuar me dokumentacion të plotë dosjet e subjekteve**, **për sipërfaqet e marra me qira në zonat e mbrojtura,** për periudhën e viteve 2019, 2020 dhe 2021, konkretisht:

a. mandat arkëtimet janë fotokopje, ne vend te origjinaleve, madje 1 rast i palexueshme**,** *për likuidimin e tarifave qirasë vjetore nga subjektet, në kundërshtim me nenin 119 te Kodit Civil, me UMF 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin aktiveve njësitë sektorit publik", pika 36.*

b. mungojnë akt verifikimet ne terren, lidhur me respektimin e ndërtimeve prej druri *të çmontueshme dhe provizore, ose nëse ato kanë përbërje muri dhe beton,*

c. mungojnë dokumentet që vërteton respektimin e sipërfaqes *zënë, sipas kontratave lidhura,*

d. mungojnë dokumentet për rehabilitimin e zonës mbrojtur ne përfundim afatit kontratave.

e. mungojnë dokumentet përfundimtare qe pasqyrojnë sipërfaqet ndërtimore te objekteve *nga specialistit licencuar, kriter baze për përllogaritjen tarifës qirasë për sipërfaqet e objekteve.*

k. mungojnë dokumentet qe te shprehet pushteti vendor për këto objekte.

(Trajtuar me hollësisht ne faqet 35-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë **të marrë masa për kompletimin e 20 dosjeve të subjekteve me dokumentacionin e munguar,** për sipërfaqet e marra me qira në zonat e mbrojtura, për periudhën e viteve 2019, 2020 dhe 2021, në zbatim të kërkesave ligjore, përkatësisht: K.D., B.H, E.K, A.Sh, G.L, A.K, A.E, A.D, "T.E.", "D.P." sh.p.k, "H" sh.p.k, A. K, G.M, K.K, "F" sh.p.k, E.K, Sh.A, "S" sh.p.k, "A" sh.a, E.B.

Brenda qershor 2023

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ADZM Tiranë:

a. në 3 raste, **padrejtësisht është shtyre afati i kontratave nga 5 vjet në 10 vjet** pa mbaruar afati 5 vjeçar i tyre, në vend që të shtyhej 3 muaj para mbarimit të afatit të kontratës 5 vjeçare, në kundërshtim me nenin 3, pika 3.1 dhe 3.2 të kontratave përkatëse, *ndërsa në 1 rast nuk është miratuar shtesa e afatit kontratës, pra me 2 standarde*, konkretisht:

** sipas shtesës kontratës nr. 96 datë 20.08.2021, subjekti G.M.*

** sipas amendamentit 2 datë 20.10.2021, subjekti A.Sh.*

** sipas amendamentit 2 datë 13.09.2021, subjekti D.P.*

b. në 1 rast, pa bazë ligjore ka lidhur 4 kontrata *(amendamente),* **në vend të 1 kontrate** *(2020-2021* **duke ndryshuar** dhe **shtuar sipërfaqet me qira** *(nga 1,3 ha në 33,8 ha dhe 47,3 ha)* në zonën e mbrojtur "*Parku Kombëtar Mali Dajtit*".

c. në disa raste paraqiten vonesa të amendamenteve, për pasqyrimin e ndryshimeve ligjore të tarifave qirasë vjetore, në vend që të mbahen në momentin e zbardhjes aktit ligjore, sipas VKM 1156 datë 24.12.2020, lidhja 1, që subjektet të likuidojnë detyrimet e qirasë për sipërfaqet e marra përdorim në kohen e duhur.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 40-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1. Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë:

- të respektojë kushtet e kontratave në shtyrjet e afateve 5-vjeçare të tyre dhe në raste të konstatimeve të shkeljeve të nxirren përgjegjësitë ndaj personave përgjegjës,
- të mos lidhë kontrata duke shtuar sipërfaqet në përdorim në zonën e mbrojtur të paargumentuara dhe në raste të konstatimeve të shkeljeve të nxirren përgjegjësitë ndaj personave përgjegjës,
- të marrë masa që subjektet të likuidojnë tarifat e qirasë në momentin e ndryshimeve ligjore dhe hyrjes në fuqi të tyre.

Menjëherë

MASA ZHDËMTIMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ADZM Tirane nuk ka përllogaritur sakte dhe nuk ka marre masa për arkëtimin e plote te **detyrimeve për tarifat e qirasë** për sipërfaqet e zonave te mbrojtura ne përdorim, për **11 subjekte** ne vlerën **1,955,991 leke ardhura te munguara,** në kundërshtim me ligjin nr. 81/2017 "*Për zonat e mbrojtura*", me VKM nr. 1064 date 22.12.2010 "*Për përcaktimin e tarifave ne sektorin pyjor dhe kullotave*" ndryshuar me VKM nr. 1156 datë 24.12.2020 *"Për përcaktimin e ardhurave gjeneruara nga tarifat qe paguhen në zonat mbrojtura të masës dhe kritereve përdorimit tyre",* lidhja 1, pika 3/a/1, pika 3/b/1 dhe pika 3/c/1 etj. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 10-11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë të ndjekë gjithë procedurat administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **1,955,991 lekë, tarife qiraje e pa paguar,** për sipërfaqet në përdorim të marra me qira në zonat e mbrojtura**, nga 11 subjekte,** përkatësisht: K.D 100,300 lekë, B.H 207,825 lekë, E K 90,000 lekë, A.Sh 55,011 lekë, G.L 80,000 lekë, A.K 118,000 lekë, A.E 32,337 lekë, A.D 191,500 lekë, "T. E" shpk 333,333 lekë, "D. P" shpk 227,685 lekë dhe "H" shpk 520,000 lekë. **Brenda 30.03.2023**

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar u konstatua se **Sektori i Manaxhimit në** AdZM- Tiranë nuk kanë informacion të plotë për subjektet private me kontrata të lidhura provizorisht në Malin e Dajtit mbi sasinë e gjedhëve dhe të imtave. Referuar të dhënave nga sistemi "Ruda " dhe nga Ministria e Bujqësisë me kontrata të lidhura për numër më të vogël subjekti B.S ka likuiduar me pak **15,300 leke** në vitin 2020 2021 dhe subjekti F.D ka likuiduar më pak **42,700 lekë** për vitin 2020. Veprime në kundërshtim me nenin 3 pika 2 e ligjin 81/2017 si dhe rregullores me nr.72/1 date 15.06.2015. *(Më hollësisht trajtuar në faqen 19-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë të ndjeke gjithë procedurat administrative dhe në gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e detyrimit nga B.S për **15,300 leke** dhe subjekti F.D për **42,700 lekë.** **Brenda 30.03.2023**

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Aneksi 1,2 i kundravajtjeve

REGJISËRI I KUNDRAVAJËEVE NË PK "MALI I DAJTIT" DHE ZONAË E MBROJËURA NË QARKUN E TIRANËS SIPAS viti 2019.

NR	KUNDRAVAJTËSI	DAËA E KONSËA ËIMIË	ZONA E MBROJËUR	DËMI I SHKAKËUAR		
	EMËR, ATËSIA, MBIEMËRI			LLOJI I DËMIË	NJËSIA	SASIA
1	I pa identifikuar	23.01.2019	PK "Mali i Dajtit"	Pemë të prera të llojit Shkozë 40 cop me Φ 8-10 cm & Lis cop 40 me ф 10.1-10, 25 cop me ф 20.1-30 cm.	copë	105
2	I pa identifikuar	11.02.2019	PK "Mali i Dajtit"	Pemë të prera të llojit Shkozë dhe Lis 98 cop me Φ 8-10 me ф 10.1-10 dhe 10 cop me ф 20.1-30 cm.	copë	113
3	I pa identifikuar	15.02.2019	PK "Mali i Dajtit"	Pemë të prera të Dajt Dajt Lis me ф 10.1-20 cm.	copë	62
4	I pa identifikuar	22.02.2019	PK "Mali i Dajtit"	Përshkrim zjarri sipërfaqësor në llojin Pishë e Zezë	ha	4,3
5	I pa identifikuar	28.02.2018	PK "Mali i Dajtit"	Përshkrim zjarri sipërfaqësor në llojin Lis	ha	4,8
6	I pa identifikuar	18.03.2019	PK "Mali i Dajtit"	Pemë të prera të llojit Lis me ф 10.1-20 cm.	copë	23
7	I pa identifikuar	25.03.2019	PK "Mali i Dajtit"	Përshkrim zjarri sipërfaqësor në llojin Lis	ha	13
				Përshkrim zjarri sipërfaqësor në llojin Lis	ha	13
8	I pa identifikuar	26.03.2019	PK "Mali i Dajtit"	Përshkrim zjarri sipërfaqësor në llojin Lis	ha	15
				Përshkrim zjarri sipërfaqësor në llojin Lis	ha	13
9	I pa identifikuar	26.03.2019	PM "Mali me Gropa "	Përshkrim zjarri sipërfaqësor në llojin Pishë e Zezë	ha	5
10	I pa identifikuar	26.03.2019	PK "Mali i Dajtit"	Përshkrim zjarri sipërfaqësor në llojin Lis	ha	8
11	I pa identifikuar	30.03.2019	PK "Mali i Dajtit"	Përshkrim zjarri sipërfaqësor në llojin Pishë e Zezë	ha	4,5
12	I pa identifikuar	30.03.2019	PK "Mali i Dajtit"	Përshkrim zjarri sipërfaqësor në llojin Lis	ha	10
13	I pa identifikuar	02.04.2019	PK "Mali i Dajtit"	Përshkrim zjarri sipërfaqësor në llojin Ah	ha	5,2
14	Sub."Gj. K" sha	11.06.2019	PK "Mali i Dajtit"	Zënie të fondit pyjor, depozitim të dherave në objekte Pishë	ha	0,5
15	Sub. "Gj. K." sha	11.06.2019	PK "Mali i Dajtit"	Zënie të fondit pyjor, depozitim të dherave në objekte Pishë	ha	0,4
16	E. K.	18.07.2019	PM "Mali me Gropa"	Pemë të prera të llojit Ah me ф 20.1-40 cm.	copë	36
17	I pa identifikuar	22.08.2019	PK "Mali i Dajtit"	Pemë të prera të llojit Lis me ф 10.1-20 cm.	copë	28
18	I pa identifikuar	12.09.2019	PM "Mali me Gropa "	Pemë të prera të llojit Ah me ф 10.1-20 cm.	copë	80

NR	KUNDRAVAJ TËSI	DAËA E KONSËA ËIMIË	ZONA E MBROJËUR	DËMI I SHKAKËUAR		
	EMËR, ATËSIA, MBIEMËRI			LLOJI I DËMIË	NJËSIA	SASIA
1	I pa identifikuar	07.01.2020	PK "Mali i Dajtit"	Pemë të prera të llojit Arrë Φ 10.1 - 30 cm	copë	10
2	R. Ç.	27.04.2020	PK "Mali i Dajtit"	Përvetësim dru zjarrri	msë	7
3	I pa identifikuar	17.06.2020	PM "Mali me Gropa "	Pemë të prera të llojit Arrë Φ 40.1 - 50 cm	copë	9
4	I pa identifikuar	20.08.2020	PM "Mali me Gropa "	Pemë të prera të llojit Ahu	copë	62
5	I pa identifikuar	28.08.2020	PK "Mali i Dajtit"	Përshkrim zjarri në sipërfaqe me llojin Pishë	ha	0,8
6	I pa identifikuar	02.09.2020	PK "Mali i Dajtit"	Përshkrim zjarri në sipërfaqe me llojin Pishë	ha	0,6
7	I pa identifikuar	06.09.2020	PK "Mali i Dajtit"	Përshkrim zjarri në sipërfaqe me llojin Pishë	ha	5,3
8	I pa identifikuar	08.09.2020	PK "Mali i Dajtit"	Përshkrim zjarri në sipërfaqe me llojin Dushqe	ha	0,5
9	I pa identifikuar	15.09.2020	PK "Mali i Dajtit"	Pemë të prera të llojit Lis Φ 10.1 - 20 cm	copë	75
10	I pa identifikuar	18.09.2020	PK "Mali i Dajtit"	Përshkrim zjarri në sipërfaqe me llojin Ah 7 Ha dhe Shkurre 11 Ha	ha	18
11	I pa identifikuar	18.09.2020	PK "Mali i Dajtit"	Përshkrim zjarri në sipërfaqe me llojin Ah 18 Ha dhe Shkurre 9 Ha	ha	27
12	I pa identifikuar	16.10.2020	PK "Mali i Dajtit"	Gërmim pa leje në fondin e ZM	m^2	1300

REGJISËRI I KUNDRAVAJTJEVE "MALI I DAJTIT" DHE ZONËN E MBROJËURA NË QARKUN E TIRANËS Viti 2021

NR	KUNDRAVAJTËSI	DAËA E KONSËA ËIMIË	ZONA E MBROJËUR	DËMI I SHKAKËUAR		
	EMËR, ATËSIA, MBIEMËRI			LLOJI I DËMIË	NJËSIA	SASIA
1	I pa identifikuar	21.03.2021	PK "Mali i Dajtit"	Pemë të prera të llojit Lis Φ 10.1 - 20 cm	copë	17
2	I pa identifikuar	05.05.2021	PK "Mali i Dajtit"	Pemë të prera në sipërfaqe të llojit Shkurre	m^2	400
3	I pa identifikuar	10.06.2021	PK "Mali i Dajtit"	Pemë të prera të llojit Shkurre	copë	22
4	I pa identifikuar	13.06.2021	PK "Mali i Dajtit"	Pemë të prera të llojit Lis Φ 10.1 - 20 cm	copë	39
5	N. K., B. A.	28.06.2021	PK "Mali i Dajtit"	Hapje rruge në ZM	ml	300
6	E. K.	03.08.2021	PM "Mali me Gropa - Bizë - Marrëanesh"	Pemë të prera të llojit Ah Φ 10.1 - 30 cm	copë	186
7	I. B., D. D.	14.08.2021	PK "Mali i Dajtit"	Pemë të prera të llojit Qarr Φ 10.1 - 30 cm	copë	32

8	I pa identifikuar	18.09.2021	PM "Mali me Gropa - Bizë - Marrëanesh"	Përshkrim zjarri sipërfaqësor në llojin Ah	ha	3
9	I pa identifikuar	25.09.2021	PK "Mali i Dajtit"	Pemë të prera të llojit Lis Φ 10.1 - 20 cm	copë	84
10	A. Gj.	24.12.2021	PK "Mali i Dajtit"	Shpyllëzim i fondië pyjor në ZM me lloje Shkurre	ha	0,06